Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (196) JANAR 2023. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

PROJEKTE

Bimët mjekësore, mundësi të reja të kultivimit

Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 7

PORTRET

Hazis Ndreu: i papërsëritshëm, i papërtuar, modest...

Nga **HALIL RAMA** — Faqe 10

PROFIL

Shefqet Duriçi, novatori e muzikanti i shquar në Bulqizë

Nga **BASHKIM LAMI** — Faqe 8

BOTIME

"Mexhit Capa dhe krahët e fisit", një monografi studimore e M.Bucit

Nga **QAZIM SHEHU** — Faqe 18

INTERVISTË: Flet prof. asoc. dr. Gafur Muka

Akoma **nuk e kemi "Rrugën e Arbrit"**, as si trase, as si punime cilësore

Unë mendoj se akoma nuk e kemi "Rrugën e Arbërit". Nuk e kemi atë as si trase as si cilësi. Me çfarë shihet në terren, konstatohet që është punuar pa përgjegjësi dhe me ritme krejt të ngadalta. Për t'u informuar konkretisht është e domosdoshme të konsultohet projekti dhe të japë shpjegime supervizori. Meqë mungojnë këto dy elementë, atëhere ajo çfarë do përfundojë nuk do të jetë "Ruga e Arbërit".

Unë mendoj se ka qenë aq retorike sa... mezi pret që ta zgjidhë vetë këtë problem. Opozita po flet kryesisht për "rrugët e florinjta", ndërkohë që "rrugët mbesin rrugës". Apeloj për më shumë profesionalizëm në analizën dhe gjykimin opozitar. Në rastin e "Rrugës së Arbrit" ka vërtet shpërdorime që e venë me "shpatulla për muri" qeverinë, referuar në këtë rast si tek cilësia e dobët e punimeve ashtu dhe shpenzimet e pajustifikuara.



OPINION

Tuneli

Duke menduar për Tunelin e Murrizit, nuk e di pse mu ngjitën si rrodhe në tru Tunelet e letërsisë.Njëri prej tyre, romani *Tuneli* i Dhimitër Xhuvanit. Shkrimtari mendoi të ndërtojë një vepër letrare në atë kohë diktature, por masivi i fjalëve dhe panelet e paragrafëve u shembën dhe e zunë Dhimitrin brenda.

Nga **KAMBER FARUKU** - FAQET 4

BOTIME

"Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë", një arritje e arkeologjisë



Recensë rreth librit të ri të studiuesit prof. Adem Bunguri.

Nga Prof. dr. **NERITAN CEKA** - FAQET 15

VËSHTRIM ENCIKLOPEDIK

Vajkali, porta perëndimore e Dibrës



Vajkali ka një pozitë mjaft të favorshme gjeografike, që lidhet drejtpërdrejt me qafën e Buallit, si urë lidhëse midis lindjes e perëndimit, lidhëse midis pellgut të Dibrës dhe atij të Matit e të Tiranës. Madje Vajkali është simboli më domethënës i rrugës së Arbrit.

Nga **ADRIATIK BALLA** - FAQET 12

AKTUALITET

Balluku: Në **nëntor 2023 nisin punimet** në Skavicë

FAQET 2

Baltovine në mbrojtjen e natyrës, Skavica dhe COP15

Nga **SELMAN MËZIU** - FAQET 2

REPORTAZH

Nga Dibra në Dibër, përmes Strezimirit, Restelicës, Shishtavecit dhe Radomirës

Nga **FITIM DIKA** - FAQET 5

NË BRENDËSI:

- **Ura** që rënkoi për më shumë se gjysmë shekulli
- Pse mungon një nga **"Nandë Malet"** e Dibrës në Memorialin e Gjoricës?
- Fati i individit në dy romanet e shkrimtarit **Agron Tufa**
- **Haki Kola**, inxhinieri që bëri më të njohura pyjet dhe shërbimin pyjor shqiptar në botë
- **Hidajet Lahu**, Atdheu është i bukur në çdo cep të tij
- **Faris Cibaku**, sfidanti i pamposhtur
- **Havzi Nela**, i rrallë por jo i vetëm
- **Beqir Gjoka**, një nga 100 shqiptarët e suksesshëm në SHBA
- Mos e harroni **Selim Pirën**, burrë i rrallë mes të rrallëve i Dibrës
- Shuhet **Kujtim Neli**, njeriu i pasionuar pas punës e shkencës.
- **Lutfi Manjani**, kapiteni i përjetësisë!

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 1 (196).
Janar 2023
Gazeta doli nga shtypi, 31 janar 2023.
Gjendet në treg deri në fund muajit shkurt 2023.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Sami CURRI
Defrim METHASANI
Osman XHILI
Kamber FARUKU
Fitim DIKA
Neritan CEKA
Adriatik BALLA
Selami NAZIFI
Qazim SHEHU
Hajri SHEHU
Gjon FIERZA
Janaq MALE
Namir LAPARDHAJA
Halil RAMA
Bashkim LAMI
Selman MEZIU
Besnik LAMI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Balluku: Në **nëntor 2023 nisin punimet** në Skavicë

Belinda Balluku, zëvendëskryeministre dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë deklaroi gjatw analizws vjetore tw ministrisw sw në nëntor të vitit 2023 do të hapet kantieri për HEC-in e Skavicës.

Sipas Ballukut, projekti vlerësohet të kushtojë rreth gjysmë miliardë euro gjatë pesë viteve të ndërtimit.

Ai synon ta bëjë sistemin hidroenergjetik të Shqipërisë më pak të varur nga moti.

Puna përgatitore për atë që do të jetë projekti më i madh i ndërtimit në Shqipëri që nga rënia e komunizmit në 1991, vjen ndërsa rajoni i Ballkanit Perëndimor – krahas Evropës dhe Perëndimit – përpiqet të reduktojë varësinë e tij nga importet e gazit rus.

Diga është parashikuar të rrisë prodhimin vendas të energjisë së Shqipërisë me 20 për qind, me shpresën se do ta transformojë vendin në një eksportues të energjisë së pastër.

"Skavica është projekti më sfidues dhe më i mrekullueshëm që kemi për të krijuar pavarësi nga importet", deklaronte Belinda Balluku.

Bechtel, kompania më e madhe e ndërtimit në SHBA, është punësuar nga Qeveria shqiptare për të kryer studime dhe për të bërë propozime për digën, e cila do të jetë në pronësi publike.

Kompania me bazë në Virxhinia ishte njëra nga një konsorcium kompanish që ndërtuan Digën Hoover në vitet 1930 në kufirin midis Nevadës dhe Arizonës.

"Diga Hoover ishte transformuese në ditët e saj. Skavica është në të njëjtën shkallë", thotë Entela Ruci, menaxhere e zhvillimit të biznesit në Ballkan në Bechtel. "Do të krijojë deri tani burimin më të madh të energjisë së pastër në të gjithë Ballkanin".

E gjithë energjia e prodhuar aktualisht nga Shqipëria është e rinovueshme dhe pjesa më e madhe është hidroelektrike, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga era ose dielli.

Në vitet me lagështi, Shqipëria mund të plotësojë 70 për qind të nevojave të saj për energji, duke rënë në rreth 60 për qind në vitet e thata.

Vendi ka duruar tre vite të thata radhazi, duke ulur prodhimin e energjisë dhe duke e detyruar atë të importojë energji në një kohë me çmime rekord.

Çmimi për megavat (MW) është rritur në ekuivalentin e rreth 460 paund në Shqipëri, ku familjet dhe bizneset varen pothuajse tërësisht nga energjia elektrike për ngrohje dhe energji.

Skavica do të jetë një digë 210 MW dhe do të optimizojë prodhimin në digat e tjera.

Vendi i ri do të jetë në gjendje të ruajë dhe kontrollojë rrjedhën e ujit në digat e tjera, që do të thotë se energjia hidroelektrike mund të krijohet ende edhe pasi stinët e thata dhe rajonet në rrjedhën e poshtme janë të mbrojtura nga përmbytjet.

SKAVICA DHE ETAPAT E SAJ

Faza e parë e nisjes së punimëve për realizimin e projektit – studimin gjeoteknik, rrugët paraprake të ndërtimit dhe përfundimin e vlerësimit social – nisi më 2 tetor me prezencën e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ambasadoren amerikane Yuri Kim.

"Bechtel" e nënshkroi kontratën me ministren Balluku, më 5 korrik.

Gjatë çeljes së punimeve u bë me dije se kjo fazë vlerësohet të përfundojë në nëntor të vitit 2022.

Ndërsa ndërtimi i uzinës pritet të zgjasë rreth katër vjet. Në fazën e dytë do të fillojë puna për ndërtimin e HEC-it.

Këshilli i Ministrave më 4 mars miratoi projektligjin, sipas të cilit kompanisë "Bechtel" iu dha autorizimi për të projektuar dhe ndërtuar hidrocentralin e parë të kaskadës së Drinit.

Ky projekt mori dritën jeshile vitin e kaluar, më 3 tetor, pas nënshkrimit të marrëveshjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për financimin e projektit.

Hidrocentrali do të jetë i aksesueshëm si nga Rruga e Kombit, ashtu dhe nga Rruga e Arbrit. Përfitimet e këtij projekti do të prekin fusha të ndryshme, si: peshkimi, turizmi edhe punësimi.

Më herët, kryeministri Edi Rama u shpreh se kontributi i këtij projekti në vlerat ekonomike shqiptare do të jetë shumë i lartë.

Në maj të 2020-ës, kryeministri tregoi se ky hidrocentral do të ndërtohej me fondet e qeverisë shqiptare, por më pas vendimi ndryshoi.

HEC Skavica është vepra energjetike më strategjike në vend dhe rezervuari ujor më i rëndësishëm i Shqipërisë me rreth 7 miliardë m3 ujë. / ***gazetatema.net***

OPINION nga Dr. **Selman Mziu**

Baltovine në mbrojtjen e natyrës, Skavica dhe COP15

Populli shqiptar i mbetur, në vlagën e përkoshme të atdheut të tij, sigurisht dhe i mbytur nga lotët e syrgjinosjes të rinisë edhe fëmijëve që braktisin shkollat, kërkon të njihet se çfarë u vendos në Konferencën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi bioshumëllojshmërinë (COP15) nga data 07.12.2022 – 19.12.2022 në Montreal të Kanadasë. Duke vazhduar më tej populli i varfëruar dibran e lugina e Drinit të Zi e shkretuar e shpopullar më shumë se kudo në Shqipëri, kërkon, dëshiron të dije se çfarë u fol e çfare u vendos në këtë konference mbarë botërore për ekosistemet natyrore dhe kujdesjet e politikbërsve e njeriut në ndërhyrjet e tyre në këto ekosisteme. Në fund të mbledhjes: ''Të gjitha vendet pjesmarrëse kanë vendosur një varg masash për të mbrojtur 30% të shumëllojshmërisë së gjallesave që gjënden në tokë dhe 30% në dete brenda vitit 2030 të mbështetura në një investim prej 30 miliard dollar ndihmë vjetore për vendet në zhvillim..

E KUNDËRTA, INVESTIM PËR ZHDUKJE

Organizma të shumta në mbarë botën, qeveri të shumta kanë ministri të veçanta, programe afat gjata e afat shkurtëra për të zbutur kërcënimet shkatërrimtare te biosferës nga ndryshimet e klimës. Përkundrazi qeveria shqipëtare ecën duke ndjekur klithmat çjerrëse të teknologjive të një kohe të perënduar. Kjo do të thotë që Qeveria Rama 3, edhe pse ka hartuar një program mbi zbutjen e ndikime të klimës mbi bioshumëllojshmërinë ajo vepron praktikisht në kundërshtim me ato që premton e deklaron në forumet ndërkombëtare, por kjo edhe në programet qeveritare mbi ekonominë. Dhe ja shembulli konkret:''...Investimi në total parashikohet 550 milionë dollar.,,(Belinda Balluku:''Shmangen përmbytjet, sjell zhvillim për zonën.,, 05.07.2021) për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, duke synuar edhe kuotën më të lart 485 m. Qeveria shqiptare në kundërshtim me 15 konferencat ndërkombëtare të OKB, mbi bioshumëllojshmërinë investon për të vendosur mbi ekosistemin natyror te luginës se Drinit te Zi ''6.7 miliard m3 ujë.. (A. Ashiku, Nga cikli: "Skavica nuk do të kalojë"...No passaran,, 20.04.2022) Si përfundim Qeveria Rama 3 investon për zhdukjen e bioshumëllojshmërine dhe jo per te shtuar e mjekuar mjedisin ''shpirt e trup sakatosur,,. Investon per zhdukjen e trojeve shumë shekullore me shtëpite, kullat, karakollet plotë art e kulture rrethuar me bahçe, livadhe, arat mbjellura me kultura të shumta bujqësore, relievet e kodrave, kodrinave, shpateve e luginave mbuluar me pyje, deri te llojet e peshqëve e molusqet që jetojn në shtratin ujë rrjedhës të Drinit të Zi prej 75 km. Veprime të cilat janë diametralisht të kundërt me politikat programet e një bote të tanë. Politikanët, deputetët, të dehur nga deliri i madhështise të Kryetarit të tyre, të friksuar e tutur nga shpata me shkëlqim të përkohshëm të tij, ngrejn duart duke bërë Amen Amen. Akoma nuk e kanë kuptuar se velloja e zezë e turpit e papëgjegjshmërisë dhe krimi apoklipsinshëm mbi biosferen, ekosistemet natyrore e bujqësore do t'i mbuloi, mbyt ato moralisht, mendërsiht e fizikisht. Dhe çmenduria vazhdon fatkeqësisht. Ja nje shembull tjetër investimesh: ''Për Shqipërinë shifra që jepet është ajo e hidrocentraleve që do të jenë të ndërtuara deri në vitin 2025 që është 436 hidrocentrale.,,(WWW BOTASOT. Info 17.11.2017) Këto janë minat ekologjike shpërthyese që do të vendosen në përrenjt e lumenjt ujërrjedhëse të pastra e bioekologjikisht të përshtatshme për një larmi të shumtë gjalllesashe ane e mbanë mjedisit natyror të shqipërisë.

INVESTIME NË MBROJTJE E SHËNDOSHJEN E NATYRES

Konfernca KOP 15 duke analizuar me kujdes, referimet e punimet e shkencëtarëve në fusha te ndryshme të klimatologjisë, ekologjisë, ekosistemeve të ndryshme etj. ka caktuar një detyrë tjetër mjaft të randësishme dhe e zbatueshme për mjaft vende të botës së sotme, dhe ja lexojm:''Paksimi i investimeve që shkatërrojn shumëllojshmërinë e qënjeve të gjalla, të paktën në 500 miliard dollar në vit, këto të investohen në mbrojtjen e natyrës, nxitjen e zhvillimit biologjik dhe shtimin e llojshmërisë në natyrë,, (Cop 15 pika 4)

Do të analizojm një pjesë të bashkëjetesës biologjike të pyllit si një ndër elementët e bioshumëllojshmërisë që janë shpendët e pyllit. Jeta e të cilëve është e lidhur pa zgjithshmërisht me pyllin si shtëpia, vendërritja (biotopi S.M) i tyre. Për të kuptuar më mire funksionimin e kësaj bashkësie do ti referohemi studimit bioekologjik të ''Pyjeve të virgjëra të shqipërisë,, ku shkruhet: ''Në pyje gjenden 60 specie shpendësh. Nga këto 7 specie janë të rrezikuara, 24 specie janë të rralla dhe 20 specie janë të zakonshme".

Ruajtja e natyrës, investimet në fushat e shërimit të plagëve të saja ishin objektivat e COP15 për të shëndoshur ekosistemet e plagosura tmerrësisht nga njeriu si qenie individuale dhe kolektive ose e bashkuar me veprimet e pa menduara të politkbërsve që kanë të plazmuar në mendjen e tyre, vetëm fitimet kolosale. Ne duhet të jemi të gjithe nxënës të natyrës ndërsa e vërteta është se ne jemi vrasësit e saj, plagë hapësit e saj. Qeveria E. Rama 1,2, dhe 3, ende nuk i ka kuptuar gabimet e saja trashanike e me pasoja për brezat e sotëm e të nesërm.

Botuar me shkurtime. Lexo të plotë në:https://sot.com.al/opinion-editorial/baltovine-ne-mbrojtjen-e-natyres-skavica-dhe-cop15-i563188

intervistë

Unë mendoj se ka qenë aq retorike sa... mezi pret që ta zgjidhë vetë këtë problem. Opozita po flet kryesisht për "rrugët e florinjta", ndërkohë që "rrugët mbesin rrugës". Apeloj për më shumë profesionalizëm në analizën dhe gjykimin opozitar. Në rastin e "Rrugës së Arbrit" ka vërtet shpërdorime që e venë me "shpatulla për muri" qeverinë, referuar në këtë rast si tek cilësia e dobët e punimeve ashtu dhe shpenzimet e pajustifikuara.

Muka: **Akoma nuk e kemi "Rrugën e Arbrit"**, as si trase, as si punime cilësore





Prof. Assoc. Dr. Gafur Muka, thotë se nuk e kemi akoma "Rrugën e Arbrit" as si trase dhe as si punime cilësore. Në intervistën për Bulqizaime.al, Muka shprehet se është punuar pa përgjegjësi dhe me ritme krejt të ngadalta. Për Mukën, shpenzimet që janë kryer deri më sot për ndërtimin e rrugës së Arbrit, janë për "rrugë të florinjta".

Kemi afro dy dekada që flasim dhe dëgjojmë për ndërtimin e rrugës së Arbrit, ndër akset më të rëndësishme kombëtare. Fakti që ende ndërtimi i rrugës po zvarritet me ritëm shumë të avashtë të punimeve, por edhe që në ato segmente që mund të konsiderohen të përfunduara, punimet nuk duken aspak cilësore, ju si e vlersoni diçka të tillë?

Natyrisht që është folur shumë dhe kemi dëgjuar shumë për "Rrugën e Arbrit". Më së fundmi, vitin e kaluar, u bë i mundur edhe kalimi nëpër atë që emërtohet si "Rruga e Arbrit". Por a është kjo "Rruga e Arbrit"?. Unë mendoj se akoma nuk e kemi "Rrugën e Arbrit". Nuk e kemi atë as si trase as si cilësi. Me çfarë shihet në terren, konstatohet që është punuar pa përgjegjësi (çfarë e lejon mungesa e ballafaqimit me projektin) dhe me ritme krejt të ngadalta (çfarë e vërteton kohëzgjatja afro 20 vjeçare). Për t'u informuar konkretisht është e domosdoshme të konsultohet projekti dhe të japë shpjegime supervizori. Meqë mungojnë këto dy elementë, atëhere ajo çfarë do përfundojë nuk do të jetë "Ruga e Arbrit".

> Unë mendoj se akoma nuk e kemi "Rrugën e Arbërit". Nuk e kemi atë as si trase as si cilësi. Me çfarë shihet në terren, konstatohet që është punuar pa përgjegjësi (çfarë e lejon mungesa e ballafaqimit me projektin) dhe me ritme krejt të ngadalta (çfarë e vërteton kohëzgjatja afro 20 vjeçare). Për t'u informuar konkretisht është e domosdoshme të konsultohet projekti dhe të japë shpjegime supervizori. Meqë mungojnë këto dy elementë, atëhere ajo çfarë do përfundojë nuk do të jetë "Ruga e Arbërit".

Sipas jush sa i organizuar ka qenë faktori dibran për të lobuar mjaftueshëm për ndërtimin e rrugës së Arbrit. Këtu nënkuptoj që tek shoqëria civile, media por më e rëndësishmja në politikë si në kampin politik majtas dhe djathtas?

Nuk mendoj se ka munguar lobimi. Ai ka qenë i nevojshëm deri sa ndërtimi i kësaj rruge të përfshihej në objektivat programore të qeverisjes. Pas kësaj, kërkohej hartimi i një projekti sa më efiçent dhe, në vazhdim, zbatimi i këtij projekti. Këto janë detyra të qeverisjes. Sa janë realizuar këto detyra? Përgjigja është dëshpëruese. Kush e ka përgjegjësinë për këtë? Firma zbatuese ka përgjegjësinë e saj, por përgjegjësinë kryesore e ka supervizimi i punimeve të firmës. Në kushtet e një kontrrolli korrekt, firma do të detyrohej ta zbatonte projektin në lartësinë e standardeve të projektimit. Duket që ky kontrroll ka munguar. Përkundër kësaj mungese duhej të reagonte fort, kryesisht opozita dhe shoqëria civile. Mbase ka patur zëra kritikë por, përderisa "veshi" që duhej të dëgjonte ka mbetur i shurdhër, është bërë "shumë zhurmë për asgjë". Nuk është kritikë të dëgjosh nga goja e politikanëve thjesht "ka korrupsion me dhjetëra apo qindra milionë euro". Kritika për objekte të tilla duhet të jetë thellësisht profesionale, duke treguar shkallën e plotësimit të standardeve, shpenzimet e justifikuara dhe paratë e harxhuara për punë të pabëra.

Nëse sot do të kishim rrugën e përfunduar, sipas jush sa do të kishte ndikur në jetën dhe zhvillimin ekonomik të qarkut të Dibrës, pavarësisht se kjo nuk mund të konsiderohet vetëm një rrugë që i shërben kësaj zone, por një aks strategjik kombëtar?

Është e pamundur të flasësh me tregues sasiorë për ndikimin e kësaj rruge në jetën dhe zhvillimin ekonomik të gjithë zonës që ajo përshkon, pa një studim të të gjithë faktorëve ekonomikë, kulturorë, socialë etj. Sidoqoftë, nisur nga fakti që kjo rrugë është miratuar për t'u ndërtuar pikërisht se ka ndikim në zhvillimin e zonës që përshkon, duhet thënë që mospërfundimi në kohë i saj ul efektivitetin e projektit, për më shumë, nëse cilësia e ndërtimit nuk realizohet në standardet e kërkuara, ky efektivitet gjymtohet keqas për gjithë kohën e shërbimit.

Nën tingujt e daulleve dhe "ahengut' të administratës publike, rruga e Arbrit u hap për kalimin e automjeteve. Kjo me një ceremoni jo aq të organizuar siç u hap tuneli që lidh Sarandën me Gjirokastrën, pasi nuk kishim kor këngëtarësh. Këtu po përdor pak ironi. Si ju duket cilësia e punimeve në ato segmente që konsiderohen të përfunduara?

Shumë larg cilësisë që garanton zbatimi i standardeve të një projekti, qoftë edhe modest.

Pak javë më parë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, njoftoi shpalljen e dy procedurave të tjera tenderuese lidhur me rrugën e Arbrit. Konkretisht ajo për sistemimin dhe rivitalizimin e skarpateve në Planin e Bardhë dhe në Shkallën e Tujanit, ku bashkë me kontratat e supervizimit për këto tendera, kap një vlerë prej afro 20 milionë euro – duke e çuar koston e rrugës në afro 350 milionë euro. Me gjithë këto shtesa fondesh, mos po shkojmë edhe më këtë rrugë, ngjashëm me investime të tjera që janë bërë në vend, ku shtesat e fondeve nga paraja publike janë të vazhdueshme e mund të them marrin edhe një emërtesë si "rrugët e florinjta"?

Nuk dua të spekulloj me shifrat. Në gjykimin e një specialisti shpenzimet i përcakton një preventiv i bazuar në një projekt, oponenca e të cilit ka dhënë vlerësime pozitive. Unë as e kam parë projektin as e kam kontrrolluar preventivin e, as e kam lexuar oponencën. E kam fare të lehtë të them që shifrat janë për "rrugë të florinjta", retorikë tashmë e dëgjuar nga veshët tanë, por për këtë dua të flas me fakte bindëse. Inisiativën për një oponencë profesionale të akordimit të këtyre fondeve duhet ta ndërmarrë si opozita ashtu edhe shoqëria civile.

Në disa intervista që kemi zhvilluar me njohës të mirë të zhvillimeve për rrugën e Arbrit, hedhin poshtë pretendimet e qeverisë se gjeologjia është problem në zvarritjen e punimeve në tunelin e qafë Murrizit. Por shohin si problem aftësinë e kompanisë për të punuar në vepra të tilla të rëndësishme infrastrukturore, dhe mos kryerja e studimeve serioze gjeologjike para se të niste puna në terren. Sa qëndron një çështje e tillë?

Unë nuk mendoj se gjeologjia nuk është problem, por mund të them se çdo problem ka zgjidhje, kur ai njihet dhe merret përsipër për t'u zgjidhur nga njerëzit që e njohin. Në rastin e "Rrugës së Arbrit", problemi është marë përsipër për t'u zgjidhur pa e njohur atë, çka do të thotë " i është hyrë detit me këmbë", më tej e kanë marrë përsipër ta zgjidhin njerëz që nuk ja kanë takatin. Për më tepër u mungon dhe "inati". Në këto kushte e kam të vështirë të bëj parashikime, pasi gjykoj se do vazhdohet me "shti ujë e shto miell" dhe... "fajin e ka gjeologjia".

Sipas jush sa aktive ka qenë opozita për të ngritur zërin për ndërtimin e rrugës dhe ato problematika që kanë dalë në ato segmente që konsiderohen të përfunduara?

Unë mendoj se ka qenë aq retorike sa... mezi pret që ta zgjidhë vetë këtë problem. Opozita po flet kryesisht për "rrugët e florinjta", ndërkohë që "rrugët mbesin rrugës". Apeloj për më shumë profesionalizëm në analizën dhe gjykimin opozitar. Në rastin e "Rrugës së Arbrit" ka vërtet shpërdorime që e venë me "shpatulla për muri" qeverinë, referuar në këtë rast si tek cilësia e dobët e punimeve ashtu dhe shpenzimet e pajustifikuara.

Zvarritja kaq gjatë, sidomos me një ritëm shumë të ngadaltë të punimeve pas zgjedhjeve të 25 prillit, mendon se kemi të bëjmë edhe me një vullnet politik të mazhorancës së sotme që në qarkun Dibër nuk e përmbushi objektivin për të pasur tre mandate?

Natyrisht unë e di se krahu opozitar, do ta rendiste këtë si faktor përcaktues. Sidoqoftë gjithë ecuria e punëve në këtë projekt nuk ka qenë asnjëherë në përmbushjen e afatave të caktuara. Dhe kjo histori vazhdon. Deri kur? Uroj dhe shpresoj të mos e kalojë vitin 2023!

Gafur MUKA është diplomuar në fakultetin Gjeologji Miniera të Universitetitet të Tiranës. Mban titullin Doktor në shkencat inxhinjerike (UPT). Specializime postdoktoriale në Montanuniversitaet Leoben, Austri, RWTH. Për tre vite ka punuar si inxhinier në Minierën e Bulqizës. Prej vitit 1981, Muka punon si lektor në universitete të ndryshme.

Marrë nga bulqizaime.al

OPINION



TUNELI

Nga **KAMBER FARUKU**

Duke menduar për Tunelin e Murrizit, nuk e di pse mu ngjitën si rrodhe në tru Tunelet e letërsisë.Njëri prej tyre, romani Tuneli i Dhimitër Xhuvanit. Shkrimtari mendoi të ndërtojë një vepër letrare në atë kohë diktature, por masivi i fjalëve dhe panelet e paragrafëve u shembën dhe e zunë Dhimitrin brenda.I dhanë shkrimtarit të mbuluar nga pluhuri i fjalëve një kazëm në dorë, e përzunë nga Tirana, e ndanë edhe nga familja, dhe e çuan të hapë kanale që të mbushet me mend nga klasa puntore. Të njëjtin fat pësoi edhe një infermiere në Bistricë, ku zhvilloheshim ngjarjet e romanit.Edhe asaj i dhanë një lopatë në dorë të mbushë gropat e rrugës, sepse kishte shërbyer si model frymëzimi për shkrimtarin.Ishte rasti i vetëm në botë që , bashkë me shkrimtarin, të dënohej edhe personazhi i veprës së tij.Komedi dhe tragjedi bashkë.

Apo Tuneli tjetër, një roman i Ernesto Sabatos.Kjo vepër nis si një tunel dashurie, por, ec e ec, dashuria brishtësohet, ngec në shtresa të paparashikuara dhe shembet.Mbeti Tuneli i shkrimtarit argjentinas si një labirinth social, edhe i kalueshëm edhe i bllokuar për ndjenjat njerëzore, edhe me dritë edhe i errët. Edhe ky një tunel letrar i frikshëm.

Do të kisha vazhduar edhe me TUNELE të tjera shkrimtarësh, por, befas, shkëndijoi në kujtesën time një tunel fizik, Tuneli famoz i Semeringut në malet austriake. Aty, shekull më parë, ndonëse nuk pati asnjë kapriçio nëntokësore, inxhinieri shqiptar Karl Gega u vetëvra.E vrau nderi profesional, mungesa e dritës në fund të tunelit.Kur drita u shfaq pas disa metrash gërmimi, nderi profesional u rikthye, por inxhinieri i paharruar nuk jetonte më.Jeton jehona alpine e lokomotivës , që i bie borisë saherë kalon krahas bustit të Karl Gegës aty te tuneli i Semeringut.

Çfar pata unë që u futa në xhunglën e tuneleve?Jo, jo nuk më rrëshqiti këmba, por më fluturoi mendja kur, pas vitesh e vitesh, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e energjisë dhe e infrastrukturës, Belinda Balluku, bash Ajo, del e thotë para pak ditësh:

-Për tunelin e Murrizit nuk ka kohë përfundimi.

Heeej!Puna për Tunelin e Murrizit po bëhet e pavdekshme!

Ishte thënë se ky tunel do të mbaronte në fund të prillit 2022.

Pastaj, gjithmonë nga Ministrja, u kumtua se do të mbaronte në shtator 2023.

Po tani?

Mu kujtua historia e Nastradinit me borxhin.Djali i kishte thënë borxhliut të vinte pas një viti.

-Jo, i thotë Nastradini, të vijë të enjten!

Borxhliu u gëzua, se e enjtja vinte shpejt.Kur ai erdhi të enjten, Nastradini i tha përsëri:

-Të pres të enjten.

Por, të enjtet nuk mbaruan asnjëherë…

Flitet për tunelin se nuk janë bërë studime gjeologjike.Folën gjeologë të njohur.Kjo u paragjykua si mosbesim, si keqdashje, si propagandë nga jomiqtë e Tunelit.

Dikush tha se është një gabim teknik në punë dhe këtë dëm e ka kompania Gjoka, shteti nuk paguan asnjë qindarkë. Doli llafi se veshjet e Tunelit u bënë me bukë peshku, polisterol.

Këto mbetën fjalë në ajër, veçse të gjithë e

kemi vënë re se për muaj e muaj nuk është punuar fare në kantier.Edhe kur niset puna, të duket se punohet me karroca dore.

Shtrohet një pyetje:-Ka inxhinierë zbatimi, apo projektimi, apo studimi gjeologjik kompania Gjoka shpk?Ka konsulentë kësolloji?Pse asnjëri prej tyre nuk shpjegon se çfar po ndodh brenda në tunel?Qytetarët kërkojnë ta dinë, sepse ata janë investitorët.

Po media, pse nuk interviston specialistët e kompanisë, drejtuesit e saj?

Ky mur i lartë errësire duhet kapërcyer. Deklaratat e Ministres janë thjesht tym, paqartësi, rrahje uji në havan.Nuk duam më të dëgjojmë atë, sepse fjalët e saj duken si perde që mbulojnë të vërtetën.

Rruga e Arbërit nuk ka dritë në fund të tunelit.

Po të jetë Tuneli i Murrizit një vepër letrare, ku i ka personazhet e saj? Është një vetëvrasje inxhinierike kjo vepër, apo një lojë ekonomike?Apo të dyja bashkë?

Rruga e Arbrit e rrënuar dhe gjysmake, merr 1/3 e financimit deri në nëntor 2022

Deri në fund të nëntorit 2022, koncesionari i Rrugës së Arbrit rezulton të ketë marrë 11.5 miliardë lekë pagesa nga buxheti i shtetit, ose rreth 100 milionë euro, sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave.

Kjo shumë është gati një e treta e fondeve totale prej 36,4 miliardë lekësh që do të marrë për të gjithë periudhën e koncesionit.

Por ndërkohë punimet në Rrugën e Arbrit janë larg përfundimit, teksa pjesa e përfunduar, edhe pse u mor në dorëzim nga qeveria, është në gjendje jo të mirë. Tuneli i Murrizit, që është aksi me më shumë kosto i rrugës, është në ende në ndërtim dhe po përparon me ritme shumë të ulëta. Ministria e Infrastrukturës pret që punimet në këtë segment të përfundojnë brenda këtij viti.

Rruga e Arbrit ka kaluar një histori të komplikuar kostosh dhe procedurash, nga planet fillestare për ndërtimin e saj me 70 milionë euro, deri në ditët e sotme ku fatura pritet të arrijë mbi 350 milionë euro.

Qeveria e mori në dorëzim rrugën në nëntor të vitit 2021, edhe pse punimet nuk kishin përfunduar në një pjesë të madhe dhe me cilësi të dobët punimesh. Inxhinierët e fushës pohuan se, kostot ishin mjaft të larta nga studimet fillestare të fisibilitetit, teksa koncensionari nuk respektoi parametrat e gjerësisë, shesh- pushimet, mbrojtjen anësore të skarpateve, etj.

Reshjet e ditëve të fundit kanë përkeqësuar më tej situatën, ku segmente të saj janë gjendur me shembje masive të dherave, aq sa edhe mjetet e kompanisë koncesionare kanë përfunduar në përroin ngjitur.

Afati i kohëzgjatjes së ekzekutimit të kontratës është 13 vjet, ndërkohë që punimet nisën më 2019. Këtë vit mbushen 5 vjet nga hyrja në fuqi e kontratës. Sipas përcaktimeve në kontratë rruga duhej të ishte dorëzuar e plotë maksimumi më 2022, por më shumë gjasë punimet në këtë aks tashmë të rrezikshëm edhe për përdoruesit do të zgjasë pa afat.

Rruga e Arbrit nuk është një projekt i ri, ajo ka nisur zbatimin në kohën e qeverisë "Berisha" gjatë së cilës u ndërtuan disa pjesë të segmentit.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Transportit, kur nisi koncensioni ishin ndërtuar plotësisht 20.12 kilometra, pjesërisht në 15.17 km dhe ishin të paprekura nga punimet 26.3 kilometra.

Investimet publike po humbasin efektivitetin pasi janë copëzuar në projekte jofizibël dhe kontrata shumëvjecare. Rrugët kanë qenë prioriteti kryesore i qeverive ndër vite dhe vazhdojnë të jenë, por invetsimet janë përqendruar në periferi duke lënë qendrën e vendit me pa një rrjet bashkëkohor rrugor edhe pse 60% e trafikut është na rajonin, Krujë, Durrës, Tiranë./B.Hoxha

Marrë nga: https://www.monitor.al/rruga-e-arbrit-e-rrenuar-dhe-gjysmake-merr-1-3-e-financimit-deri-ne-nentor-2022/

20 milionë euro shtesë për dy lote të rrugës



Afro 10 milionë euro shtesë u dhanë nga qeveria për sistemimin dhe rivitalizimin e skarpateve në Planin e Bardhë, pjesë e rrugës së Arbërit. Puna formalisht ka nisur që në nëntor 2022, por në terren shumë pak është ndërhyrë në skarpate. Kryesisht janë ndërtuar mure betoni anësore dhe sistemuar disa shembje përgjatë trases, duke mos ndërhyrë në sistemimin e pjesëve të tjera.

Autoriteti Rrugor Shqiptar disa muaj më parë shpalli dy procedura tenderuese lidhur me rrugën e Arbërit. Konkretisht ajo për sistemimin dhe rivitalizimin e skarpateve në Planin e Bardhë dhe në Shkallën e Tujanit, me një vlerë prej afro 20 milionë euro. Në termat e referencës për këto dy tendra, thuhet se koha e nevojshme për përfundimin e punimeve është katër muaj nga data e lidhjes së kontratës, çka përkon vetëm pak javë para mbajtjes së zgjedhjeve vendore.

Në njoftimet fillestare të qeverisë, rruga e Arbërit një projekt koncesionar pritej t'u kushtonte taksapaguesve rreth 40 miliardë lekë ose 330 milionë euro. Por me ndryshimet e fundit, vlera për ndërtimin e rrugës së Arbërit do të shkojë në 350 milionë euro. Bashkë me segmentet e tjera para vitit 2013-të, kjo rrugë parashikohet të kap vlerën e mbi 400 milionë euro.

Ndërtimi i saj është përdorur si një "kale" beteje elektoralesh në qarkun e Dibrës prej vitesh. Ato segmente që konsiderohen të përfunduara, janë me punime jo cilësore dhe jo në parametrat e kërkuar duke u kthyer në burim aksidentesh dhe zhgënjimi për banorët e Dibrës. / bulqizaime.al

reportazh

Nga Dibra në Dibër, përmes Strezimirit, Restelicës, Shishtavecit dhe Radomirës

Nga **FITIM DIKA**

Ishte fundjava e parafundit e 2022 dhe, tre miq, duke shfrytëzuar kohën e kthjellët me diell, temperaturat e larta dimërore dhe shkrirjen e borës në mbi 2000m lartësi mbidetare, dëshironin të bënin një udhëtim që ngjason shumë me një aventure, sado që ishin të përgatitur.

Një ditë më parë kishim marrë leje nga policia e Kosovës për të kaluar pa kontroll kufirin e mbyllur mes Strezimirit dhe Restelicës, sëbashku me Butrint Selën dhe Brezar Dibrën,u nisëmdrejt Korabit.

Ora ishte 9.00 ku të tre adhuruesit e maleve pimë një kafe në "Retro 2" të Dibrës së Madhe. Pasi blemë ca byrekë, me mish e me gjizë, u nisem drejt magjistrales së Mavrovës për të marrë kthesën drejt Strezimirit. Herë pas here shfaqej frika se pas shirave të rrëmbyeshëm të mesdhjetorit, rruga nga Strezimiri për në Restelicë mund të ishte mbyllur edhe falë natyrës, përveç edhe falë shtetit që nuk mund ta mirëmbajë dhe asfaltojë. Megjithatë, fati ishte me ne dhe rruga përtej gropave me baltë dhe disa gurëve të rënë përgjatë rrugës, mes bukurive përrallore dhe të qeta skajshmërisht, duke mos parë as edhe një polic dhe udhëtar rasti, arritëm në kufirin mes Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.

Ishte momenti për të kaluar kufirin dhe pas 1km fillonte asfalti, i cili, ishte shtruar me aq delikatesë në këtë zonë të humbur dhe në zgrip të Kosovës, por mjaft të bukur mes Dibrës dhe Prizrenit. Falë vullnetit të mirë të policisë së Kosovës dhe qeverive të Kosovës, ky udhëtim shkoi aq për së mbari. Ishte policia e Kosovës që reagoi menjëherë për dhënien e lejes së qarkullimit në territorin e saj, përkundër që kolegët e saj në Tiranë e Shkup duhet me mijëra herë lutje e administratë, dhe ishte qeveria e Kosovës që falë asfaltimit të rrugës malore në Restelicë deri në kufi me Maqedoninë Veriore, i jepte hijeshi udhëtimit tonë të admiruar.

KOSOVË


U ndalëm pak në brendësi të territorit të Kosovës, ku përveç asfaltit kishte edhe shumë kroje të reja të ujit të kristaltë, dhe ku nga një vend dukej maja e Korabit të madh, Piramida që simbolizon trekëndëshin kufitar mes Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, si dhe shtëpinë cilindrore që dukej me dylbinë në Majën e Titos. Vend mahnitës, falë diellit dhe ajrit të pastër në lartësi 1920m.

"Dashuria ndaj natyrës është dashuri që nuk të zhgënjen kurrë", - thoshte Balzaku, që i shkonte përshtat këtyre tre dashamirëve të maleve.

NGA RESTELICA NË SHISHTAVEC

Pas një ndalese të shkurtër në këtë peizazh, tre të rinjtë me arushën e maleve, Jeep Grand Cherokee, nisen drejt Restelicës, ku ndaluan për një kafe rasti. Aty dëgjoheshin kamarierët që mes veti flisnin një gjuhë të përzier mes maqedonishtes dhe serbishtes. Nga Restelica nisen drejt fshatit Krushevë, që një rrugë majtas merrte përpjetën për kufirin e ri ndërkombëtar mes Kosovës dhe Shqipërisë. Dikur ky kufi ishte vetëm për banorët vendas të Dragashit, kurse tani funksionone edhe për banorët tjerë. Kaluam pa problem kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë dhe menjëherë djathtas ndodhej "Parku i Aventurave"- Shishtavec, i promovuar disaherë në rrjetet sociale të kryeministrit Edi Rama. Ishin thjesht të ndërtuar tre shtëpi të vogla dhe disa rrjeta për të ushtruar ngjitjet dhe dukeshin si ushtrime të lehta të rekrutëve fillestarë. Aty të kujtohet sesa të etur janë për reklamë disa politikanë.





Në fund erdhëm aty ky filloi. Një rrethrrotullim mjaft përrallor që i mungon vetëm pak investimi, ose për ta kryer duhet të kesh nerva administrative dhe një fuoristradë. U ndalëm në Retro2 dhe u përshëndetëm për këtë udhëtim që mund të kryehej përherë të parë pas shumë vitesh nga të rinjtë dibranë - legalisht.



Kosova duhet të falenderohet që asfalton rrugë në zgrip të maleve dhe nuk del qeveria me reklama pompoze, të falenderohet për policinë vigjilente që jep leje kur është nevoja për vizita turistike, kurse Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet të marrin mësim për këto çështje nga shteti më i ri.



KUKËS

Nga Shishtaveci me rrugën gjarpërore që tani merrte tatëpjetën nisemi drejt Kukësit historik. Rruga ishte mjaft e bukur dhe kjo vërehet edhe nga deklaratat e ambasadorëve të huaj në Tiranë. Çdokund ku kapte syri lart në bjeshkën e Shqipërisë, kishte ndonjë shtëpizë, apo ndokund edhe disa shtëpia. Tokë që ka mbetur e vetmuar vështirë që gjendet në Shqipëri, përkundër që nuk janë të asfaltuar si në Kosovë. Arritëm në Kukës, duke kaluar nën urën e Rrugës së Kombit. Në Kukës, përkundër emigrimit masiv, pamë plot të rinj kafeve dhe stadiumin që do e kishte zili edhe ndonjë vend europian. Tre miqtë dibranë pyetnin veten, pse Dibra, që ka po aq banorë sa Kukësi, nuk ka një stadion të tillë dhe as një qendër të tillë, aq më pak aeroport ndërkombëtar?!

Me siguri, kjo ndikuar edhe nga qeveria e Tiranës, që kësaj here kishte bërë diçka pozitive me rilindjen urbane.

RADOMIRË - PESHKOPI

Pasi hëngrëm drekë te Lugina e Drinit, treshja niset nga Kukësi drejt Peshkopisë për nga rruga me shumë kthesa. Kaluam Kolesjanin, Radomirën, Kastriotin dhe në fund në Dobrovë të Peshkopisë, u ndalëm për një kafe në "Street Bar" të Pajtim Vraniccit. Ai erdhi menjëherë, po sa mori vesht që tre miqtë e vjetër të Dibrës së Madhe ishin aty. Biseduan për malet dhe emisionet e fundit rreth maleve dibrane. Pajtimi tashmë më shumë ishte i fokusuar te motorët e skijimit që i jepnin më shumë adrenalinë.

DIBËR E MADHE

Në fund erdhëm aty ky filloi. Një rrethrrotullim mjaft përrallor që i mungon vetëm pak investimi, ose për ta kryer duhet të kesh nerva administrative dhe një fuoristradë. U ndalëm në Retro2 dhe u përshëndetëm për këtë udhëtim që mund të kryehej përherë të parë pas shumë vitesh nga të rinjtë dibranë - legalisht.

Kosova duhet të falenderohet që asfalton rrugë në zgrip të maleve dhe nuk del qeveria me reklama pompoze, të falenderohet për policinë vigjilente që jep leje kur është nevoja për vizita turistike, kurse Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet të marrin mësim për këto çështje nga shteti më i ri.

Ura që rënkoi për më shumë se gjysëm shekulli

Nga **SELMAN MEZIU**



Materie e ngurtësuar dhe shpirtërore. Ura - mjet lidhës. I dy brigjeve përrenjsh, lumenjsh edhe vijash uji. Lidhje miqësore, urë lidhëse në mes popujve, kulturave, traditave...

Ura e Çikut lidhte dy brigje. Shullanet, brigjet rreskore (shiste argjilore S.M.) e fisit Lala. Në mes i ndante lumi Murra. Emrin thuhet se e mori nga fshati Qafë Murrë, nga ku fillojnë damarët e kaltër me burimet e tyre të saj. Ndoshta, muri, muraja, murale, ndoshta nga disa të tillë. Por kemi edhe qen i murrëm, i thirrnim "murro"' lopë e murrme e thërrisnin "murre, murra". Mundësi tjetër është se në qafën e Murrës frynë veriu e që quhet murlan. Prandaj qafa është e zhveshur nga bimësia shkurrore e drunore. Koha e përkundi në tallazet e saja.

Ura fillesën e saj nuk e ka më shumë se 70 vjet, edhe pse udha e makinave Peshkopi-Burrel ka filluar aty rreth vitit 1935. Kur vjen nga lagjia Hoxhe, Prençe, Kurte, pa hyrë në urë, ka kaluar një vijë uji. Diku mbi atë ka qenë mateca (fillimi i vijës ku hynte uji në shtratin e Murrës) i vijës së mullirit të Zyber Hoxhës. Ajo, si ndërtesë, ka qenë e vendosur afërsisht në qoshen më lindore të parkut me plepa "Dine Doda".

Aty ku bashkohen udha këmbësore Fushë-Muhurr, shpella Zgjorgj, kroi i Heres, Bufull, ka qenë një çezëm, uji i pijshëm për banorët. I sjellë aty me tuba xinkati, e ndërtuar rreth viteve 1975. Marrë nga burimi, kroi në kurtin e Avdi Mëziut në Bushei. Të dyja këto u zhdukën në kohë të ndryshme. Tani i erdhi radha Urës mbi lumin Murra, e thirrur si "Ura e Çikut". Ndoshta ky emërtim erdhi ngaqë shtëpitë e fisit të tyre, zbritur nga Shqathi që i kishin në afërsi të saj.

Para viteve 1970 ajo ka qenë me këmbë e shtroje prej hekuri, si ato të urës mbi lumin Drini i Zi. Rreth viteve 1970-1975 u ndërtua ura prej çimentoje e hekuri. Nuk vonoi dhe lumi Murra i lëvizi njërën këmbë. Dhe në gjithë këto 10 vjeçar, ajo herë pas here e godiste fort, duke i prishur, herë këmbët e herë bazamentin. Deri sa prej shumë vitesh u kthye në gjysmë urë betoni, gjysmë urë me dërrasa e panela hekuri. Klima, koha po brente jetën e saj me ngadalë, si krimbi drurin. Derisa me datën 16 dhjetor 2022 i dha goditjen përfundimtare, shkatërruese. Edhe shteti, pushteti i krahinës së Muhurit, në dhjetë vjeçarët e Partisë së Punës edhe ky i demokracisë pas viteve 1990 e dinin dhe e përfytyronin se një ditë ky lum do të bënte hatanë mbi këtë urë kamthyeme. Ajo nuk u mirëmbajt dhe riparua kurrë nga ajo kohë deri sa vdiç.

U shprehëm kështu, sepse aty kanë lëvizur, ece e jake, nënat me fëmijë të vegjël mbajtur për dore; nxënës shkollash fillore, tetëvjeçare, të mesme, karroca me bukë misri e gruri, miell e grurë; fshatarë nga Selishta edhe me thesin e kripës e të miellit; mijëra makina me dru zjarri për qytetin e Peshkopisë, edhe makina me gurë, tulla, tjegulla, zhavorr e rërë; autobus e mikrobusa me banorë të moshave të ndryshme; kuaj, mushka e magjer me gjeth, bar, ngarkuar me dru zjarri e kashtë misri; tufat e dhive, lopëve e deleve. Një mizëri lëvizjesh në kohë e hapësira të gjëra. Gjithçka u shua, vërshimet e lumit Murra, shkatërruan urën, rrjedhimisht u shuan këto lëvizje që buisnin gjallëri, jetë.

Po sjellim një dëshmi mjaft kuptimplotë dhe kokë fortë, mbi të cilën duhet të nxjerrim shkaqet dhe të mësojmë. Lexojmë:

"Kompaktësimi 2018', FA rehabilitojnë 16 km rrugë rurale në Dibër, Xhaçka (Olta Xhaçka, Ministre e Mbrojtjes S.M.) u shpreh: "Ndihmojmë komunitetin nëpërmjet stërvitjeve."

"Forcat e Armatosura kanë nisur stërvitjen 'Kompaktësimi 2018', ku edhe testuan kapacitetet për reagime të menjëhershme në rastet e emergjencave civile. Njëkohësisht FA përmirësuan infrastrukturën rurale në zonë duke rehabilituar rrugën rurale nga Muhuri në Selishtë prej rreth 16 km. (Shqiptaria.com. 11 Nëntor 2018).

Shembja e kësaj ure me 18 m. gjatësi, 3 m gjërësi e 24 m lartësi (vërtetë ajo nuk është as 2 m lartësi, (S.M.) marrë në një hartë ushtarake botuar në vitin 1985), ka një varg gabimesh të mbledhura nyje. Që nga projektimi, me kambë me hapësira të ngushta dhe mjaft e ulët. Kjo rezultat i mos dijes, e mos matjes të prurjeve kulmore e me të ulta të prurjeve, mbi të cilat të mund të kryheshin llogaritjet e përmasave. Goditja e herë pas hershme nga prurjet e shumta të lumit Murra, nuk i "shqetësoi" pushtetin në bazë e deri në Peshkopi për t'a rregulluar e korrigjuar gabimet inxhinierike ndërtimore. Pas viti 1990 e njëjta situatë, veçse më e keqësuar. Kjo për arsye se koha po e shkallmonte nga që u prenë para kohe dhe pa baza silvotetknike pyjet e rinj të ahut në Pratin e Selishtës dhe kudo në përrenjtë, luginat e shpatet e ujëmbledhësit, deri dhe kurorat e gjelbërta të liqeneve të Kacnisë. Sigurisht, të gjitha këto janë të dokumentuara. Këto të çojnë rrjedhimisht në shtimin e prurjeve të lumit në fjalë. Sepse vetë pyjet, qoftë dushkajat apo pyjet trungishte ah, pishnaja janë një sfungjer biologjik natyral për reshejt e lëngëta e të ngurta e vërtetuar shkencërisht në shekuj.

Tanimë, vetë Fushë Muhuri, mbarë fshatrat buzëdrinas, kanë mbetur të vetmuar, të kërcënuar nga shpatat e qeverive të pas vitin 1990 që ua mbajnë mbi koka: ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Zhdukjen makabre të gjithçkaje. Populli jeton me frikë i trullosur. Atij i ka humbur e ardhmja në "Gijotinën e politikanëve shqiptar" e së fundi fatkeqësisht te qeveria "Rama 3", e cila ngulmon në këtë "mathauzen për pellgun e lumit Drini i zi". Kjo ka çuar, mendok unë, që edhe Arma e Xhenjos të Ushtrisë shqiptare dhe vetë Ministria e mbrojtjes të mbyllin sytë te ura e sakatosur mbi lumin Murra në Fushë-Muhur.

Ky kërcënim bukhenvaldian ka sjellë boshatisjen e fshatrave, bombarduar psikologjikisht e moralisht, fshatarë, bujqër e intelektualë në fshatrat buzëdrinas, natyrisht edhe muhurakët. Së shpejti një katastrofë e ngjashme e pret urën mbi lumin Drini i Zi me përmasa: 183 m e gjate, 3 m e gjerë dhe 15 m lartësia. Mjerisht, kësaj i ka mbaruar garancia prej 50 vjetësh, sepse ajo është përuruar në vitin 1946. Edhe ajo do të këputet diku. E fatkeqësitë e vuajtjet do të përlotin, gjakosin, muhurrakët, selishtasit, sinjanët etj.

Udhëzgjidhjet janë të shumta. Kundërshtimi me forcë e energji të reja në vazhdimësi i ndërtimit të pellgut ujëqelbur të Skavicës. Intelektualë, pushtetarë, opozitarë, i gjithë populli i krahinave të Muhurit, Katër Grykëve, Luznisë, t'i dërgoi peticione qeverisë të sotme për ndërtimin urgjentisht të urës mbi lumin Murra dhe projekte e plane për rindërtimin e urës mbi lumin Drini i Zi në Fushë-Muhurr. Vetëm të bashkuar e me veprime energjike duhet dhe mund t'i riparojmë e dalim nga dana e fatkeqësive që janë të pranishme sot e do të vijnë duke u shtuar në pafundësi.

Riparimi i përkohshëm me mbushje me zhavorre të urës së rënë në formë V është zgjidhje e përkohshme, e realizuar me datën 19.01.2023, se vete lumi Murra përsëri do të hakmerret, ndoshta me dëmtime edhe më të rënda.

Njoftim për shoqata dhe organizata joqeveritare

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre.

Kostot e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit të gazetës.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603** ose shkruani emailit:

rrugaearberit@gmail.com

Vetëm pak ditë më parë përfundoi në qarkun e Dibrës, një projekt i GIZ-it për bimët mjekësore. E kush më mirë se dy shkencëtarët e bujqësisë dibrane, Dali Horeshka dhe Zyber Gjoni, do ta merrnin përsipër një barrë të tillë. Daliu, ekonomist me përvojë dhe njohës i shkëlqyer i bujqësisë, kurse Zyberi, doktor shkencash, ish pedagog i universitetit studiues dhe grumbullues i bimëve mjekësore.

Bimët mjekësore, mundësi të reja të kultivimit

Nga **OSMAN XHILI**

Vetëm pak ditë më parë përfundoi në qarkun e Dibrës, një projekt i GIZ-it për bimët mjekësore. E kush më mirë se dy shkencëtarët e bujqësisë dibrane, Dali Horeshka dhe Zyber Gjoni, do ta merrnin përsipër një barrë të tillë. Daliu, ekonomist me përvojë dhe njohës i shkëlqyer i bujqësisë, kurse Zyberi, doktor shkencash, ish pedagog i universitetit studiues dhe grumbullues i bimëve mjekësore.

Në cilësinë e nëndrejtorit të bujqësisë për qarkun e Dibrës, për gjashtë vite rresht, kisha marrë pjesë në dhjetëra e dhjetëra trajnime të fermerëve nga fondacione dhe organizata të ndryshme. Disa të shkurtër, një ditore e të tjerë më të gjata, të shtrirë dhe në muaj. Në përfundim, disa nga lektorët dhe trajnuesit dilnin në konkluzione "shumë interesante". Dibra, sipas tyre, duhej të zhvillonte pemëtarinë dhe blegtorinë, gjëra për të cilat, as që nuk na kishte shkuar mendja më parë.

Trajnimi i kësaj radhe, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm rural, ndryshonte kryekëput nga shumë të tjerë të mëparshëm. Nuk erdhën fermerët tek trajnuesit, por këta të fundit shkuan në bazë. Nuk mbeti njësi administrative, pa u shkelur dhe gati çdo fshat u përfaqësua me vjelësit dhe kultivuesit më aktivë të bimëve mjekësore. Maqellara, Melani, Selishta, Arrasi, Fushë Bulqiza, Lura e shumë të tjera, u bënë stacione të ndalesës, të takimit, e bashkëbisedimit, të dy shkencëtarëve tanë me njerëzit, që vërtetë ishin të etur për të marrë dituri shtesë, në lidhje me bimët mjekësore. Po cilat ishin në të vërtetë përfitimet nga ky trajnim që zgjati gati dy muaj?

Dali Horeshka, njeriu që ka gati 40 vjet eksperiencë, që nga kooperativat e dikurshme dhe deri tek përvojat e shumta me fondacionet e huaja i bën publike shifrat. Ai tregon se u kryen mbi 20 takime gjithsej, me një mesatare prej 25 personash për çdo takim, duke e çuar në 500, numrin e përgjithshëm të atyre që morën pjesë. Po të llogarisësh që çdo person i trajnuar ka 2,4 pjesëtarë krahë pune në familje, ky numër shkon në 1200 persona.

Më tej ai vazhdon të tjera detaje të këtyre takimeve të shprehura në përqindje, duke paraqitur të dhëna vërtetë interesante. Në të gjitha takimet e organizuara, rreth 40 përqind e personave të trajnuar kanë qenë të rinj në moshë, 47 përqind e personave kanë qenë të kthyer nga emigracioni, kurse 20 përqind e personave të trajnuar kanë qenë gra. Në disa raste dhe në disa vende numri i grave ka shkuar në 70 përqind në Fushë Bulqizë dhe 50 përqind në Trepçë. 30 deri 70 përqind e familjeve në disa fshatra, grumbullimin e bimëve mjekësore e kanë si të ardhur bazë për familjet e tyre.

Të gjitha këto e të dhëna të tjera, që burojnë nga lapsi i mprehtë i shef Daliut, nuk janë të dhëna skematike, përpunuar, sa për tu mbushur mendjen drejtuesve të GIZ-it për efektivitetin e projektit në fjalë. Jo, ata materializohen në mesazhe shumë pozitive e shpresëdhënëse për ekonominë dibrane e më gjerë akoma. Ata tregojnë se në Dibër gjenden resurse të tilla, që mund të mbajnë në këmbë, familje të tëra, fshatra dhe zona të tëra, që ata të mos shpopullohen, por të shfrytëzojnë në mënyrë racionale ata mundësi e burime natyrore. Këto të dhëna tregojnë, që dhe vëmendja e të rinjve dhe grave është kthyer nga ky lloj aktiviteti, që në fakt e meritojnë një krye vendi, për nga të ardhurat që sjellin. Kështu shprehet, në mënyrë filozofike Daliu, që është dashuruar kaq shumë me këto bimë, aq të dobishme për ekonominë dhe shëndetin e njeriut.



Pamje nga një parcelë me bimë mjekësore aromatike në Dibër, e cila u mbështet financiarisht nga projekti "E ardhme e Qëndrueshme për Sharr/Korab-Koritnik". Foto: ***PPNEA.***

Po të mos ishte roli dhe kontributi i doktorit të shkencave, Zyber Gjoni, aktiviteti i studimit, grumbullimit dhe përpunimit të bimëve mjekësore në qarkun e Dibrës, ndoshta do të ishte sa gjysma e vëllimit të sotëm. Pata kënaqësinë ti kushtoj një faqe gazete këtij heroi, që aq shumë po bën më këtë drejtim dhe gjithnjë e më tepër mendoj se është shumë pak. Ai meriton një libër të tërë. Nëse dikur Dibra kishte heronj që luftonin me pushkë për mbrojtjen e kufinjve, doktori i shkencave, Zyber Gjoni lufton me mendjen e tij, me punën dhe përkushtimin, me sakrificat e tij, të zonjës së tij të nderuar dhe gjithë stafit të tij të përkushtuar. Dikush mund të thotë se ata po përpiqen thjeshtë për të rritur të ardhurat e kompanisë së tyre, por unë kam bindjen absolute, që kjo është vetëm një arsye, bile tani jo më e rëndësishmja. Gjithmonë shkencëtari ka sakrifikuar veten dhe familjen për ide të mëdha dhe për humanizëm. I dashuruar me profesionin e tij, ai trishtohej, kur shihte se një pjesë vjelësish e korrnin bimën e qershiglës, e njohur si boronicë, për të sjellë frutin e saj te magazinat e tij. Atë masakër mjedisore- mjekësore, që ai e shihte në moment, fshatarët do ta kuptonin vetëm dy tre vjet më vonë dhe do ti binin kokës me grushte. Një rast të tillë pati në fshatin e bukur të Ilnicës, dhe pasi bisedon me kryetarin e këshillit dhe me gjithë banorët, problemi u fut në rrugën e rehabilitimit. Duke e shfrytëzuar sipas kritereve të duhura e të njohura,do ta kishin përjetë këtë bimë të vyer, për të tashmen dhe për brezat që do të vijnë.

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se profesor Zyberi e kishte filluar që herët trajnimin e vjelësve, të cilët ishin pjesë organike e aktivitetit të tij. Sa herë që ata sillnin bimët mjekësore të vjela, duke i vlerësuar për punën e bërë, ai u thoshte ndonjë këshillë miqësore për ta bërë sa më mirë këtë lloj aktiviteti në të ardhmen. Gjatë takimeve të trajnimit ai kishte më shumë mundësi për ti thelluar këshillat e tij, deri në nivel shkencor. Ai u flet fermerëve se si të dallojnë saktë bimën, që realisht duhet vjelë, pa e ngatërruar me ndonjë tjetër të ngjashme. Sallat e takimeve u shndërruan në auditore shkencore, falë punës me projektor, me foto dhe pjesëmarrje masive.

U tregon se si nuk duhet ngatërruar murrizi i kërkuar me atë të ngjashmin, por që është i mbuluar me push, në frut apo në gjethe. Tek bima e Petasitas, apo Llapoi me kapelë, duhet vëmendje të mblidhet lloji me lule të kafenjtë dhe jo ai me ngjyrë të bardhë. Konfuzion mund të ketë dhe tek bima e Aguliçes, ku lloji i kërkuar është ajo me ngjyrë të verdhë në portokall dhe jo ajo me ngjyrë të bardhë. Ngatërresa të tilla, me apo pa dashje do të kishin pasoja të pariparueshme në të ardhmen. Kështu do të humbej besimi i kompanive të mëdha grumbulluese, por ca më keq akoma do të rrezikoheshin konsumatorët fundorë, ata që do të përdornin këto bimë, apo produktet e përpunimit të tyre.



Foto nga trajnimi i mbështetur nga GIZ

Profesor Zyberi ligjëron me të njëjtin seriozitet, që pati dikur si pedagog në sallat e universitetit. Ai u tregon për kohën optimale të pjekjes së frutit që dëshirojmë. Tek trëndafili i egër (Rosa Canina), fruti duhet ketë arritur ngjyrën e kuqe, por as nuk duhet të jetë i qullur, ta ketë kapur brryma. Rrënjët e bimëve zakonisht mblidhen në fazën e qetësisë relative, pra kur të ketë mbaruar aktiviteti fiziologjik, që zakonisht përkon me fundin e vjeshtës.

Shumë të rëndësishme janë dhe rekomandimet për vendin dhe mënyrën e tharjes. Kjo procedurë duhet bërë në hije, pra një tharje graduale, për të mos shkatërruar ingredientët e rëndësishëm mjekësorë, që përmban bima. Vendi për tharje duhet të jetë i rrethuar, me pamundësi hyrje dhe ndotje nga kafshët dhe shpendët, mundësisht duke vënë kompensatë poshtë materialit për tharje. Jo pak i rëndësishëm është dhe hapi tjetër, ai i amballazhimit. Duhet futur në thasë të pastër, pa u ngjeshur, pasi ndodh ndezja e masës gjethore, apo lulore.

Profesor Zyberi ndez një dritë të kuqe, një sirenë alarmi për disa specie bimësh mjekësore në zhdukje. Përdorimi i kmesës, prerja e degëve, apo gjithë bimës tek dëllinja dhe tek bimë të tjera, do të ishte katastrofale. Do të duhen më pas, jo më pak se 20 – 30 vjet për tu rigjeneruar bima në fjalë. Po kështu, mbledhja e rrënjëve dhe kriteret e tjera jokorrekte të grumbullimit, i asgjësojnë bimët mjekësore, duke i futur në listën e kuqe dhe ca më keq akoma, në zhdukje totale. Është pikërisht njeriu, që me ndërgjegjen, idetë dhe punën e tij e shmang këtë fenomen dhe garanton vijimësinë e shfrytëzimit të tyre.

Problemet me bimët mjekësore janë të shumta e të panumërta, por profesor Zyberi nuk mund të qëndrojë pa ndarë me vjelësit dhe një ide shumë të rëndësishme. Ai don që vjelësit e bimëve mjekësore, partnerët e tij strategjikë, të mos kenë vetëm këtë status, por të bëhen dhe fermerë, pra kultivues të bimëve mjekësore. Kultivimi i tyre e zgjeron shumë gamën e llojeve, sasinë e grumbulluar dhe për pasojë, sasinë e parave në xhepat e njerëzve, duke e shndërruar Dibrën në një potencial të madh eksportues të bimëve mjekësore. Të shumta janë llojet e bimëve që mund të kultivohen. Sherebela, Ciani, Mëllaga, Aguliçja, Shtogu e shumë të tjera, presin që fermerët ti fusin në projektet e punës së tyre në vitet në vazhdim. Kjo gjë nuk është utopi, por në disa raste i realizuar në praktikë .Është viti i dytë që fermeri Rexhep Ilnica po punon me bimën e cianit, duke realizuar jo pak të ardhura në një sipërfaqe prej gati pesë dynymësh. Bedri Topuzi ka punuar me mëllagën, Atli Mani me Aguliçen, kurse Avdi Puci në Venisht të Sllovës ka mbjellur dy hektarë me shtog. I kthyer nga Italia, ai po përpiqet të japë një model, se Italinë e kemi këtu, se dhe këtu punohet e jetohet, kur kemi vizion e përkushtim.

Tani është radha e vjelësve, e fermerëve, që këto këshilla, këto mësime të vyera të këtyre dy shkencëtarëve, që për fat i kemi në Dibër, ti venë në zbatim, për të pasur suksese akoma më të mëdha në të ardhmen.

ME RASTIN E 75-VJETORIT TË MINIERËS SË KROMIT BULQIZË,1948-2023.
Rrugëtimi profesional i një minatori

Shefqet Duriçi, novatori e muzikanti i shquar në Bulqizë



Nga **BASHKIM LAMI**

Në fisin Duriçi në Vajkal me traditat më të mira patriotike, dallohej në vite përpjekja për të jetuar me dinjitet duke punuar, por më veçanërisht në këtë shkrim do të sjellim një familje zanatçinjsh në disa breza. Shefqet Duriçi ka lindur më 1942 në Vajkal Bulqizë në një familje zanatçinjësh dhe të përkushtuar ndaj punës, babai i tij Asllani dhe xhaxhai Arifi kanë qenë mjeshta të ndërtimit të shtëpive bashkë me Ismailin e Selmanin, por edhe të punimit të orendive shtëpiake, për të jetuar me ndershmëri dhe për të arritur objektivat për të edukuar e shkolluar fëmijët, që të bëhen të zotët për jetën e tyre. Le të njihemi me disa nga aspektet e jetës së Shefqetit në periudha e vende të ndryshme, që na tregojnë rrugën e rritjes së tij profesionale në fusha të ndryshme. Shkollimin fillor e mori në vendlindje dhe atë 7 vjeçar në qytetin e ri të Bulqizës në shkollën e natës si mundësi e vetme në atë kohë. Kur Shefqeti ishte14 vjec filloi të bënte punë të ndryshme me dorë me llamarina dhe familja u bindën se ai ka aftësi të veçanta për të bërë shumë lloj punësh. Babai tij, Asllani i sjell një ditë sahatin e xhepit të mikut të tij, Dile Marini, që ishte i prishur dhe Shefqeti arriti ta riparoj e sahati punoi shumë në rregull. U kënaq vetë Shefqeti, po ashtu u kënaq i ati dhe miku i tij. Kur bleu një sahat dore tip "roskop", Shefqeti dhe vëllai i tij Zeneli i morën lejë të atit dhe e hapën e mbyllën disa here, deri sa arritën të mësojnë rradhën e çmontimit të pjesëve dhe e montonin përsëri e kthenin në gjendje pune.Edhe vëllai vogël Esati i ndoqi i përqëndruar në këtë aksion. Me këtë përpjekje vëllezërit arritën të aftësohen e të njohin ndërtimin e funksionimin e sahatëve. Kur ishte në punë motorist në "kompleksin 41" arriti të ndërtoj një sahat xhepi krejt me punë dore. I është dashur rreth një vit, që u aftësua për të riparuar orat. Jeta e Shefqetit dhe talenti i tij janë shumë interesante e mbresëlënëse, pasi kur ishte vetëm 15 vjeç arriti të krijoi ide novatore, që çuditën specialistët inxhinierë, sepse atëherë Shefqeti kishte vetëm 7 klasë shkollë. Ata nuk e dinin se ky djalë i ri me trup mesatar e shikim të përqëndruar, për të përvetësuar çdo këshillë dhe për të analizuar çdo ndodhi, apo pengesë që i dilnin në proceset e punëve, që shikonte rreth e qark në ambjentin industrial, ku punonte. Jeta e tij është mbushur me mbresa, sfida e arritje që e shoqëruan në punë e shoqëri, duke qenë i suksesshëm si ai.

SHEFQETI U RRIT ME PASIONIN PËR TË ZBATUAR TEORITË SHKENCORE NË PRAKTIKËN E PËRDITËSHME.

Shefqet DuriçI ka filluar punën në vitin 1957, kur ishte vetëm 15 vjeç dhe dukej se kishte pasion të jetë pranë makinerive, prandaj që në javët e para e caktuan motorist në galerinë 41. Në vitin 1958, Shefqeti shikonte me vëmendje, se si punëtorët i shkarkonin ca kosha metalik të mbushura me krom e të varur me dy rrotulla në një kavo çeliku, ku lëviznin me shpejtësi lart e poshtë. Fillon të mendojë nëse këtë punë të punëtorëve, a është e mundur të bëhet automatike, që veprimi i shkarkimit të karrelave të teleferikut, që transportonte mineralin e kromit nga Zona e "I" tek rruga automobilistike në qytet, të kryhej më shpejt. E mendon dhe e skicon idenë deri sa arrin të bindet, se ja arriti qëllimit. Shokët e punës e pëlqyen idenë e Shefqetit dhe sapo vjen inxhinieri i tregojnë për këtë. Në debatin teknik Shefqeti e bind inxhinierin për idenë e tij dhe më pas këtë ide e mësuan edhe specialistë në ndërmarrje, ku ishte një komision, që shqyrtonte idetë për shpikje e racionalizime, që drejtohej nga inxhinieri Halim Alihasani, i cili ishte edhe kryetar i degës teknike. Në këtë komision ishte kryetar Fadil Ngjelina, inxhinier energomekanik. Në këtë komision shqyrtoheshin shpikjet për mekanizimin e proçeseve, që sillnin edhe leverdi ekonomike për ndërmarrjen. Duke spikatur aftësitë teorike e praktike të Shefqetit, Fadili e bën Shefqetin 17 vjeçar anëtar të këtij komisioni pranë drejtorisë së ndërmarrjes në vitet 1958 – 1959.

I riu pasionant Shefqeti propozon në komision shpikjen tjetër, se si mund të ndizeshin në mënyrë automatike dritat e kampit të burgut edhe kur mungonte personi i ngarkuar me këtë detyrë, që në atë kohë ishte Ramiz Basha nga fshati Dragu. Në këtë kohë Dhimosten Malo, drejtor energomekanik në Ministrinë e Industrisë e Minierave Tiranë, njihet me projekt idenë e Shefqetit dhe i kërkoj që ta mbronte këtë ide, se si e realizon ai çdo hap të këtij novacioni që ishte një skemë mjaft e ndërlikuar, por Shefqeti e mbrojti idenë e tij me sukses. Kjo ide nuk gjeti miratim për tu zbatuar edhe pse qëndronte teknikisht, për arësye të rregullores së sigurimit teknik, që kërkonte, se cili person do të mbaj përgjegjësi në rast difekti të paisjes. Dhimosteni bashkë me drejtorin Sinan Xhemili e Tosum Spahiun, duke parë aftësitë e Shefqetit vendosën ta propozonin në ministri, që ta dërgonin atë, për tu specializuar në BS, por në ato ditë ndodh prishja e marrëdhënjeve dhe u kthyen nga BS edhe studentët që ishin atje me studime, atëherë kjo mbeti për Shefqetin vetëm një ëndërr,

Pasi kthehet Shefqeti nga ushtria në vitin 1962 në Bulqizë, ka kërkuar të filloj riparues orash në ndërmarrjen e shërbimeve, pasi këtë aftësi e fitoi qysh në vegjëli. E dërgojnë në Peshkopi tek dyqani i orëndreqësve, ku ka dhënë provat me orëndreqësin Qemal Rustani. Është kthyer në Bulqizë dhe ka hapur dyqanin e riparimit të sahatëve, ku ka punuar dy vite.

Shefqeti kishte pasion edhe muzikën dhe ka blerë një fizarmonikë të shkatruar që e rregulloi vetë gjithë tastot dhe filloi të luaj pjesë të thjeshta, pastaj Ai bleu fizarmonikën e vogël Hazis Camit dhe me atë ka studjuar partitura dhe arrin të luaj pjesë popullore, të këngëve të lehta, vallëzimet, tango, rumba, valse, etj dhe për afër një vit ai është aftësuar në këtë instrument dhe ka filluar të marrë pjesë në aktivitetet artistike në Bulqizë.



PROFESIONIST I SHQUAR BËHESH, KUR KE PASION PËR TË STUDIUAR E PUNUAR ME VULLNET E DASHURI, PËR TË GJETUR ZGJIDHJE TË REJA TË PROBLEMEVE.

Në Bulqizë qenë ndërtuar çentrali elektrik diezel 1250 kilovat/orë dhe afër tij edhe ofiçina, ku u vendosën dy torno, një trapan bango, një frezë, reparti i saldimeve e kovaçanë. Shefqeti fillon punën në vitin 1964 në ofiçinën e minierës në fillim axhustator, dhe për pak muaj ai mësoj të punoj në të gjitha makinat, si tornitor, frezator, pra ishte një mekanik talent që "çfarë i shihte syri, ja bënte edhe dora". Këto mjeshtri ai i kishte njohur në sajë të pasionit që kishte gjatë kryerjes së punëve, që ju bënte analizë të hollësishme situatave problematike profesionale me specialistët e asaj kohe, si përgjegjësit e ofiçinës Encio Xhimitiku, Ilia Kocaqi e më pas Faik Shehu. Ata ishin mjeshtra të vërtetë për kohën, por për tu marrë zanatin nuk ishte e lehtë, sepse duhej tu rrije pranë dhe ti shikoje me vemendje, se si ata i përdornin mjetet e punës e makineritë që kishte në atë kohë ofiçina. Ai shikonte me kujdes çdo veprim të tyre në punët mekanike e elektrike gjatë shërbimeve të përditëshme. Në atë kohë në ofiçinë punonin tornitor Osman Lala, Dilaver Spahiu, Vebi Konesha dhe Esat Keta, axhustator Lutfi Loka, në kovaçanë Rexh Toluli e vëllezërit Arif dhe Kadri Selmani, etj. Shefqeti krahas punës studionte vetë në librat e fizikës dhe manualet mekanike dhe elektrike, që i binin në dorë, si dhe në librat që shoqëronin makineritë sovjetike apo kineze që i sillnin dhe i montonin në sektorët e minierës.

Sapo në Bulqizë më 1967 u hap shkolla e mesme e natës, Shefqeti dhe disa të rinj të tjerë u regjistruan menjëherë, për të vazhduar këtë shkollë. Në shtator 1968 shkolla u kthye në profesionale me tre degë, miniera, gjeologji dhe elektromekanike dhe Shefqeti regjistrohet në atë degë që lidhej edhe me punën që bënte, sepse e ndihmonte në ngritjen e nivelit teorik dhe profesional.

Në vitin 1969 Shefqetin Komiteti Ekzekutiv i rrethit Dibër e caktojnë të punoi në ofiçinën NBSH Peshkopi, ku Xhetan Xhika e aktivizoj të punonte në fillim saldator, por Shefqeti ndiqte me kureshtje çdo proçes pune që bëhej aty, si në ofiçinën e minierës në Bulqizë.

Në Peshkopi Shefqeti është marrë edhe me muzikën, pasi qysh më herët në Bulqizë arriti të mësoj me vullnet përdorimin e fizarmonikës. Ai kishte aftësi për ti luajtur pjesët muzikore me shumë saktësi dhe lëvizje shumë të shpejtë të gishtave. Bashkëpunimi me kompozitorin Tonin Rrota, muzikantin e estradës Lahim Kola dhe këngëtaren Melita Shehu, bëri që ai të realizoj me sukses shumë pjesë muzikore. Në vitin 1969 në Peshkopi është organizuar një konkurim i estradave amatore të disa ndërmarrjeve të rrethit. Shefqeti këtu ka qenë drejtues artistik dhe fizarmoniçist i ansamblit amator të SMT-së e NBSH-së. Gjatë verës ka punuar në Peshkopi fizarmoniçist me orkestrën që luante muzikë në lulishtën verore "1 Maj" dhe për disa kohë edhe me orkestrën e hotel "Korabi" në Peshkopi.

Në vitin 1971 Shefqeti rikthehet në Bulqizë dhe fillon punën elektromekanik në Fabrikën e Pasurimit të Kromit që sapo kishte nisur prodhimin e koncentratit. Gjatë kësaj kohe Shefqeti përfundon shkollën e mesme për elektromekanik dhe është regjistruar për të vazhduar shkollën e lartë me korespondencë në degën e fizikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të UT, por vështirësitë e mëdha të punës e penguan të plotësoj këtë objektiv, megjithëse tekstet e fizikës, manualin e metalikës në dy pjesë, detale makinash me autorë sovjetik, teknologji mekanike, rezistencë materiale, etj, i kishte studjuar prej shumë kohësh, për të njohur teoritë e fizikës, që i duheshin, për të kuptuar disa proçese teknike, që i dilnin përpara në praktikat e punëve të përditëshme.

Në vitet 1973 – 1974, kur Jaho Fasliu ka qenë kryetar i Bashkimeve Profesionale e morën Shefqetin në shtëpinë e kulturës, ku përgjegjëse ishte Tefta Rusi e më pas Bajram Kola, ndërsa Liman Okshtuni ishte operator i filmit në kinema dhe Shefqeti e zëvëndësoi Limanin për shfaqjen e filmave për një kohë. Shefqeti këtu ishte drejtues artistik i orkestrës dhe pregatiti ansamblet popullore e estradën dhe drejtoj një kurs katër mujor, për pregatitjen e muzikantëve të rinj Azem Teta, Selman Selmani, Ferit Shehu, etj, me mësime teori e praktikë në fizarmonikë. Në shtëpinë e kulturës Shefqeti vazhdoj deri kur erdhën me punë në kinoklubin e qytetit, drejtor Hysen Dërvishi regjizor dhe Xhelil Ymeri kompozitor. Shefqeti e ka vazhduar përdorimin e fizarmonikës deri në vitin 1985.

Shefqeti rikthehet përsëri me punë në Fabrikën e Pasurimit të Kromit në ofiçinë, përgjegjës i repartit elektromekanik, ku i gjithë grupi i specialistëve kishin detyrë, që të mirëmbanin makineritë e fabrikës. Shefqeti edhe këtu ku ai ka punuar për një kohë të gjatë ka shfaqur në vazhdimësi ide novatore për të zgjidhur problemet në rastet e vështirësive që çfaqeshin në repartet e fabrikës. Në 17 vjet nga 1974 – 1990 Shefqeti ka drejtuar kurset e kualifikimit të fabrikës, për mekanikë, elektriçistë, xhenerikë, saldatorë, hidraulikë, etj, që vazhdonin për 4 muaj, një herë në dy vjet dhe merreshin në prova për të

intervistë



mbrojtur kategorinë profesionale. Shefqeti ka qenë zv/kryetar në komisionin e fabrikës dhe të minierës që merrnin në prova kategorizimi specialistët e këtyre fushave.

NOVATORI QË NGRITI LINJAT E REJA TË PASURIMIT TË KROMIT.

Në vitin 1996 – 2006 Shefqetin e kanë emruar kryetar i degës energomekanike të fabrikës, pra 10 vjet. Shefqeti arriti me këmbëngulje të bëj një studim shumë të rëndësishëm për të rritur efikasitetin e përpunimit të mineralit. Ai vuri re se në mineralin, që dilte nga repartin i coptimit, rreth 45% e Cr2O3 do futej në bluarjen e imët me 0-2mm edhe një sasi e madhe e pluhurit, që ishte i përzierë me mineralin e copëtuar, duke kaluar më pas në proçes pasurimi në makinat e sedimentit dhe pjesa tjetër kalonte për pasurim të mëtejshëm tek tavolinat gravitacionale. Grupi teknik i udhëhequr nga Shefqeti menduan që duhej shoshitur minerali, që vjen nga makinat e copëtimit dhe të ndahej klasa e pluhurit 0-2mm, për të kaluar direct në makinat e sedimentimit, pasi kjo pjesë e mineralit përbënte 20% të sasisë. Me këtë ndërhyrje teknike e teknologjike u rrit kapaciteti përpunues i fabrikës me 20%, si dhe arrihej përmirësimi i treguesve (rikuperimi) dhe ulej përqindja e mineralit të dobishëm, që shkonte bashkë me sterilin.

Drejtori Martin Cukalla ngriti grupin teknik të linjave të reja, ku Shefqeti u caktua të jetë drejtuesi i këtij grupi, ku ishin edhe Faik Dufi, Sazan Bajrami e Esat Duriçi. K/inxhinieri Bujar Pata ngriti problemin, nëse shpikja që u realizua më parë me sukses tek fabrika e pasurimit të mund të ndërtohej edhe në "kompleksin 41" të impiantit të seleksionimit të kromit, ku pluhuri që shoqëronte gjithë mineralin të mund të ndahej e të mos shkonte në stoqet e sterilit. Për analizën granulometrike u caktua inxhinieri gjeolog me përvojë Jorgo Kola, i cili ka nxjerrë të dhënat teknike të mineralit të ndarë në disa klasa, nga 0-300mm, në përqindje të sasisë së përgjithëshme në çdo klasë dhe të cilësisë në çdo klasë. Studimi nxorri se pasurimi i mineralit me shoshitje dhe makinë sedimentimi ka interest ë madh. Për këtë u ngrit linja e re, që u ndërtua nga specialistët bulqizakë, në zbatim të këtij studimi, që solli rritje të sasisë së mineralit koncentrat, që më parë shkonte dëm në sasi të konsiderueshme e shkarkohej me sterilin. Kjo shpikje për kohën ishte shumë e rëndësishme dhe me vlera të mëdha ekonomike. Më pas kjo shpikje u zbatua edhe në fabrika të tjera pasurimi në disa miniera të vendit tonë.

Pas prishjes me kinezët më 1977 në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë u krijuan vështirësi të mëdha të mungesës së bazës materiale dhe të pjesëve të këmbimit që duheshin për zëvëndësim për shkak të konsumimit në makinat e punës. Grupi i novatorëve në fabrikë të drejtuar nga Shefqeti, arritën të prodhojnë sitat 600x900 mm që u realizua në vend dhe këto sita u përdorën me sukses në fabrikën e pasurimit në Bulqizë dhe në Kalimash Kukës. Në projektimin e shtresave të sitave 600x900 mm parapriu projektimi dhe ndërtimi i makinës së profilimit trapezoidal 2x3x8 mm me temperature 600oC të telit çelik 65 Mn, 6mm, ku si specialist në përdorimin e kësaj makine shërbeu saldatori me përvojë Sazan Bajrami. Në vitin 1979 Shefqeti caktohet nga Ministria e Industrisë e Minierave drejtues i punimeve të montimit të Fabrikës së Pasurimit të Kromit në Kalimash Kukës, deri sa u vu në shfrytëzim.

Në vitin 1987 komisioni shtetëror i MIM Tiranë i jep Sheqet Duriçit titullin "Mjeshtër Elektrik". Po në këtë kohë mjeshtri Shefqet DuriçI ka qenë anëtar i këshillit shkencor të ministrisë dhe pjestar i grupit të ngritur nga MIM Tiranë, për studimin e projektimin e briketimit të pluhurave të kromit, që u bë me iniciativën e zv/ministrit të MIM Martin Cukalla, i cili njihte me detaje problemet e pasurimit të kromit. Ky grup vazhdoi për shtatë muaj në realizimin e këtij studim – projektimi. Në këtë grup që funksiononte pranë ISPTMinierave Tiranë kanë qenë edhe Liko Ismaili nga Vlora, inxhinier metalurg në Uzinën e Ferrokromit Burrel dhe ish pedagog në degën metalurgji të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UT, si dhe inxhinier elektrik Man Gjongecaj nga Tropoja, dhe një inxhinier teknolog i ISPTM.

Me urdhër të ish zv/ministrit të MIMinieraTiranë Faik Çinaj në harkun kohor të viteve 1980 - 1990 mjeshtrin Shefqet Duriçin e kanë caktuar të drejtoi punimet në disa raste avarish të rëndësishme në fabrikat e pasurimit të kromit në Krastë, Kalimash, Kukës, Uzinën Ferrokromit Elbasan dhe Fabrikën e Pasurimit Hekurnikelit Guri i Kuq Pogradec, ku në këtë të fundit, me venien në punë të fabrikës, ish përgjegjësi mekanik Pasko Pano dhe drejtuesit kryesor të asaj fabrike e kanë falenderuar publikisht për mjeshtrinë e kapërcimit të asaj avarie të rëndë.

Shefqeti falenderon dhe thekson se, për inkurajimin e ideve novatore mbështetës të veçantë kanë qenë drejtuesit Prof. Asooc Dr. inxhinier miniere Martin Cukalla dhe inxhinieri pasurimit mineraleve Bukurosh Koçi. Kontribute të rëndësishme në grupin inovator kanë dhënë edhe vëllezërit Mustafa dhe Naim Kajnozi. Në vitet 1990 u pregatit edhe projekti i ngritjes së ofiçinës qëndrore të riparimit të fadromave në shkallë vendi, por ngeli pa u zbatuar për shkak të reformave të thella në administratën shtetërore nëpër institucione e ndërmarrje në gjithë vendin tonë. Arritjet e mjeshtrit Shefqet Duriçi janë vlerësuar me çertifikata distingtivë e urdhëra të lartë të punës nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të RSH

Mjeshtri duarartë Shefqet Duriçi ka rritur pesë fëmijë Viktorin, Arbenin, Suzanën, Artanin dhe Klodianin të cilët janë shkolluar dhe bërë zanatçinj në profesione të ndryshme për të përmbushur jetën me sukses. Ai sot është në pension dhe jeton në Tiranë, por çdo ditë vëmëndja e tij mbetet e përqëndruar si atëherë, kur ishte në krye të punëve, që kërkonin zgjidhje.

Tiranë, më 20 janar 2023

OPINION

Pse mungon një nga "Nandë Malet" e Dibrës në Memorialin e Gjoricës

Injorimi i historisë së një zone, si ajo e Muhurrit, që i ka dhënë kombit heronj dhe personalitete të shquara, si gjeneralët e Skëndërbeut, Nikollë e Dhimitër Berisha e deri te mendimtari e prijësi popullor Dine Hoxha, një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog, përbën një akt absurd të realizuesve dhe promovuesve të Memorialit të Gjoricës

Për të qenë të saktë, autorëve të këtij memoriali si dhe autoriteteve lokale të Dibrës që e kanë miratuar dhe promovuar atë, do t'ju mjafonte qoftë edhe referenca nga "Historia e Dibrës" e historianit të mirënjohur, akademik Kristo Frashëri, botuar 10 vjet më parë.



Nga **Halil RAMA***

Përjetësimi i historisë në vepra arti gjithnjë ka patur pritshmëri të lartë nga publiku. Kjo, gjithnjë kur ato kanë pasqyruar realisht lufrat heroike për liri e pavarësi të popullit tonë në shekuj, një prej të cilave, siç dihet është edhe Lufta e Gjoricës e Korrikut 1844 kundër ekspeditës turke të komanduar nga Hajredin Pasha.

Për vetë qëndrësën heroike dhe masive, heronjtë, dëshmorët, terrenin, motin dhe gjithçka tjetër, ajo betejë e pagëzuar me emrin "Lufta e Gjoricës"ose "Lufta kundër Hajredin Pashës", është cilësuar nga historianët si ndër më të egrat, më të përgjakshmet, më të pabarabartat në historinë e popullit tonë, afro 400 vjet pas vdekjes së Skëndebeut. Kësaj beteje të lavdishme të kryengritësve dibranë, siç dihet i parapriu Kuvendi i Nandë Maleve të Dibrës.

Nuk do të ishim marrë shumë me faktet e pamohura historike, nëse 179 vjet më vonë, autoritetet lokale të Dibrës do të inauguronin bujshëm në Gjoricëmemorialin me titullin "NËNTË MALET E DIBRËS", ku çuditërisht në të shkruhet se malet ishin: Çidhën, Luzni, Katër-Grykë, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, Mali i Reçit, Mali i Dardhës dhe Bulqiza (edhe kjo renditje, jo sipas asaj të pasqyruar në dhjetra libra të historisë së Dibrës). Pra dalin 8 dhe jo 9 Male, duke u lënë jashtë Mali i Muhurrit.

Për të qenë të saktë, autorëve të këtij memoriali si dhe autoriteteve lokale të Dibrës që e kanë miratuar dhe promovuar atë, do t'ju mjafonte qoftë edhe referenca nga "Historia e Dibrës" e historianit të mirënjohur, akademik Kristo Frashëri, botuar 10 vjet më parënga Shtëpia Botuese "M&B"në bashkëpunim me bashkinë Peshkopi.

Mbështetur në veprën "Dibra në udhën e historisë" të etnografit të mirënjohur dibran Hazis Ndreu-Nderi i Kombit,historiani K. Frashëri, ndër të tjera, shkruan se: "Sipas traditës gojore, Kuvendin e Gjoricës e kryesoi Sheh Mustafa Zerqani.Në të morën pjesë krerët e 'Nëntë Maleve'. Ndër pjesëmarrësit e Kuvendit kanë arritur në ditët tona nëpërmjet këngëve popullore vetëm emrat e pesë krerëve – ato të Cen Lekës dhe Salë Markes nga Gryka e Vogël, Ismail Kaloshi nga Çidhna, Nel Hoxhës dhe Abaz Pirës nga Muhurri". (Fq.218). Më pas po në këtë faqe renditen krerët e Nëntë Maleve, sipas pleqësive, ndër të cilët, të dytët janë Pleqtë e Muhurrit: Zejnel Hoxha (Hurdhë), Mustafa Lala (Shqath), Ibrahim Kaleshi (Vaimadh), Demir Lleshi (Bulaç), Josuf Lika (Shqath). Ndërsa përsa i përket pjesëmarrjes në Luftën e Gjoricës kundër forcave turke të Hajredin Pashës, historiani Kristo Frashëri shkruan se: "Forcat e Luznisë, Muhurrit dhe Çidhnës, bashkë me forcat e maleve të tjerë, u vendosën pjesërisht në Gjoricë dhe pjesërisht në Veri të saj, me detyrë kryesore për të penguar kalimin e ushtrive turke nëpër Urën e Topojanit.".

Për pjesëmarrjen aktive të Muhurrit në Nandë Malet e Dibrës kanë shkruar me fakte edhe historianët e studjuesit e mirënjohur dibranë Moisi Murra, Fatos Daci, Sakip Cami (edhe unëlibrin "Muhurri, histori dhe psonalitete") etj.

Për praninë e Muhurrit si Mal në Nëntë Malet e Dibrës, realizuesit dhe promovuesit e Memorialit të Gjoricës, para se ta inauguronin atë, për të qenë sa më të saktë, mund t'i referoheshin hartës së publikuar në faqen 187 të librit të Prof.Kristo Frashërit "Historia e Dibrës".

Nëse për motivacionin e memorialit realizuesit dhe propovuesit e tij i janë referuar librit "Enciklopedia e Dibrës", të studjuesit të mirënjohur Fatos Daci – Mjeshtër i Madh (autor i më shumë se 60 librave),qoftë dhe me një vështrim të përciptë të kësaj enciklopedie, pa shumë vështirësi do të kishin mësuar edhe për renditjen e Nandë Maleve të Dibrës, ku padyshim, Muhurri vjen i katërti, pas Reçit, Dardhës e Çidhnës.

REAGIMI I ELITËS DIBRANE: "NJË PËRMENDORE ME DEBAT"

Studjuesi dhe historiani i mirënjohur Haki Pernezha, e konsideron këtë"Një përmendore me debat". Kjo sipas tij për faktin se kur ta shohësh më në hollësi, me keqardhje dallon, të paktën ngutje në "kompozimin" e pllakatës së vendosur në këtë përmendore. Ndër të tjera ai evidenton faktin se "Në pjesën ku renditen Malet mungon Muhurri. Kjo s'duhej të ndodhte. Përveç gabimit me Muhurrin, mendoj se edhe renditja e bërë është ndryshe nga çfarë jemi mësuar të dëgjojmë nga populli a të lexojmë. Zakonisht kur numërohen Malet respektohet vendndodhja e tyre dhe përmenden me radhë nga Reçi deri në Bulqizë ose anasjelltas".

Një përmendje e tillë, pa "rend" gjeografik, sipas tij krijon debate të panevojshme. Po ashtu, për faktin se në pllakatë, për Malet shkruhet se ato ishin forma organizimi shtetërore.., Pernezha argumenton se kjo thënie bie ndesh me qëllimin dhe funksionin e Maleve (apo Krahinave) të Dibrës. Pra, Malet e Dibrës nuk ishin forma shtetërore por ishin një realitet që Perandoria Osmane u detyrua t'i njohë me kohë.

Për mungesën e e malit të Muhurrit në këtë përmendore ka reaguar ashpër dhe Ing.Ylber Cami nga Gjorica. "Si banor i Gjoricës, vendit ku u zhvillua beteja më heroike e dibranëve, ju kërkoj falje banorëve të Muhurrit, që në këtë pllakatë nuk janë të përfaqësuar. Si dhe është tallje për mua dhe të gjithë gjoricarët që në atë pllakatë nuk është as emri i Gjoricës. Por, ju jap fjalën dhe besën që atë pllakatë do ta ndërtojmë më gjigante që të përfaqësojmë denjësisht të Nëntë Malet dhe të gjithë dibranët e rënë në fushë betejë për të mbrojtur vatanin",-shkruan Ylber Cami në rrjetet sociale. Ndërkohë sipas tij "Është fyerje e rëndë e heroit tonë kombëtar që të vendosësh "yllin"mbi shqiponjën e Skëndërbeut, ndërkohë që duhet të jetë përkrenarja e Skënderbeut. Ne duhet të jemi të parët që duhet ta ruajmë dhe trashëgojmë ".

(Vijon në faqen 20)

cyan magenta yelloë black

Në 95-vjetorin e lindjes:
Nga Dritëro Agolli, Moikom Zeqo, Kol Jakova, Xhezair Abazi, Bujar Kapexhiu, Xhafer Martini e Agron Tufa: Si e kanë vlerësuar Hazis Ndreun

"HAZIS NDREU: *i papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë"*



Nga **Halil RAMA***

E kanë quajtur "Ezopi i Dibrës", "Burri i Odës Dibrane", "magu", i cili me prekjen e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo shqiptari. Ndoshta si për askënd tjetër, për ish-partizanin e Brigadës së Parë Sulmuese dhe të parin drejtues vendor në Zall Dardhën ku ka lindur, koreografin e valltarin që me talentin e rrallë të të kërcyerit ka mahnitur jo vetëm publikun shqiptar por edhe atë rus në Festivalin e gjashtë Botëror të Rinisë e Studentëve në Moskë më 1957, për artistin, poetin, studjuesin dhe shkrimtarin e mirënjohur Hazis Ndreu - Nderi i Kombit, janë shkruar, botuar dhe promovuar bujshëm katër monografi. Dhe jo nga autorë të rastësishëm, por nga personalitete të mirënjohura të letrave, si: Prof.Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, Prof.dr.Ramazan Bogdani – "Mjeshtër Madh" – shkrimtar dhe studjues i etnomuzikologjisë dhe etnokoreografisë, Xhezair Abazi – shkrimtar dhe kritik i mirënjohur letrar dhe nga prozatori e poeti Xhafer Martini – ish-Kryetar i Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Dibrës.

I vlerësuar gjithashtu nga personalitetet kryesore të letrave e artit: Dritëro Agolli, Kol Jakova, Drago Siliqi, Moikom Zeqo, Bujar Kapexhiu, Ramazan Bogdani, Agron Tufa, Skënder Sallaku, Reshat Arbana, Luftar Paja, Agron Xhangolli, etj, si ikonë e artit e kulturës kombëtare, ky artist, studjues e shkrimtar me rrezatim mbarëkombëtar, këtë 1 shkurt do të festonte 95-vjetorin e ditëlindjes.

Pesëmbëdhjetë vjet më parë, (në 80-vjetorin e ditëlindjes) u realizua një spektakël madhështor në përkujtim të "Artistit të Meritуar" Hazis Ndreu. Skenarist, regjisor dhe prezantues, prof. Bujar Kapexhiu – "Nderi i Kombit", i cili pas disa vitesh do ta përjetësonte atë në veprën e tij monumentale "Burri i Odës Dibrane". Një spektakël për një artist dhe njeri të madh, ku interpretuan artistë dhe njerëz të mëdhenj të botës së artit, kulturës e shkencës.

Për të arritur deri te ky spektakël-show, Kapexhiut iu deshën muaj të tërë parapërgatitje…Dhjetëra takime me studiuesit e Institutit të Folklorit, prof.dr. Ramazan Bogdani, Agron Xhagollin, Skënder Sallakun, Skënder Calën, Inajet Shehun etj. Të gjitha takimet të monitoruara besnikërisht nga djali i madh artist i Hazizit, Avni Ndreu - "Mjeshtër i Madh" (drejtues dhe koreograf i Ansamblit Artistik që mban emrin e babait të tij), sipas të cilit: "Baba interesohej për të gjithë, të njohur e të panjohur, që ishin në hall apo që kishin ndonjë problem me zyrtarët. Interesohej për ata që hynin në burg, që i pushonin nga puna, për ata që s'kishin Triskë Fronti, për të futur dikë në shkollë, për vizitë te ndonjë mjek i zoti…. Ishte me një fjalë, derë e hapur për popullin, njoft e panjoft… e dinin që Hazizi të mbaron punë se është i njohur dhe e duan të gjithë… deri në Tiranë… te qeveria".

Po, i tillë ishte Hazis Ndreu 'magu', i cili me prekjen e tij magjike ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore,

DRITËRO AGOLLI: "Hazis Ndreu, miku im, mjeshtër i humorit dibran. Sot e kësaj dite si ai nuk gjen më. I papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë"

MOIKOM ZEQO: "Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian"

KOLË JAKOVA: "Hazis Ndreu asht ngritë mbi rapsodët aktualë të Veriut..Ai e ka nda çiftelinë dhe shkruan në frymën e Fishtës. Madje në disa konceptime epike Ai ma shumë pin ujë në Eposin e Kreshnikëve"

DRAGO SILIQI: "...Ky Hazizi i Dibrës asht me kryet tek Eposi i Kreshnikëve dhe Lahuta e Fishtës"

siç shprehet për të shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa.

PAK NGA AUTOBIOGRAFIA PËR "DOSJEN E KUADRIT"

Referuar autobiografisë së shkruar më 1954 për "Dosjen e Kuadrit", Xhezair Abazi, në librin «Ezopi i Dibrës» ndër të tjera na njeh me faktin se pasi kishte qenë dy muaj xhandar, në shtator 1944 Hazis Ndreu radhitet si partizan në Brigadën e Parë Sulmuese. Në kreun e I (Jeta) të këtij libri ndër më të kërkuarit nga lexuesit, Xh.Abazi i mirënjohur për kontributin madhor në fushën e kritikës dhe të studimeve letrare dhe që për 30 vjet (1979-2009) punoi në Lidhjen Shkrimtarëve, redaktor në «Drita », shef i sektorit të kritikës dhe botues në SHBL, shkruan se : « … Për vetë faktin që xhanadar ndejti vetëm 2 muaj dhe, në shtator rradhitet në Brigadën e Parë Sulmuese, mendoj se Hazizi po lëvizte jo thjeshtë për të siguruar jetesën e familjes. Një djalosh, që e kishte filluar 'jetesën' që 7 vjeç, tanimë duhet të zgjidhte rrjedhën e së ardhmes ». (fq.27). Dhe në të vërtet kjo do të ishte zgjedhja më e mirë e djaloshit që «nga mosha 7-16 vjeç u rrit duke punuar në dyret e botës, nëpër male, stërka, në borë e shi, duke fjetur në rrogoz, duke e zgjuar me këmbë dhe duke ngrënë çfarë u tepronte të zotëve », që sipas Xh.Abazit, do të thotë t'ia kalosh Oliver Tuistit.

Ish- partizani që mori pjesë në luftën heroike për çlirimin e Tiranës, (luftë ku ranë dëshmorë 3-4 djem nga Dardha) ndonëse vetëm 16 vjeç do të merrte pjesë në rrugëtimin e gjatë të kësaj brigade deri në janar të '46-ës kur e kaluan në Brigadën e Mbrojtjes së Popullit, dhe kur filloi të marrë rrogë si ushtarak efektiv. « Pesë vite të jetës së tij (16-21 vjeç) rrjedhin si partizan dhe ushtarak efektiv. Kanë qenë vitet kur i është lidhur ashti i trupit, por edhe ashti i shpirtit. Një fëmijë që e ka filluar 7 vjeç 'shërbimin civil' për ta vazhduar me pesë vite shërbim ushtarak. Për dy vite të tjera (1950-51) punon përsëri ushtarak, por këto në organet e Sigurimit të shtetit",-shkruan Xh.Abazi në librin "Ezopi i Dibrës", (fq.32). Më pas për dy vite (1952-54) Hazis Ndreu qe kryetar lokaliteti në Zall Dardhë, për të vijuar si Sekretar Komiteti në Shumbat kur Dibra u bë Qark dhe Shumbati rreth, dhe po në vjeshtën e atij viti (1954) e transferojnë shef të Fuqisë Punëtore të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Dibër.

HAZIS NDREUT I BURONTE MAGJI ARTISTIKE TËRË QËNIA E TIJ

Gjithsesi, Hazis Ndreu, fëmija i dytë i Halim Ndreut dhe Vaskë Barës, që kishte lindur në Zall Dardhë më 1 shkurt 1928, do të bënte emër e karrierë në fushën e artit e kulturës. Kështu në harkun kohor të tri dekadave (1957-1987 ai kryen më së miri funksione të rëndësishme si: Përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës Peshkopi; Drejtor i Estradës dhe Shtëpisë së Kulturës Peshkopi; Inspektor i Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit Dibër, si aktor, orkestrant e koreograf në Estradën Profesioniste etj. Ndërkohë gjatë këtyre viteve merr pjesë në Festivalin e Rinisë Rinisë Botërore në Moskë, ku midis 103 grupeve konkuruese fiton çmimin e tretë si valltar (1957), fiton çmimin e parë në Festivalin Kombëtar të Fjalës Artistike, me kryetar Jurie Kujtim Spahivoglin (1964) kur shkruan poemën "Dibrës time"; merr pjesë në turneun tre mujor të Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve në Kinë (1967); merr çmimin e dytë në konkursin kombëtar për poemën satirike "Ma kadalë, or Kapidan" (1969).

Dhjetë vite më vonë më 1979 i jepet titulli "Artist i Meritуar"; Më 1982 merr çmim të dytë për poezi satirike nga revista "Hosteni" dhe po atë vit, me Ansamblin "Kukësi i Ri" shkon në një turne një mujor në Kosovë, ku repertori i tij pati një pritje dhe jehonë të jashtëzakonshme.

Në vitet '80-të Hazis Ndreu ka qenë pjesë e turneut të Ansamblit Shtetëror të Këngëve e Valleve në Turqi…

Autorit të librit "Ezopi i Dibrës" do ti mjaftonte kjo karrierë e shkëlqyer artistike për të konkluduar se Hazis Ndreut i buronte magji artistike tërë qënia e tij.

KËNGËT E HAZIS NDREUT, KËNGË TË KRENARISË KOMBËTARE

Është i njohur tashmë, jo vetëm në metropolin shqiptar, por edhe në Stamboll, Ulqin, Shkup, Kërçovë, Strugë, Prishtinë, etj, Ansambli Artisik "Hazis Ndreu"- "Nderi

kulturë

AGRON TUFA: "... Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai".





ï Kombit", i cili, tre vite pas "pagëzimit me këtë emër" ka fituar dhjetra çmime të para e trofe në festivale kombëtare e ndërkombëtare. Presidenti i këtij Ansambli Muharrem Gjoka – "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Qarkut Dibër shprehet se: "Vlerat dhe përmasat këtij ansambli, madhështia e tij, konsistojnë edhe në emrin që mban: 'Hazis Ndreu' – 'Nderi i Kombit', titull me të cilin u dekorua para tre vitesh (Dekret Nr. 11708, datë 17.09.2020) me motivacionin: "Për veprimtarinë e shumëanshme në lartësimin e kulturës kombëtare, etnografisë, folklorit e muzikës popullore shqiptare, veçanërisht asaj dibrane. Si autor e interpretues virtuoz i këngëve e valleve folklorike dhe si studjues, hulumtues e krijues letrar i shquar".

Për zotin Gjoka, mjafton qoftë edhe ky motivacion për ta konsideruar Hazis Ndreun ikonë të artit e kulturës kombëtare. Kjo, sipas tij edhe për faktin se Ai ka qenë i afirmuar si këngëtar popullor në nivel kombëtar. Ka marrë pjesë në Festivalin e këngës, muzikës dhe valles në Tiranë më 25-27 nëntor të vitit 1959, ku vlerësohet me çmimin e lartë "Rapsod popullor". Pas kësaj, merr pjesë rregullisht në të gjitha festivalet folklorike të Gjirokastrës dhe në Festivalin e këngës popullore të Beratit, në vitin 1995.

Liri Rasha, një tjetër zë brilant dhe interpretuese e talentuar e këngës popollore e qytetare vlerëson se: "Këngët e Hazis Ndreut janë të veçanta në shumë segmente krijuese dhe interpretuese. Për dallim nga rapsodët e tjerë që kanë krijuar e kënduar dhjetra e qindra këngë, albumi i këngëve të tij duket modest, por origjininaliteti i këngës së tij është tej mase i veçantë, qoftë me zërin burrëror, të lindur apo të trashëguar, qoftë me përzgjedhjen e këngëve, meqë ai ka kënduar vetëm këngë historike dhe këngë trimërie, qoftë me melodinë dhe kompozimin e shquar artistik, qoftë me mënyrën arkaike të të kënduarit, qoftë me forcën e brendshme shpirtërore, mobilizuese, që iu ka dhënë këngëve". Ndërkohë, Muharrem Gjoka vijon: "Të gjitha këngët e Hazis Ndreut janë antologjike, të gjitha këngët e tij janë këngë të krenarisë kombëtare, këngë që kurrë nuk harrohen, kurrë nuk vjetërohen". Kjo sipas tij për faktin se sapo ta dëgjosh këngën e Hajredin Pashës, pavarësisht se kush e këndon dhe pavarësisht sa mundohet ta këndojë mirë e më mirë, nuk ka si të mos kujtohet origjinali, të cilit askush deri sot nuk i është afruar. Në këtë këngë ai ka bërë bashkë zërat kushtrimtarë si uraganë të ndezur flakë të Lumës e Dibrës, zërin mobilizues të masave të revoltuara shqiptare kundër mbretit të Turqisë, ka intonuar zërin më të fuqishëm të mundshëm të kushtrimit të furisë kryengritëse, të ndeshjeve për jetë a vdekje, zërin e ngadhënjimit çlirimtar.

Kjo këngë epike-heroike, përveç forcës mobilizuese, ka edhe një melododi mahnitëse që të rrëmben si një forcë magnetike, duke të mbërthyer në botën e heroikes dhe tragjikes, duke të sjellë në kujtesë dhembjen bashkë me krenarinë. Këngëtari kushtrimtar Hazis Ndreu, i ka kënduar edhe kryetrimit të Lumës e të Shqipërisë, luftëtarit të përkushtuar Elez Isufi, i cili "në malet e Lurës dhe të Korabit, fushën e mbushi me shapka të sërbit", ashtu siç i ka kënduar edhe heroizmit të Isuf Murres e të trimave të tjerë dibranë.

Po ashtu Hazis Ndreu ka punuar me zell në fushën e historisë, ku ka dhënë kontribut të vyer në mbledhjen e të dhënave gojore e dokumentare për ngjarje të rëndësishme të luftërave popullore e figurative atdhetare me të cilat ka referuar në sesione shkencore e simpoziume brenda dhe jashtë vendit.

TË MËDHENJTË E LETRAVE, ARTIT E KULTURËS PËR HAZIS NDREUN

Veprimtaria krijuese e Hazis Ndreut është vlerësuar nga personalitete të shquara të letrave, të artit e kulturës.

Nëse për Dritëro Agollin, "Si Hazis Ndreu, mjeshtër i humorit dibran, sot e kësaj dite, si ai nuk gjen më, i papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë", për Moikom Zeqon, Hazisi është unik. Duke veçuar dy aspekte të figurës multidimensionale, që përbëjnë këtë njeri krijues unik, Zeqo ka vlerësuar veçanërisht studimin e tij për Skënderbeun, përmes toponimeve dhe gjurmimeve në zonën e Dibrës, që nuk ka qenë vetëm një shkencë e terrenit. "Për Skënderbeun ka disa studime të tipit gojëdhënor, por studimi i Hazis Ndreut është diçka e re dhe serioze, që më ka bërë shumë përshtypje. Janë studime që lidhen me veriun dhe jugun e vendit, ndaj të gjithë studiuesit duhet të marrin për bazë këtë libër dhe këtë studim të Hazis Ndreut", është shprehur Moikom Zeqo. Ndërkohë Zeqo ka vlerësuar edhe përmbledhjen me tregime alegorike dibrane të H.Ndreut, që sjell rrëfime të popujve. "Libri Tregime alegorike dibrane nxjerr në pah mençurinë e popullit tonë përmes karakterit linear të rrëfimit. Shkruesi i librit ka dimensione të veçanta dhe trashëgimia e tij është më shumë se ai fizikisht", ka vlerësuar Moikom Zeqo.

Hazis Ndreu ishte i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian.

Kolë Jakova vlerëson se "Hazis Ndreu asht ngritë mbi rapsodët aktualë të Veriut..Ai e ka nda çiftelinë dhe shkruan në frymën e Fishtës. Madje në disa konceptime epike Ai ma shumë pin ujë në Eposin e Kreshnikëve". Po në këtë linjë e vlerëson edhe Drago Siliqi, sipas të cilit: "...Ky Hazizi i Dibrës asht me kryet tek Eposi i Kreshnikëve dhe Lahuta e Fishtës".

Po. Tek Hazis Ndreu, - shkruan Bujar Kapexhiu, arti gërshetohet në mënyrën më brilante. Ka shkelur në të gjitha gjinitë e tij dhe ka lënë gjurmë. Jeta e pasur artistike e ka veshur me pavdekësi këngëtarin, poetin, aktorin, rapsodin, historianin dhe etnografin Hazis Ndreu.

Teksa dëgjon emrin e tij nuk ka se si të mos të kujtohen rapsoditë e bukura të zonës së veriut, që vijnë në sfond sapo ndriçohet skena. Por jo vetëm kënga, edhe vallet e mrekullueshme, poezitë dhe studimet për Skënderbeun do të mbeten gjithmonë në mendjen e shqiptarëve.

Hazisi, si kërcimtar, në shumë festivale kombëtare e ndërkombëtare, qe fitues i shumë çmimeve, sidomos në vallen dyshe dibrane me kërcimtarin e mirënjohur Besim Zekthi. Vlerat e tij si koreograf e valltar i evidenton më së miri prof.dr.Ramazan Bogdani në librin e tij "Hazis Ndreu, Korabi i valles dyshe dibrane". Studiuesi Agron Xhagolli, veç të tjerash, flet për Odën Dibrane si institucion dhe për burrin e saj, Hazis Ndreu. Ai ishte dhe mbetet një universitet që ua kalon shumë universiteteve me emër, për nga forca e riprodhimit të ngjarjeve, interpretimit, për nga mençuria dhe ironia e hollë, aspak fyese për mikun, por shumë favorizuese edhe për t'u formuar në të.... Këtë e pohon artistikisht edhe "Artisti i Popullit" Resha Arbana, njëherësh edhe "Nderi i Kombit". Artisti i Popullit, Skënder Sallaku, ka pohuar meritën e padiskutueshme të Hazis Ndreut, i cili duke eksploruar në rrënojat e lashtësisë, si një historian i mirëfilltë, e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare.

Shkrimtari Xhafer Martini, në librin e tij "Hazis Ndreu – Prsonaliteti, krijimtaria", ndër të tjera shkruan se: "Te Hazizi vepronte si tek rrallë njerëz, teoria e kompensimit: Zoti i kishte mohuar ato që ua kishte dhënë të gjithëve, por nuk e kishte nxjerrë nga sytë: për të do të kujdesej si për të rrallët, do ta pajiste me talent dhe dhunti për shumë fusha. Një fjalë e urtë thotë: 'Kur të do Zoti, nuk ke nevojë për të tjerët'. Megjithatë, Hazizin e kanë dashur edhe të tjerët. Kjo është meritë e tij".

Krijimtaria e Hazis Ndreut është vlerësuar nga kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali, nga Artisti i Popullit Luftar Paja, nga Behar Mera, Skënder Cala, Llesh Nikolla si dhe nga këngëtarët Arif Vladi, Lirie Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Saje Poleshi...


Shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa vlerëson se: "...Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai".

Me botimet e tij: "Ushtima e Maleve" – libër me poezi (1961; "Valët e Drinit të Zi" - poema dhe vjersha (1966); "Këngë e vargje" – libër poetik (1970); "Një trim i Skënderbeut në Dibër" - poemë rapsodike (1972: "Tregime alegorike dibrane" (1983 ; "Elez Isufi - trajtresa, dokumente" - (1996; "Kastriotet dhe skenderbeu ne trojet arbnore" (1999 ; "Dibra në udhën e historisë - traditë, kanun, luftë histori" (2003)etj, Hazis Ndreu ka hyrë me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe.

Le ta kujtojmë, nderojmë e respektojmë si të tillë në 95-vjetorin e ditëlindjes së tij Hazis Ndreun, si simbolin e Odës Dibrane, gati-gati si një institucion lëvizës ndërshekullor i traditës, të cilin, shumëformësia e qasjes, ribërja letrare e evenimenteve historike, aftësia vrojtuese, kultura e begatë e shkathtësia përpunuese e lëndës së trevës së vendlindjes, me gjithë gamën përjetuese, e bëjnë të kapërcejë nga Dibra në vizionin e botës shqiptare në përgjithësi.

** Mjeshtër i Madh*









DISA NGA LIBRAT E BOTUAR NGA HAZIS NDREU

- Ushtima e Maleve – libër me poezi (1961)
- Valët e Drinit të Zi - poema dhe vjersha (1966)
- Këngë e vargje – libër poetik (1970)
- Një trim i Skënderbeut në Dibër: poemë rapsodike (1972)
- Tregime alegorike dibrane (1983)
- Elez Isufi: trajtresa, dokumente- (1996)
- Kastriotet dhe skenderbeu ne trojet arbnore (1999)
- Dibra në udhën e historisë: traditë, kanun, luftë histori (2003)



Vajkali ka qenë historikisht baza e minierës së kromit në Bulqizë dhe vetëm nga ky fshat kanë lënë jetën në minierë mbi 20 vetë.

Vajkali, porta perëndimore e Dibrës





Nga **ADRIATIK BALLA***

Vajkali është fshat famëmadh e historik në qarkun e Dibrës. Aktualisht përfshihet në njësinë urbane të Bashkisë Bulqizë. Fshati në fjalë shtrihet në pjesën më të sipërme të luginës së Bulqizës, në të dy anët e saj, në lindje të qafës së Buallit, në lartësinë 740-800 m (territori i fshatit shtrihet nga 720 m në zalli tek Pishat e deri në 2101m që është maja e Kreshtës së Balgjait).

Vajkali kufizohet në veri me njësinë malore të Balgjait, mal që bën pjesë në vargjet e Lurës, e në jug kufizohet me malësinë e Martaneshit, konkretisht me njësinë malore të Dhoksit. Në perëndim mbyllet me qafën e Buallit e në lindje mbyllet tek Gurët e Skënderbeut, duke pasur kufij mjaft të qartë natyror, duke u shtrirë në afro 40 km².

Vajkali ka një pozitë mjaft të favorshme gjeografike, që lidhet drejtpërdrejt me qafën e Buallit, si urë lidhëse midis lindjes e perëndimit, lidhëse midis pellgut të Dibrës dhe atij të Matit e të Tiranës. Madje Vajkali është simboli më domethënës i rrugës së Arbrit.

Është katund që i përket Bulqizës së vjetër e që mbart mbi shpinë një histori magjepsëse. Nga gërmimet arkeologjike janë gjetur objekte me rëndësi e që sot ndodhen në muzeun e Dibrës. Këto objekte flasin për një "kulturë të Vajkalit", por ende nuk ka gjurmime të mjaftueshme arkeologjike për të zbardhur plotësisht në çfarë shkalle ka qenë ky zhvillim.

Referuar Eqerem Çabej, Vajkal vjen nga latinishtja (Valis-Callis ose Vallis-Callis), që do të thotë rrugëkalim, rrugë kryesore ose rruga e luginës. Besoj se ky është interpretimi më i saktë që i është bërë këtij toponimi, edhe pse vendasit e lidhin me vaj (vajtim)-kali e disa të tjerë si lugina e kalit (kuajve).

Vajkali është vendi i dy prej betejave gjakatare që Skënderbeu zhvilloi e fitoi kundër ushtrisë osmane të drejtuar nga renegati Ballaban Pashë Badera (1465). Në këto beteja të fituara me gjak dëshmorësh, ka spikatur deri në madhështi shpirti liridashës shqiptar dhe arti ushtarak skënderbejan.

Sipas një raporti të misionarëve italianë rreth vitit 1650, Vajkali ishte një fshat me popullsi myslimane dhe të krishterë, madje kishte 20 shtëpi të krishtera.

Në veprën "Kënga e Sprasme e Balës", të Gavril Dara i Riu, përshkruhen mjaft saktë toponimet e vjetra që korrespondojnë të gjitha me emërtimet e sotme, përfshi dhe emrat e heronjve Nik Peta e Pal Golemi që kanë varret në Vajkal, pylli i Gropës, maja e Plakthit, plaku Bal, Gjergj Mirëshpaja (Mirëshpia) etj, etj.

Vajkali është vendlindja e Baba Fejzë Bulqizës (1803-1860), "Nderi i Kombit" dhe "Dëshmor i Atdheut", klerik dhe patriot i madh shqiptar, i cili udhëhoqi një rebelim të armatosur kundër Perandorisë Osmane më 1860.

Vajkali është fshati ku i madh e i vogël, burra e gra, u rreshtuan në llogore gjatë luftës 9-vjeçare të Dibrës 1912-1921, gjë që na e shpreh mjaft mirë edhe raporti i komandantit qeveritar, kapiten Ali Rizait, që raportonte nga qafa e Buallit për qeverinë e Tiranës. "250 bulqizakë gjenden në vijën e parë të përplasjes. Kur nga Tirana nuk na vjen as buka, këtu nuk janë kursyer për ta ndarë kafshatën me ne. Jo vetëm burrat, por e shumta e grave bulqizake kanë rrokur armët dhe janë rreshtuar me burrat dhe vëllezërit e tyre për të ruajtur emnin e hymnueshëm shqiptar". Në këtë vend, Bajram Curri dhe udhëheqës të tjerë kanë organizuar rezistencën antiserbe.

Vajkali është vendlindja e patriotit Mehmet Duriçi (1852-1925), udhëheqësit të çetës bulqizake midis viteve 1912-1921.

Në Vajkal u regjistrua një nga aksionet e para antifashiste në Shqipëri dhe kjo ndodhi para se Haxhi Lleshi të kthehej nga konferenca e Pezës në shtator 1942. Ky fshat ka dhënë, pra, një kontribut të rëndësishëm gjatë LANÇ-it.

> Vajkali ka një pozitë mjaft të favorshme gjeografike, që lidhet drejtpërdrejt me qafën e Buallit, si urë lidhëse midis lindjes e perëndimit, lidhëse midis pellgut të Dibrës dhe atij të Matit e të Tiranës. Madje Vajkali është simboli më domethënës i rrugës së Arbrit.

Vajkali nuk ka qenë një vend i banuar dendur për shkak të kushteve jo të favorshme pedologjike. Fusha e tij ka natyrë ligatinore, gjë që kushtëzon toka jo shumë pjellore, plus që, duke qenë në fundin perëndimor të luginës së Bulqizës, në Vajkal konkretizohet gjithë forca e erës (murlani) që vjen nga lindja, duke bërë që Vajkali të jetë një prej zonave më të ftohta në Shqipëri, me temperatura që zbresin gjatë dimrit nën 20 gradë celcius, mesatarja vjetore afro 10 grade celcius. Sasia më e madhe e reshjeve 24-orëshe është regjistruar në stacionin e Bulqizës më 02.11.1957 dhe është 100.1 mm, e dyta shifër më e madhe është 75 mm (27.11.1983).

Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1923 dhe në defterin e Teki Selenicës, Vajkali jepet bashkë me fshatrat e tjerë të Bulqizës e jo i ndarë. Bulqiza ishte fshat në nënprefekturën e Zerqanit me afro 2500 banorë. Por të dhëna më të sakta jep regjistrimi austriak i vitit 1916, ku Vajkali regjistrohet me lagjet Suroçaj, Aliaj, Ahmetaj, Duriçaj, Sallakaj, me një popullsi 787 banorë. Pas vitit 1960, Vajkali inkuadrohet si pjesë përbërëse e qytetit minator të Bulqizës.

Vajkali është fshat me shumë monumente natyrore, si Gurët e Skënderbeut (të dëmtuar disi në fillim vitet 90-të), Gurra e Kuqe, 6 liqenet akullnajore të Dhoksit që janë një perlë e vërtetë, ujëvara e Duriçit, kreshta e mprehtë e Balgjait që bie mjaft pjerrët mbi qytezën e re të Bulqizës, masivin pyjor me ahishte dhe halorë në Gatelli i Bulqizës rrëzë majës së Dhoksit, qafën e Buallit për vlerat didaktike të saj etj.

Vajkali është fshat që ka burime uji të konsiderueshme, përrenj me ujë të vyer si ai i Duriçit, i Sharrës dhe përroit të Thellë.

Këneta e tij në zemër të fushës së Vajkalit është 10 hektarë.

Vajkali ka qenë historikisht baza e minierës së kromit në Bulqizë dhe vetëm nga ky fshat kanë lënë jetën në minierë mbi 20 vetë.

Vajkali është fshati nga ku kanë dalë inxhinierë të spikatur, ushtarakë të zotë e me funksione madhore, mjekë të shquar, piktorë, skulptorë, e deri biznesmenë të suksesshëm.

Sot, në Bashkinë Bulqizë, Vajkali prezantohet me dy lagje (Vajkal 1 në qytetin e vjetër dhe Vajkal 2 në qytetin e ri). Ky fshat ka sot mbi 1 mijë banorë.

Vajkali është vendi i basenit më të madh krommbajtës të Shqipërisë, njohur si masivi i kromit Bulqizë, që i ka dhënë vendit mbi 15 milionë tonë mineral kromi. Në territorin e Vajkalit, pranë qafës së Buallit, ndodhet gjithashtu fabrika e pasurimit të kromit.

Në trashëgiminë e zonës hyn veshja popullore mjaft e spikatur, e ruajtur prej të paktën 500 vjetësh, por Vajkali është, gjithashtu, vendburimi i shumë këngëve të famshme popullore, përfshi "Vajkaloren", "Sheh Fejza...", si dhe "Bareshën", kjo e fundit këngë himn e folklorit shqiptar.

Nga kjo paraqitje e shkurtër enciklopedike kuptojmë që Vajkali i ka dhënë shumë Shqipërisë, por është vlerësuar shumë pak. Dhe, në fakt, sikurse e ka thënë një autor, historia e Vajkalit (rrjedhimisht Bulqizës), nuk është histori lokale por është histori kombëtare.

Ngjyrat që përshkruajnë Vajkalin janë:

E kuqja e gjakut, e zeza e kromit, e bardha e dëborës, jeshilja e pyjeve dhe livadheve, e kafenjta e kreshtave dhe shumëngjyrëshja e veshjes tradicionale dhe e jetes së banorëve të saj.

** Adriatik BALLA është Doktor i Shkencave Gjeografike.*



Vajkali është fshat me shumë monumente natyrore, si Gurët e Skënderbeut (të dëmtuar disi në fillim vitet 90-të), Gurra e Kuqe, 6 liqenet akullnajore të Dhoksit që janë një perlë e vërtetë, ujëvara e Duriçit, kreshta e mprehtë e Balgjait që bie mjaft pjerrët mbi qytezën e re të Bulqizës, masivin pyjor me ahishte dhe halorë në Gatelli i Bulqizës rrëzë majës së Dhoksit, qafën e Buallit për vlerat didaktike të saj etj.

cyan magenta yelloë black

kulturë

Ndahen çmimet kombëtare për Letërsinë, Agron Tufa fiton çmimin e parë

“Ngjizja e papërlyeme” shpallet libri më i mirë në kategorinë e romanit



Në datë 23 dhjetor 2022, në hollin e Akademisë së Arteve të Shqipërisë, u mbajt ceremonia e ndarjes së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2021, organizuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit.

Agron Tufa fitoi çmimin Kombëtar të Letërsisë, për kategorinë “Romani më i mirë i vitit”, me romanin “Ngjizja e papërlyeme”, “për një rrëfim mjeshtëror dhe një galeri të pasur personazhesh, ku gërshetohen së bashku historia, fantastikja dhe grotesku”.

Në garë për këtë çmim ishin edhe shkrimtarët Bashkim Hoxha, Mira Meksi, Ritvan Dibra dhe Stefan Çapaliku.

Vlerësimi për Agron Tufën, i cili prej dy vitesh jeton në Zvicër, u dha në mënyrë unanime nga anëtarët e jurisë, kryesuar nga prof. Floresha Dado.

“Nuk nxjerr ndonjë sekret po të them se pati të gjitha votat pro”, shkruante në profilin e tij në Facebook, anëtari i jurisë, shkrimtari Virion Graçi.

“Tetralogjia “Ngjizja e papëlyeme” është ndërtuar në bazë rrathësh interferues rrëfimorë, gjithsej katër, me një prolog dhe epilog të zhvendosur në kohën e sotme që legjitimon instancën nga ku shkarkohet rrëfimi dhe një intermexo, “Orë pa akrepa”, që na jep idenë e palëvizshmërisë, pezullimit të rrjedhjes së Kohës. Rrathët rrëfimorë janë romane që kanë në

> Agron Tufa fitoi çmimin Kombëtar të Letërsisë, për kategorinë “Romani më i mirë i vitit”, me romanin “Ngjizja e papërlyeme”, “për një rrëfim mjeshtëror dhe një galeri të pasur personazhesh, ku gërshetohen së bashku historia, fantastikja dhe grotesku”.

epiqendër një protagonist, i/e cili (cila) ose rrëfen në vetë të parë, ose na jepet në veprim përmes vetës së tretë”, thotë Tufa në një intervistë një vit më parë.

Në panairin e librit të mbajtur në Tiranë në nëntor 2022, Agron Tufa botoi romanin e ri “Paqja e përgjakur e Adamit”, i cili është një rrëfim elegjiak për fatin e njeriut të drejtë që përpiqet të meritojë “hisen e tij nën diell”, që sakrifikon e flijohet për të afërmin, që ëndërron të ndërtojë strehën e tij në paqe me këtë botë dhe që gjen në realitet vetëm tradhtinë, poshtërimin dhe mosmirënjohjen.

Për më shumë rreth dy librave të rinj të shkrimtarit Agron Tufa, lexoni më poshtë një kritikë të librit nga studiuesi i letërsisë, Namir Lapardhaja

Fati i individit në dy romanet e shkrimtarit Agron Tufa

Nga **NAMIR LAPARDHAJA**

Romani “Ngjizja e papërlyeme” kaloi pa vëmendjen e duhur dhe pa jehonën e merituar. Për nga forma strukturore, ai është ndërtuar mbi bazën e rrathëve interferues rrëfimor, i përbërë nga katër të tillë, që mund të qëndrojnë edhe si pjesë më vete, një prologu dhe epilogu, në qendër të të cilëve është një protagonist (Martin Gega – emër që e ndeshim edhe në romane të mëparshëm të autorit, një lloj alteregoje që e ka shoqëruar në të gjithë procesin krijues), i cili herë rrëfen në vetën e parë (është ai që rrëfen për veten), herë në vetën e tretë (janë të tjerët ata që rrëfejnë për të apo rreth tij); po ashtu, edhe përsa i përket përmbajtjes, romani rrëfen një fenomen të dhimbshëm dhe aspak për t’u krenuar të shoqërisë shqiptare në vitet ’60-të të shekullit të kaluar: ndarjet e vajzave ruse prej djemve shqiptarë në periudhën e prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe vuajtjet, persekutimet, internimet apo dënimet e ndryshme të atyre që nuk pranuan që regjimi t’i diktonte edhe se më kë duhet të ndanin shtratin bashkëshortor.


Nga ana tjetër, “Paqja e përgjakur e Adamit” është romani i fundit i shkrimtarit Agron Tufa. Sipas shënimet autorial në faqen e fundit, vepra është përfunduar në Bex të Zvicrës, në shtator të vitit 2022, pra në vendbanimin aktual të autorit.

Tema e këtij romani, në dallim nga “Ngjizja e papërlyeme”, është marrë nga aktualiteti, ku në qendër të tij është protagonisti Adam Zaganjori, një njeri i mirë, i urtë, i moralshëm, pakëz naiv si pasojë e besimt të shumtë që ka tek njerëzit, veçanërisht tek të afërmit, dhe peripecitë e jetës së tij, nga normaliteti i përditshëm në rrokullisjen e pakthim

> Të dy romanet e shkrimtarit Agron Tufa ndërthurin fatin e individit. “Ngjizja...” përshkruan individin në diktaturë dhe shtypjen e tij në forma dhe mënyra të ndryshme, që vjen si rezultat i ingranazheve shtypëse të sistemit, ndërsa “Paqja e përgjakur...” trajton fatin e individit në bashkëkohësi, në demokraci, madje në dekadat e fundit, gjë që del edhe nga një mori shenjash tekstuale dhe elementeve të tjera.

drejt fatalitetit të vdekjes, pas kalimit të mundimeve të shumta njerëzore. Në ndryshim nga romani paraardhës, “Paqja e përgjakur e Adamit” ka një strukturë rrëfimtare lienare. Ngjarjet në të fillojnë nga fillimi dhe jepen në mënyrë kronologjike drejt fundit, pa përthyerje kohore dhe hapësinore. Duke qenë poet i mirëfilltë dhe i mrekullueshëm, gjuha poetike, karakteristikë për veprat e mëparshme, ka ruajtur tek ky roman veçoritë e gjuhës së prozës, duke dhënë gjithçka me masë, pa tepri, pa ngarkesë emocionale, që vjen si pasojë e thellësisë gjuhësore apo e figuracionit të saj. Në pikënisje të këtij romani gjejmë gjurmë të zanafillës së njerëzimit, por mjeshtëria krijuese e autorit, thurja e fabulës dhe e intrigës së saj, arrijnë ta fshehin dhe ta sendërtojnë rrëfimin, duke e mbajtur lexuesin të gozhduar deri në faqen e fundit për të marrë vesh fatin e protagonistit, i cili, gjatë faqeve të romanit, shpeshherë bëhet, pa kuptuar, edhe fati i vetë lexuesit.

Të dy romanet e shkrimtarit Agron Tufa



ndërthurin fatin e individit. “Ngjizja...” përshkruan individin në diktaturë dhe shtypjen e tij në forma dhe mënyra të ndryshme, që vjen si rezultat i ingranazheve shtypëse të sistemit, ndërsa “Paqja e përgjakur...” trajton fatin e individit në bashkëkohësi, në demokraci, madje në dekadat e fundit, gjë që del edhe nga një mori shenjash tekstuale dhe elementeve të tjera.

Elementet fantastike të “Ngjizjes së papërlyeme” (ngelja shtatzënë e Ljuba Borisovës si pasojë e gëlltitjes së dorëshkrimeve të të shoqit), janë zëvendësuar nga një realizëm therrës tek “Paqja e përgjakur e Adamit” , saqë të duket sikur gjithçka që zhvillohet është aty përbri teje, ndërsa ti vetëm pret që të mbyllësh faqet e romanit dhe ta shohësh në realitet atë që po përshkruhet.

> Shtypja dhe pafuqia e individit përballë sistemit është një ndër karakteristikat e letërsisë ekzistencialiste. Në faqet e fundit të “Paqes së përgjakur të Adamit” të shfaqet Mërsoi i Kamysë dhe vezullimet prej diellit të ngjashme me të, çka i shkaktojnë vegulli protagonistit apo reflektim në sy të elementeve metalike mbi tavolinë, gjë që shkaktojnë edhe vdekjen e personazheve.

Shtypja dhe pafuqia e individit përballë sistemit është një ndër karakteristikat e letërsisë ekzistencialiste. Në faqet e fundit të “Paqes së përgjakur të Adamit” të shfaqet Mërsoi i Kamysë dhe vezullimet prej diellit të ngjashme me të, çka i shkaktojnë vegulli protagonistit apo reflektim në sy të elementeve metalike mbi tavolinë, gjë që shkaktojnë edhe vdekjen e personazheve.

Jo për ta ekzagjeruar apo për të mos qenë objektiv, kur mbarova së lexuari romanin voluminoz “Ngjizja e papërlyeme” krejt natyrshëm mendova se kjo vepër, nëse do të arrihej të përkthehej në mënyrë mjeshtërore në gjuhën pritëse, do të konkuronte denjësisht në dimensionet evropiane dhe botërore të letërsisë, gjë që do t’i bënte nder kulturës dhe gjuhës shqipe, ndërsa romani “Paqja e përgjakur e Adamit” është një vepër që i qëndron mrekullisht shtratit të letërsisë shqipe dhe dëshmon edhe një herë mjeshtërinë krijuese të shkrimtarit Agron Tufa./ ExLibris

Marrë nga exlibris.al

cyan magenta yelloë black

Haki Kola, *inxhinieri që bëri më të njohura pyjet dhe shërbimin pyjor shqiptar në botë*

Nga **GJON FIERZA, JANAQ MALE**

Në 30 vitet e fundit, emri i inxhinierit tashmë të ndjerë Haki Kola zë një vend të veçantë në Pylltarinë shqiptare por dhe në Kosovë, si një konsulent dhe drejtues i projekteve për pyjet, të financura dhe mbështetura nga donatorët ndërkombëtar. Eshtë periudhë pune me këto projete që e kalon një çerek shekulli.

Inxhinier Haki Kola, vlerësohet si njeri ndër përfaqësuesit më të zëshëm të studentëve që janë diplomuar në Fakultetin e pyjeve në vite. Rezultatet e larta si student, cilesitë si njeri dhe personalitet në formim bënë që ai të ishte një nder studentet që u perzgjodh pas studimeve por dhe disa vite me vonë, për të qënë pedagog në atë fakultet. Sipas kujtimeve te tij, janë tre kerkesa dhe dy vajtje ne Komitetin ekzekutiv të Dibres të ish dekanit të Fakutetit të Pyjeve doc. Bajram Xheko për të mundësuar transferimin inxh Haki Koles si pedagog në fakultet, por pa sukses. "Kemi shumë nevojë për Hakiun nuk e lejojmë të na iki, ai nuk do jetë inxhinier ne Pyjore por me detyrë të veçantë në Stacionin Bujqesore për Frutikulturën" i kishin dhënë përgjigje dekanit të fakutetit.

Ai në profesionit e inxhinierit për frutikulturën në Dibër do të punonte për me shumë se 15 vite. Puna e tij do të përqendrohej së shumti tek dy drurë pyjor- frutor, arra dhe gështenja. Falë punës në terren por dhe studimve dhe kërkimeve shkencore të inxhier Hakiut dhe në keto dy kultura, Dibra pati rezultate të mira. Midis specialistëve të pemtarisë në Shqipëri në ato vite, spikaste dhe emri i inxhinierit dibranë Haki Kola.

Kur ndryshoi sistetmi pas viteve 90, inxhinier Haki do të kalonte në detyra të të tjera, në sherbimin pyjor në Dibër midis kolegëve pylltar. Ai në ato vite u përpoq që sa qe e mundur të sillte risi në mbajtjen dhe pergatitjen e dokumentacionit, të përdorimit të teknologjisë së re që ishte në hapat e para, falë njohurive shumë të mira dhe përdorimit të literaturës në anglisht, rusisht dhe italisht.

Sapo Shqipëria, filloi të hapej kur organizata dhe donatorët filluan të investonin tek ne, sigurisht njerëzit e ditur dhe me gjuhë të huja ishin shumë të kërkuar prej tyre si konsulent vendor në këto organizata. Në fillim Hakiu erdhi në Tiranë, si specialist në DPPK, por në më pak se një vit do të fillonte punë si konsulent në Projektin shqiptar të pyjeve që kishte nisur të zbatohej. Në vijim të veprimtarisë, ai do ishte si drejtor i Projektit Shqiptar të Pyjeve të Bankës Botërore. Ai më vonë do të punonte dhe me projekte të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Inxhinieri i pyjeve dibrani Haki Kola, do të angazhohej me punë në pylltarinë e Kosoves rreth 70 vite më vonë se inxhinieri i pyjeve shkodrani dr. Benard Lacaj, që në kohën e pushtimit nazist ai mbulonte nga Distrikti i Pyjeve të Shkodrës dhe pyjet e Kosovës.

Veprimtaria e inxhinier Haki Kolës është e gjërë dhe në disa drejtime ku mund të përmblidhën:

• Zhvillim i Akteve Ligjore në lidhje me Pyjet Komunale: Rregullore mbi transferimin dhe administrimin e pyjeve komunale dhe kullotave, si dhe mbi marrëveshjet kontraktuale për menaxhimin e tyre; rregullore dhe statuse në lidhje me krijimin dhe funksionimin e shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave;

• Përgatitje e dokumentave politik: strategji për zhvillimin e sistemit pyjor në Shqipëri,



plan në lidhje me uljen e prerjeve të jashtligjshme, strategji pyllëzimi, pjesëmarrje në grupe pune për përgatitjen e strategjive për zhvillimin rajonal nëpërmjet Millennium Development Goals (Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit), pjesëmarrje në reformat institucionale të pyjeve në Shqipëri;

• Përgatitje e udhëzuesve: për planifikimin pjesëmarres për pyjet komunale dhe kullotat; për projektet e karbonit bazuar në rigjenerimin natyror dhe pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në këto projekte;

• Përgatitje e dokumentacionit për formimin dhe implementimin e projekteve: modele teknike bazuar në praktika tradicionale, modele mbi trajnimin silvikulturor të pyjeve, projekte për rehabilitimin e pyjeve;

• Punë kërkimore dhe analizë e traditave Shqiptare mbi mirëmbajtjen e tokës: përdorimi i të drejtave të pronës për tokat pyjore dhe kullotat; lobim për përfshirjen e të drejtave të përdoruesve dhe pronarëve në bazën ligjore duke ndjekur një qasje decentralizuese;

• Analiza dhe studime mbi decentralizimin e menaxhimit të pyjeve në Kosovë;

• Përgatitje e udhëzuesve: për identifikimin e kufirit mes fshatrave në pyje dhe kullotë me pjesëmarrjen e fshatrave fqinj duke ndjekur metologjinë e profilizimit të ndarjeve.

• Përgatitje e udhëzuesve mbi planet e menaxhimit për pyjet private në Kosovë;

• Pergatitja e projekteve në lidhje me



Disa data të rëndësishme nga jeta dhe veprimtaria e ing. Haki Kolës:

Ka lindur në Zerqan me 12 tetor 1953.
Ka qënë i martuar, me dy femijë,
Në vitet 1972-1977, student ne Fakultetin e Pyjeve
Në vitet 2007- 2009 Master shkencor në politika pyjore, Fakulteti i shkencave pyjore, Tiranë
Përvoja profesionale
Janar 2017- Nentor 2018 CNVP Shqipëri, Konsulent
Janar 2014- Dhjetor 2016 CNVP Kosovë, Drejtor i CNVP
Viti 2013- 2014 Agrotec Itali, Konsulent për zonat e mbrojtura
Gusht 2009 - Korrik 2012 SNV Kosovë Drejtues ekipi
Tetor 2004 - Korrik 2009 Shqipëri, këshilltar, Ekipi i menaxhimit të projektit Burimeve Natyrore: Banka Botërore dhe Qeveria e Shqipërisë
Maj 1998 - Tetor 2004 Shqipëri, drejtor i Projekti Shqiptar i Pyjeve i Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare
Mars 1995- Maj 1998 Shqipëri, specialist, Projekti Shqiptar i Pyjeve i Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare
Gusht 1994 - Shkurt 1995 Shqipëri, specialist, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave të Shqipërisë
Maj 1992 - Gusht 1994 Shqipëri, përgjegjës i Sesionit Teknik, Drejtoria e Sherbimit Pyjor, Dibër
Korrik 1991 -Maj 1992 Shqipëri, Përgjegjës i Sektorit Shkencor, Komiteti Ekzekutiv Dibër
Maj 1977 - Qershor 1991 Shqipëri, Kërkues Shkencor, Stacioni Kerkimor Bujqesor Dibër
Haki Kola ka ndërruar jetë me 7 maj, 2020.

rehabilitimin e pyjeve, biodiversitetin, menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve me cungishte lisi, modele mbi konvertimin e formacioneve të makjeve në pyje gjethegjerë;

• Zhvillim i mekanizmave monitoruese si dhe metologji supervizimi për implementimin e projekteve;

• Studime eksperimentale dhe artikuj kërkimor mbi menaxhimin e qendrueshem të cungishteve në Kosovë;

• Pilotimi i menaxhimit te perbashket pyjor në Kosovë;

• Implementim i sistemeve inovativ të ngrohjes me paleta druri në Kosovë;

• Mbështetje në krijimin e shoqatave të



përdoruesve së pyjeve në nivel komunal, rajonal dhe kombëtar nëpërmjet fushatave sensibilizuese, takimeve, trajnimeve dhe lobimit;

• Krijimi dhe zhvillimi i dokumenteve ligjorë për bashkëpunimin mes njësive administrative komunale dhe shoqatave të përdoruesve së pyjeve dhe kullotave;

• Aftësi të përparuara komunikuese dhe negociuese;

• Njohuri të mira të traditave lokale të mirëmbajtjes së tokës, pyjeve dhe kullotave në Shqipëri dhe Kosovë.

Haki Kola, ka punuar për më shumë se 25 vjet në implementimin dhe menaxhimin e projekteve ndërkombëtare për menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve. Këto projekte janë financuar nga Banka Botërore, SIDA, SNV dhe CNVP, që kanë pasur qellim përmiresimin e pyjeve të Shqipërisë dhe Kosovë duke përfshirë përdoruesit dhe pronarët e pyjeve në planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve që zhvillohen në pyje dhe kullota

Haki Kola, punoi mbi 42 vjet, si specialist, kërkues shkencor e drejtues; në frutikulturë, në pyje, zhvillim rural, etj.. Ai është autor i shumë publikimeve për pyjet dhe mjedisin, për dushqet dhe shkurret, përdorimin e tokës, mbi traditat rajonale në lidhje me të drejtat e përdoruesëve të pyjeve dhe kullotave, etj.

Për rreth 6 vjet, drejtoi Shoqatën Kombëtare të Pyjeve Komunale dhe Kullotave në Shqipëri. Anetar i IUFRO (Unioni Nderkombetar i Kerkuesve ne fushen e Pyjeve); "Qytetar nderi" i komunes Grekan-Elbasan. Për përmirësimin e dushkajave të Grekanit. Antar i Shoqates shqiptare dhe botërore të Gazetarëve të Bujqësisë.

Ai ka qënë pjesemarres në më shumë se 20 konferenca dhe seminare jashtë Shqipërisë ku ka paraqitur kumtesa dhe referate.

Është autor dhe bashkëator i artikujve të shumtë shkencor në lidhje me arrën, produktet pyjore, politikat e shërbimeve mjedisore etj. Artikuj ka botuar dhe ne shtypin dhe revista jashtë vendit.

Autor i skenarit të tre dokumentarëve mbi Pyjet komunale në Shqipëri, të cilët kanë fituar çmime nderkombetare në festivale filmash të Agrikulturës në Europë.

Pas ndarjes nga jeta, në vitin 2021 janë përmbledhur (nga unë Gj. Fierza) disa nga: shkrimet, studimet dhe përkthimet në botimin "Kriza mjedisore ndërmjet sfidave dhe zgjidhjeve" një botim voluminoz që është financuar nga CNVP- Kosovë dhe është shpërndarë falas në Kosovë dhe Shqipëri. Ka komunikur dhe lexuar mirë ne tre gjuhe te huaja: Anglisht Rusisht dhe Italisht

Haki Kola, punoi mbi 42 vjet, si specialist, kërkues shkencor e drejtues; në frutikulturë, në pyje, zhvillim rural, etj.. Ai është autor i shumë publikimeve për pyjet dhe mjedisin, për dushqet dhe shkurret, përdorimin e tokës, mbi traditat rajonale në lidhje me të drejtat e përdoruesëve të pyjeve dhe kullotave etj.

recensë

Reçensë e monografisë "Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë" të studiuesit prof. Adem Bunguri.

"Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë", një arritje e arkeologjisë

Nga **Prof. dr. Neritan CEKA**

Punimi i studiuesit Adem Bunguri me titull "Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë" vjen për diskutim vetëm një vit pas monografisë "Vegla bakri dhe sëpata bronzinë Shqipëri dhe Kosovë". Në këtë punim, ashtu si edhe në punimin e mëparshëm, autori trajton një kategori të veçantë objektesh prej bronzi, siç janë përkrenaret ilire. Në këtë punim paraqiten të gjitha përkrenaret ilire të zbuluara deri më sot në territorin e Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Përveç 40 përkrenareve të tipit ilir të zbuluara në të dy vendet tona, ai ka përfshirë në studime edhe 5 përkrenare të tipeve të tjera të zbuluara në Shqipëri. Gjithashtu, duke i parë përkrenaret si një element të setit mbrojtës të aristokracisë ushtarake, ai ka përfshirë në këtë punim edhe elementët e tjerë të këtij seti, si parzmoret, kallçinjtë dhe mburojën ilire. Gjithësesi kategoria kryesore janë përkrenaret, që zënë mbi 98% të të gjithë punimit. Që në fillim duhet të vlerësoj faktin e trajtimit të kategorive të veçanta të objekteve si një qasje mjaft pozitive në studimet arkeologjike.

Qëllimi thelbësor i këtij punimi është të jap një pasqyrë sa më të plotë analitike të përkrenareve ilire të zbuluara në territorin e Shqipërisë dhe të Kosovës, të identifikojë tipet dhe variantet e përfaqësuara dhe të bëjw mbi këtë bazë edhe një vlerësim kronologjik dhe historiko-kulturor të tyre.

Punimi është struktuar në 8 kapituj, sipas kritereve kronologjikë dhe tipologjik. Në kapitullin I, "Të dhëna të përgjithshme", përveç hyrjes, pozitës gjeografike dhe historikut të kërkimit, jepen të dhëna të përgjithshme mbi përkrenaret ilire, tipologjinë dhe kronologjinë e tyre, tipet, variantet dhe veçoritë morfo-strukturore të tyre, shpërndarjen e tyre në hapësirë, si dhe një tabelë katalogimi të tyre në Shqipëri e Kosovë. Në këtë të fundit jepet database i plotë për çdo ekezemplar, ose pasaporta e çdo objekti, që përfshin vendgjetjen, vendruajtjen, nr. inventarit, përmasat, pesha si dhe referenca e plotë në rastet kur objekti është i botuar.

Në kapitullin II, "Përkrenare të fazës së hershme dhe të mesme (tipet I-II)", trajtohen përkrenaret e tipeve më të hershme të njohura në Shqipëri. Është fjala për përkrenaren e Borovës, që i takon variantit b të tipit I, kronologjikisht e lidhur me periudhën arkaike, dhe përkrenarja e Ungrejt që i takon variantit b të tipit II, kronologjikisht pak më e vonë. Autori thekson me të drejtë që Shqipëria është rajoni i vetëm në Ballkan pas Korinthit, ku është përfaqësuar tipi I i përkrenares së prodhuar nga një copë e vetme bronzi. Me rezervë përfshihet në këtë tip edhe përkrenarja e humbur e Karicës, bazuar mbi një foto të saj të botuar në një album filatelik.

Kapitulli III, "Përkenare të fazës së zhvilluar (tipi III)",është kapitulli kryesor i krejt librit. Në këtë kapitull trajtohen përkrenaret e tipit III me kalotë gjysëmsferike, hapje trapezoidale të fytyrës, hapje këndore mbiveshore etj. Ky tip përkrenare në Shqipëri është përfaqësuar nga 24 ekzemplarë, që sipas autorit klasifikohen në disa variante, si IIIA1a (6 ekzemplarë), IIIA2a (13 ekzemplarë), IIIA2b (2 ekzemplarë) dhe IIIA3a (3 ekzemplarë). Gjithashtu në Shqipëri, ndryshe nga viset përreth, është përfaqësuar dhe një variant i vonë i përkrenareve të tipit III, varianti IIIB, me 4 ekzemplarë (Starovë, Petrushë, Kryegjatë, Dushk). Është pikërisht ky variant i vonë i stampuar në monedhat e tipit mburojë-përkrenare të qyteteve ilire të Skodrës e të Lisit (prerje e pas vitit 186 para Kr.) me legjendën "Σ-KO-ΔPI-NΩN" dhe "ΛIΣΣI-TAN" si dhe në monedhën e po këtij tipi të prera nga mbreti ilir Genti me legjendën "BACIΛЄωC-ΓЄNθI0Y", i konsideruar me të drejtë si terminus ante quem i përdorimit të përkrenares ilire në Shqipëri.

Po ashtu, autori tërheq vëmendjen edhe mbi një variant të veçantë të përkrenareve ilire, të konsiderua si variant hibrid ose kombinativ, që gërshetojnë elementët e tipit korinthik dhe ato të tipit ilir në një objekt të vetëm. Ky variant është përfaqësuar vetëm në Shqipëri nga dy ekzemplarë (Bitinckë, Apolloni). Nisur nga këto të dhëna të reja, që nuk kanë qenë të njohura më parë, autori mendon se frymëzimi tipilogjik i përkrenareve ilire ka ardhur nga tipit i përkrenares korinthike.

Në kapitullin IV trajtohen "Përkrenare ilire në Kosovë". Është fjala për 7 ekzemplarë variantit AIIIA1a (3 copë nga Banja e Pejës), 3 copë të variantit IIIA2a (ekzemplari i Dejës së Rahovecit dhe dy ekzemplarët e Korishës) dhe një copë e variantit IIIA3a (ekzemplari i Neprabishtit (Shirokë), kjo e fundit e zbuluar nga austriakët gjatë një gërmimi të kryer në vitin 1918.

Në kapitullinV, "Përkenare të tipeve të tjera në Shqipëri",trajtohen shumë shkurt përkrenret e tipeve të tjera në Shqipëri, përkatësisht përkrenarja korinthike e Bastarit, përkrenarja atike e Monunit (Pogradec), përkrenarja e tipit maqedonas e Apollonisë si dhe dy përkrenare të tipit kelt, njera prej bronzi (Belsh) dhe tjetra prej hekuri (Lin), duke dhënë për të gjitha edhe kontekstin historik. Gjithashtu, në katalog, përfshihet edhe një përkrenare kali e Antigonesë e zbuluar nga Dh. Budina. Një syth i rëndësishëm i këtij kapitulli është, padyshim, "Numizmatika ilire", ku jepen shkurt monedhat e tipit mburojë-përkrenare të përmendura më lart.

Në kapitullin VI trajtohen në mënyrë të përmledhur "Elementë të tjerë të kompletit mbrojtës", përkatësisht, triparzmoret e bronzit (Urakë I, Urakë II, Karicë), 4 çifte kallçinjsh bronzi (Urakë II, Belsh, Çinamak dhe Dobraç), mburoja rrethore ilire (Urakë I, Apoloni) dhe versionet e gurta të saj (Apolloni, Balsh dhe Selcë e Poshtme).

Në kapitullinVII, "Përkrenare ilire në Ballkan dhe në Europë",jepet një pasqyrë përgjithësisht e plotë e përhapjes së përkrenareve të tipit ilir në Ballkan dhe jashtë tij si dhe pasqyrimi i përkrenareve ilire në Muzet e Europës. Kapitulli mbyllet me një tabelë katalogimi e përkrenareve ilire në Europë.


Në kapitullinVIII, "Analiza, kronologjia dhe origjina", përveç analizës analitike mbi përkrenaren e tipit ilir, origjinën dhe zhvilllimin e saj morfo-strukturor dhe tipologjik në Shqipëri në një linjë kronologjike ngjitëse, synohet të jepet edhe konteksti social dhe politiko-ushtarak i shtetit ilir dhe atij dardan, si shtete të fuqishme në skenën ballkanike të kohës.

Libri mbyllet me "Përfundime" në shqip dhe në gjuhën angleze, si dhe me anekset e tjera të fundit të monografisë, si lista e figurave, lista dhe përmbajtja e tabelave, lista e shkurtimeve, bibliografia.

Sikurse shihet qartë nga analiza e përmbledhur e kapitujve, objekt i këtij punimi është trajtimi i përkrenareve prej bronzi të tipit ilir të zbuluara në territorin e Shqipërisë dhe të Kosovës. Katalogu përfshin 40 ekzemplarë të përkrenareve të tipit ilir në të dy vendet tona, 33 prej të cilave nga territori i sotëm i Shqipërisë dhe 7 ekzemplarë nga territori i Kosovës. Përveç tyre, në katalog janë përfshirë edhe 5 përkrenare të tipeve të tjera të gjetura në Shqipëri, përkatësisht një përkrenare e tipit korinthik, një atik me strehë, një e tipit maqedonas dhe dy ekzemplar të tipit kelt, vetëm njera prej të cilave është prej bronzi.

Janë përfshirë gjithashtu edhe elementë të tjerë të armëve mbrojtëse, që plotësojnë kompletin luftarak të princërve dhe kalorësve ilirë të periudhës arkaike dhe antike si dhe të dhëna numizmatike mbi këto armë mbrojtëse. Duhet thënë se një pjesë e rëndësishme e kërkimit i kushtohet analizave klasifikuese, tipologjike dhe ndarjes se tipeve të identifikuar në grupe kronologjike. Autori bën klasifikimin tipologjik të përkrenareve të zbuluara në Shqipëri, ku janë përfaqësuar të tri tipet suksesive I-III të të zhvillimit të përkrenareve ilire, si dhe 7 variante të tyre, përkatësisht variantet Ib, IIb, IIIA1a, IIIA2a, IIIA2b, IIIA3a dhe IIIB, ndërsa në Kosovë vetëm tipi III me variantet IIIA1a, IIIA2a dhe IIIA3a. Në Shqipëri është përfaqësuar gjithashtu edhe varianti hibrid ose kombinativ, që gërsheton elementë të përkrenares së tipit korinthik dhe atij të tipit ilir.

Autori e thekson disa herë faktin me mjaft interes se në Shqipëri është përfaqësuar një numër i madh variantesh, duke filluar që nga ai Ib, më i hershmi i serisë, deri tek varianti i fundit, ai IIIB, që mbyll serinë e zhvillimit të përkrenareve të tipit ilir. Meritë e këtij punimi është padyshim katalogimi i të gjithë gjetjeve të kësaj kategorie, me të dhëna të plota mbi vendgjetjen, gjendjen dhe vendin e ruajtjes, përmasat,



peshën, tipin variantin, referencën kur është e botuar më parë etj.

Pavarësisht frymëzimit tipologik nga Korinthi, autori thekson se trualli ilir është rajoni ku përkrenarja u zhvillua morfologjikisht dhe tipologjikisht dhe u pagëzua si përkrenare e tipit ilir. Etnikoni "ilir", logjik dhe i natyrshëm, buron jo vetëm nga fakti se në truallin ilir u krijuan tri tipet kryesore të zhvillimit të saj, por edhe nga përqëndrimi i vendgjetjeve të saj në hapësirën historike të Ilirisë si dhe nga koha shumë e gjatë e përdorimit të saj në këtë hapësirë. Përkrenarja shfaqet në një stad të veçantë të zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe politik të ilirëve, që i referohet lindjes, zhvillimit dhe lulëzimit të aristokracisë ushtarake ndër ilirët.

Punimi ka meritën e madhe se plotëson një boshllëk të kahershëm në studimet prehistorike shqiptare. Për këtë arsye, përshkrimi dhe analiza e përkrenareve ilire prej bronzi përbën një ndihmesë origjinale që do të zerë vend në trajtesat e prehistorisë shqiptare në përgjithësi. Të dhënat e sjella nga autori përforcojnë hipotezën e prodhimit në vend të përkrenareve ilire, të mbrojtur nga stuiuesit H. Ceka, N. Ceka, F. Prenddi, S. Aliu, B. Jubani etj. Libri ofron në mënyrë koherente përceptimin e të dhënave që janë akumuluar ndër vite në Shqipëri e Kosovë për përkrenaret e tipit ilir. Pas një diskutimi sistematik të tyre dhe dokumentimi rigoroz, autori përpiqet të shpalos gjithë potencialin informues të këtyre gjetjeve në kontekstin social dhe politiko-ushtarak të zhvillimit të vendit gjatë periudhave arkaike, klasike dhe qytetare ilire.

Punimi ka një karakter të fortë shkencor. Ai mbështetet tërësisht në të dhëna të dokumentuara mirë arkeologjikisht; edhe gjetjet që vijnë nga kontekste të padokumentuara mirë ose si gjetje rasti, vendosen nga autori në një kontekst rajonal dhe tipologjik. Në këtë mënyrë edhe këto gjetje marrin vlerë dhe mbështesin argumentet e autorit për përhapjen gjeografike të metalurgjisë prehistorike dhe formimin e një ansambli gjetjesh që është jo vetëm i plotë, por edhe shkencërisht përfaqësues. Studimi ka meritën se ndjek një logjikë të fortë shkencore që fillon me formulimin e problemit kërkimor dhe pasohet nga një analizë rigoroze, me parashtrimin e hipotezave dhe diskutimin e tyre në formën e përfundimeve.

Aparati shkencor i këtij libri është mjaft i pasur. Autori ka shfrytëzuar një literaturë të gjërë dhe të përditësuar, e reflektuar në mbi 140 tituj dhe 501 fussnota.

Aparati ilustrativ përfshin një material shumë të pasur ilustrativ. Autori ka Monografia shoqërohet nga një aparat i pasur ilustrues i përbërë nga 24 figura, harta diagrama dhe 76 tabela, prej të cilave 36 tabela me vizatime objektesh dhe foto të tyre dhe 30 tabela vetëm me foto të përkrenareve si dhe 10 harta të përhapjes së përkrenareve ilire në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan sipas tipeve dhe varianteve të tyre. Ilustrimet e pasura të dhëna në këto tabela, fotografitë, hartat, grafikët, diagramat etj përbëjnë një pasuri të vërtetë dhe kontribut shumë të vlerësueshëm, dhe njëkohësisht shënojnë një arritje të arkeologjisë ilire,që do t'u shërbej edhe studiuesëve të tjerë në të ardhmen. Shpreh mbështetjen time për botimin e këtij punimi të sukseshëm të Bungurit, në trajtimin e një kategorie objektesh metalike të pastudiuar më parë në mënyrë sistematike nga arkeologët shqiptarë, që përkon plotësisht me natyrën e botimeve akademike.


Rruga e Arbërit nr. 196

botime

Hidajet Lahu, **Atdheu është**

(Zakone, tradita, gjenealogji / lagjja "Pashnjarë, Sllovë), Tiranë, 2021

Nga **PROF. DR. HAJRI SHEHU**



Libri është një dritare për të parë Sllovën. Libri ka fakte; ka të dhëna arkivore dhe historike; ka të vjela nga njerëz të gjallë e nga folklori. Faktet vijnë nga fusha e autorit – bujqësia, mjedisi, blegtoria etj. Dhe lexuesi mund t'i shohë drejtpërdrejt në libër. Mund të shohë edhe statistika nga prodhimi. Të dhënat arkivore dhe historike i ka qëmtuar nga burime autentike.

Dy fjalë hyrëse për autorin: Është burri simpatik, shumë i edukuar, fjalëpak e vullnetshumë. Model modestie. Lindur e rritur në këtë Pashnjarën, që e ka aq shumë për zemër, në një familje aq fisnike e aq punëtore. Ka një karrierë të spikatur pune e punësimi në fushën e agronomisë e të drejtimit të bujqësisë në ish-rrethin e Dibrës.

Libri na sjell pranë Pashnjarën e Sllovën, por edhe vetë autorin. Libri përshkohet nga ndjenja të thella dashurie e dashamirëse dhe vlerësimi për Pashnjarën, për Sllovën, për krahinën. Pashnjara dhe Sllova janë si pjesa me të tërën. Të dyja – të mira e të dashura. Gjithnjë brenda krahinës e Atdheut. Dhe sinteza e përfundimi na vjen nga titulli i librit: *Atdheu është i bukur në çdo cep të tij*. Le ta bëjmë pjesë të mendësisë sonë dhe të zemrës sonë këtë postulat. Dhe, sidomos mërgimtarët tanë.

Sllova – dhe bashkë me të, Pashnjara – njihet në shkallë kombëtare, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Sllova ka qenë (disi – edhe sot) kryeqendra e gjithë Ujemujës (në vitet '50 të socializmit – edhe për Kalanë e Dodës). Jo, thjesht, në kuptimin si qendër administrative e krahinës *(lokaliteti),* si qendër ekonomike *(kooperativa),* si qendër arsimore *(shkolla fillore / 1921, shkolla 7-vjeçare/1947 dhe më pas – shkolla e mesme),* si qendër shëndetësore *(spitali),* si qendër kulturore *(shtëpia e kulturës)*.

Sllovës e Pashnjarës ia japin emrin e mirë njerëzit. Sepse gjithherë, bashkë me vendin dhe me viset janë njerëzit; bashkë me njerëzit janë ngjarjet e historitë e bëmat – të vjetra dhe të reja. Dhe në libër, bashkë me autorin dhe audiencën e tij – më së pari, pashnjarasit e sllovasit, na vijnë njerëzit trima, fisnikë e punëmirë – me emra e me mbiemra: Elez Isufi e Sufë Xhelili; Dali Ndreu e Beshir Ndreu – të dy vallezër të mirë, patriotë e trima; Nuz Mala – mjeshtri për punim dërrasash, njeriu model e Zure Lahu – mjekja e shquar popullore (në parantezë: Unë nuk e shërova dot qimëzën në spital në Tiranë, ma shëroi Zurja në Pashnjarë); Halil Lahu (babai i autorit) – kryetari i parë i këshillit antifashist nacionalçlirimtar dhe Sabedin Nakja – bujku i dalluar i zonës. (Në parantezë: Unë kujtoj me nostalgji livadhet e Sabedinit në Ligjatas / Paradin). Nuk e di a mund të ketë në botë aq shumë lule erëndshme, sa ç'kishte në livadhin e Sabedinit.

Libri është një dritare për të parë Sllovën. Libri ka fakte; ka të dhëna arkivore dhe historike; ka të vjela nga njerëz të gjallë e nga folklori. Faktet vijnë nga fusha e autorit – bujqësia, mjedisi, blegtoria etj. Dhe lexuesi mund t'i shohë drejtpërdrejt në libër. Mund të shohë edhe statistika nga prodhimi. Të dhënat arkivore dhe historike i ka qëmtuar nga burime autentike. Një shembull: Mbase ndonjë mund të mos e dijë që në arkivin e Institutit të Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike është Defteri kadastror i vitit 1467. Nga Defteri ka të dhëna. Të vjelat nga njerëzit e folklori vijnë nga fshati, nga Ujemuja, nga përtej Ujemujës. Lexuesi mund të lexojë për dasmën për e zakonet e dasmës; për këngë dasme; për festat e motmotit e festimin e tyre. Në punë të dasmave e të nuseve duam të përveçojmë Kalin e Daud Sulës. Kali i Daudit në Pashnjarë ishte i bardhë. Dhe nuset merreshin vetëm me kalë të bardhë. Vetëm me Kalin e Daudit. Dhe kushedi sa nuse ka sjellë ai Kali i Daudit. Daudi e mbante dhe e ruante me kymet (po përdorim një fjalë bisedore të vjetruar të krahinës). Kur merrnin nuse, Kalin e zbukuronin. Dhe ai bëhej edhe më i hijshëm. Daudi vetë nuk pati fëmijë. Dhe Kali nuk i solli nuse në kurt. Por ai gëzohej me zemrën e tij të madhe kur ia lypnin të tjerët Kalin për nuse. Në libër mund të lexohet edhe si e varrosën Kalin kur vdiq. Miranda Shehu (Xhilaga) ka një poezi për këtë Kalin e nuseve. Ai meriton një film dokumentar.

Meqë jemi te folklori i pasur i krahinës, nuk mund të rrimë pa përmendur tri fjalë të urta që jepen në libër. Ato janë:

Babë e djalë – besë e fjalë.
V(ë)llai me v(ë)lla – kullë e kala.
Burrë e grue – mish e thue.

Është botuar do kohë përpara një libër me folklor nga Ujemuja. Më vjen keq që nuk janë zbuluar dot atëherë, që të ishin në atë libër. Ani. Ja që u zbuluan e na u dhanë nga Hidajeti. Fjalët e urta janë mençuria e popullit. Të shkruash bukur, - thotë një i urtë, - do të thotë të ndiesh bukur, të mendosh bukur, të shprehesh bukur. Fjalët e urta janë ndihmëtari ynë për të ndier bukur, për të menduar bukur, për t'u shprehur bukur.

Vetëm pak për vlerën konceptore të këtyre tri fjalëve të urta: Ato janë një sintezë e përkryer dhe një traktat i shkëlqyer për rolin e pazëvendësueshëm në jetë të familjes *(së madhe)*, për komunikimin brenda familjes (edhe fisit, lagjes etj.), për moralin, marrëdhëniet e dashurinë brenda kësaj njësie bazë të shoqërisë, për besën e traditën. Këto koncepte materializoheshin në jetë. Kujtojmë bashkëmarrëdhëniet për punët e stinës, kur ndërtoheshin shtëpi të reja, në dasma e në morta, në raste fatkeqësish natyrore e mbi të gjitha, besa-besën kur luftohej për vatan. Nëntitulli i librit u shkon këtyre vlerave konceptore. Ai është *Zakone, tradita, gjenealogji*. Mund t'i shtohej edhe *mitologji dhe gojëdhëna* sepse ka edhe të tilla. Shihni, p.sh., në libër atë *Përroin e Dervishit*.

Sllova njihet në të gjithë Shqipërinë. E kemi edhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar. Një vlerësim shumë i lartë ky. Edhe shkolla e Sllovës njihet në shkallë vendi edhe për historikun e saj (në fillim, në Trojak, ndër më të parat në Shqipëri – më 1914; më 1921 – te Përroi i Botës; më 1947 – shkollë 7-vjeçare, tani – e mesme e përgjithshme), por edhe për rolin e madh zhvillimor në krahinë. Shumë mund të flitet për këtë shkollë dhe për mësuesit e saj. Ne do të përmendim vetëm një moment: Në vitin 1987, në Sllovë u mbajt një sesion i madh shkencor në shkallë rrethi për gjuhën. Dhe e dini çfarë tha profesor Androkli Kostallari, akademik, që e pati mbrojtur doktoratën në universitetin "Lomonosov" të Moskës para dy korifenjve të gjuhësisë botërore – Vinogradov e Budagov, atëherë (1987) – drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, kryeredaktor i Fjalorit kombëtar të gjuhës së sotme shqipe, shef i Sektorit të leksikologjisë dhe të leksikografisë dhe i Kartotekës së leksikut të shqipes? Ja çfarë tha: Sot dëgjova fjalë (nga kumtesat), që nuk i kam hasur as në leximet e mia dhe as në Kartotekën me 5 milionë skeda. Në Sllovë i tha. Shkolla 7-vjeçare (më pas – 8-vjeçare) ishte qendra kulturore-artistike e zonës. Sllova ka marrë gjithnjë çmime të para në festivalet në shkallë rrethi.

Shkolla e Sllovës – Pashnjara dhe vetë Sllova – është pjesë e historisë së shkollës kombëtare. Edhe për hershmërinë e saj e historikun e saj, siç u cek, edhe për rezultatet e saj, por edhe për mësuesit e saj. Ka pasur mësues që janë figura kombëtare: Haki Sharofi, Abdulla Çanga, Ismail Strazimiri, Naim Plaku, Sejfulla Kata etj. Kaq pasur edhe mësues të tjerë: Mikeli, Lorenci, Eqeremi, Xhema, Femiu, Enveri. Këta nuk janë vendës. Ka edhe vendës. Mësues edhe drejtorë të shkëlqyer. I kemi në libër.

Jemi te njerëzit e Sllovës. Ata e duan dhe e ruajnë shumë natyrën, kujdesen shumë për arat e për livadhet, për mezhdat e për përrenjtë, për drurët e për shkurret, për mollët e për kumbullat. Në libër i kemi këto. Në libër na thuhet se pemëtaria e Ndreve ka mbi 100 vjet jetë. Kush ka qenë ai Miçurin, që i pati bërë ato blloqe me pemë, aq të lakmueshme për këdo që i kundronte a u shijonte frutat? Sllova dallon nga të gjithë fshatrat e tjerë në punë të pemëve. Duket sikur Zoti e ka bërë kasten të tillë. Ajo që mund të shtojmë është kjo: Në vitin 1959, specialistë çekë për mollët, njohës dhe hulumtues të kësaj frute në të gjithë Europën, paskan thënë: Aromën e këndshme të mollëve të Sllovës nuk e kemi hasur në asnjë vend tjetër. Libri na sjell edhe dëshirën e sotme për zhvillim të mëtejshëm të Sllovës e të zonës.

Historia e lagjes Pashnjarë. Themeli është familja Lekë Lahi. Leka, me besim katolik. Nga Shkodra: 1530-1590. Zë vend në Sllovë. U kthye në mysliman. Pra, rreth 500 vjet më parë. Deri tani – 14 breza. Njëri nga djemtë e Lekës, i kthyer në Islam, ka themeluar teqenë e Peshkopisë. Ka edhe fise të tjera ardhëse në Sllovë, si Nakja, Ndreu etj. Në libër ka të dhëna të qarta gjenealogjike për fisin Lahu.

Po e përsërisim thënien: Njerëzit ia japin fytyrën një vendi. Sllova ka pasur burra, që ia kanë përndritur fytyrën. Ka burra Sllove, të cilëve u këndohet këngë: Elez Isufi e Sufë Xhelili. Ka pasur këngë edhe Tafë Çorja. Edhe Faik Cala. Besojmë të ketë këngë edhe për burra të tjerë me emër. Dhe vijmë te një thënie tjetër: Të shkruash për Sllovën, nuk është e lehtë. Sepse Sllova është e madhe. Bash sepse është Sllovë. Vetëm një libër nuk e nxë Sllovën. Gjithkush e ka provuar: Përkundër dëshirës së një autori për të thënë sa më shumë, mundësisht – gjithçka, është kufizimi që vjen nga vetë libri si libër. E, atëherë, me siguri, autori do të bëjë librin e dytë, me siguri. Dhe kemi mësuar se e ka bërë. Tashmë, për Ujemujën, pjesë e së cilës është Sllova. Dhe atje do të ketë vend më shumë për gjeneral Dali Ndreun, njëri ndër udhëheqësit kryesorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, komandant i Korparmatës I të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Nderi i Kombit; për Esat Ndreun – komandantin e çetës së Sllovës; për Beshir Sufën, burrin sybojëqiell, komandant i vendit. Por burrënimi i Sllovës shkon më tej. I kemi në libër. Do të përmendim bashkë me ta edhe ndonjë tjetër. Për burrëri, për bëma:

- Halil Lahu – kryetari i parë i këshillit nacionalçlirimtar të fshatit Sllovë.

- Malok Lahu, postieri shembullor e besëtari, që për ndodhi e kërkesa të veçanta e bënte rrugën Pashnjarë (Sllovë) – Tiranë në këmbë për një ditë. E paimagjinueshme.

- Përmendëm pak më parë Zure Lahun, Daud Sulën e Nuz Malën. Shtesa ime: Sa mirë do të kishte qenë, sikur ndërgjegjja e sotme masive të ishte si e atyre! Shtesa e dytë: Sabedin Nakja – bujku i dalluar (kështu quhej sepse kështu vlerësohej). Në vitin bujqësor 1955 ose 1956 (nëse nuk gabojmë) mbolli pambuk dhe pambuku i dha boçet fjollë të bardha. Pambuk në Sllovë! Një me një me të shkonin dy vëllezër - Haqif e Rufat Lahu. Dhe të tjerë. Te Naket përmendet në libër Abdullah Nakja. Unë do të shtoj: Abdullahu bënte një lloj mushti, që nuk e kam parë e pirë askund tjetër. Duke vijuar më tej, kemi Sabri Loçin. E kujtoj me mëngët përveshur, kur punonte në arë e në klubin e Sllovës. Dhe e di çfarë them? Me ato krahë e shpatulla, ai mund të ngrinte globin. Dëshira, e bija, bashkënxënësja me ne në shkollën 7-vjeçare, ishte vajza e zgjuar e gjithë klasës. Te Zhugrret ka shumë për të thënë. I kemi në libër. Unë do të përveçoja Idriz Zhugrrin. Ishte i sëmurë nervor. Ishte sëmurë në luftën e Çanak Kalasë. Topat. Gjëmimet. Lufta. Qe dijetar i madh i fesë. E kam parë shumë shpesh në verë llërëpërveshur, me kmesë në dorë. Me atë kmesë mund të bënte të pabërën. As edhe një mizë nuk e ka prekur.

Para se të dalim në Ratke e Çore, do të kthehemi përsëri te Ndretë e Sllovës (Pashnjarës). Janë mësuesit nga një familje: Xhetani – babai dhe Remziu e Mirushi – të bijtë. Nga ajo shtëpi – bashkënxënësja jonë, Donika. Ajo dallonte nga shoqet e saj dhe nga të gjithë ne të tjerët. Për qytetarinë e saj. Me flokë të prerë shkurt, pak poshtë bulës së veshit, gjithnjë e pastër, gjithnjë sqimatare.

cyan magenta yelloë black

Libri na josh edhe ne të tjerëve të shkruajmë. Për çfarë? Për shumë gjëra. Në libër thuhet se deri nga fillimi i viteve '50 sllovasit e bënin pazarin në Tiranë. Për kripë e vaj guri shkonin. Nga Bulqiza e tej - nëpër Rrugën e Arbrit. Nëpër këtë rrugën, që sot është automobilistike e që e presim të përurohet sa më shpejt. Zakonisht, shkonin vargan. Dhe, në këto udhë me varganë kishte edhe biseda, humor, histori. Mund të shkruhet edhe për to. Edhe për shqipet.

i bukur në çdo cep të tij

Hidajet Lahi promovon dy librat e tij

Këto ditë janari 2023, autori Hidajet Lahi, një intelektual i njohur dibran, promovon në Tiranë dy librat "Atdheu është i bukur në çdo cep të tij" dhe "Ujemuja", monografi, etnografi kushtuar vendlindjes. Një vështrim historik shkruar me fakte e dokumenta, me ngjarje e njerëz të kësaj treve të njohur.

Në promovim morën pjesë banorë nga zona e Ujemujës, por dhe nga zonat përreth e më gjerë. Ishin të pranishëm shumë intelektual të njohur, disa prej tyre kishin ardhur dhe nga larg, posaçërisht për këtë veprimtari.

Për librin foli dr. Hajri Mandri, njëherësh dhe redaktor i librit. Për një panoramë të librit foli më gjerë dhe autori Hidajet Lahi. Pati pyetje dhe diskutime, por do të veçonim diskutimet e z. Selami Gjoka ardhur nga Elbasani, Elmas Lala, Dogjani Dervishi, Qatip Bara e të tjerë.

Libri ju dhurua të pranishmëve me autograf nga autori Hidajet Lahi. Për të pranishmit, u dha dhe një koktej, shoqëruar me muzikë nga grupi i rapsodëve, kryesuar nga Veseli Shehu dhe Fatjon Dervishi.

Atmosfera e gëzuar dhe miqësore ju dha mundësi të takohen me njëri-tjetrin, të



bisedonin jo vetëm për librin, por dhe më gjëre. / **I. DERVISHI**

Xhelal Ndreu dhe Avni Ndreu – shkrimtarët tanë të pazëvendësueshëm. Nga libri "S'ka qetësi në Lisivalle", një libër i shquar dokumentar–letraro-romanistik, kam vjelë mbi 300 fjalë e shprehje të rralla të gjuhës shqipe për Kartotekën kombëtare të Fjalorit kombëtar të gjuhës shqipe në Institutin e Gjuhësisë. Janë fjalë Sllove e fjalë Dibre. Na i ka sjellë Xhelal Ndreu. Më tej, te Ndretë na vijnë emrat Mahmut Ndreu e Hasan Ndreu. Kemi edhe Ajet Ndreun, emrin e të cilit mban shkolla e mesme e Sllovës. Unë kam një shtesë: Lavdërim Ndreu. Në shkollën 7-vjeçare një vit më lart se unë. Ruaj në kujtesë diçka mbresëlënëse. Në një veprimtari festive ai këndoi këngën përmetare. "A kanë ujë ato burime?". Pse qe mbresëlënëse? Sepse ishte këngë qytetare. Sepse melodia na u duk tjetërlloj. Sepse mësuam fjalë që nuk i kishim në fjalorin tonë vetjak; por, as në fjalorin shkollor. Kemi edhe Lavdie Ndreun. Njerëzit kthenin kokën për ta parë. Sepse ishte e bukur. Nxënëse? Besoj - e dalluar në klasë. Unë kam njohur rastësisht Rizahun e Cen Elezit – Hysen Ndreut. Pasi kishte bërë burg, ishte kthyer në familje, në Tiranë, në Rrugën e Barrikadave. Një burrë shumë i edukuar. I pata treguar dy ngjarje me Elez Isufin, siç i kisha dëgjuar. M'i pëlqeu shumë. Bënte punime artistike të shkëlqyera me kashtë gruri.

Në Pashnjarë ka jo vetëm burra të shquar. Ka edhe gra e vajza. Zure Lahu, siç thamë. Dhe Kumrije Lahu. Në libër kemi disa faqe për Kumrijen. Kumrija është e para vajzë në krahinë që ka shkuar në shkollë të mesme e larg familjes. Kumrija ka titullin "Mësuese e merituar".

Libri i Hidajet Lahut është për Pashnjarën. Por edhe për Sllovën. Dhe pjesë e Sllovës janë edhe Ratket e Calet. Në Ratke është një krua, që s'ka të dytë në krahinë e më tej. Nga Ratkët na ka ardhur një libër mjaft i mirë nga Feriti. I rrënjës së përmendur të Ferateve është. Calet janë ata që morën pjesë të gjithë në Luftën Nacionalçlirimtare. Për ish-kryetarin e kooperativës, Qatip Calën, thoshin që tyta e pushkës i dilte mbi krye. Ishte aq i ri. Në punën ndërtimtare: Në Cale ka një dëshmor pune: Është traktoristi Faik Cala – Hero i Punës Socialiste. Kurse, i ati, Mustafa, ishte terzi. Ai i vishte burrat e krahinës me tirq e koparane (jakuce).

Ngjarjet e vogla bëjnë ngjarje të mëdha. Shihni në libër, për shembull, ndodhinë me Elez Isufin në Pashnjarë. Dhe zgjidhjen aq të mençur të Elez Isufit.

Jemi përsëri te burrat e burrërorët. Libri na çon pak si në skaj të Sllovës, në juglindje të saj. Janë burrat Selman, Halil dhe Dan Ndreu. I pari – farkëtar me emër. Kudhra e çekiçi i tij njiheshin edhe përtej krahinës. I dyti – Halili ishte violinisti virtuoz. I treti, Dani ishte valltari virtuoz që kërceu në Festivalin Botëror të Rinisë në Moskë.

Po të vijmë më këtej, janë Çoret. Një lagje gjithë pemë. Autori i librit përmend mjaft emra. Më së pari, tre dëshmorët e Luftës: Dalip Çorja, Naxhi Çorja, Telat Çorja. Janë vrarë nga nazistët gjermanë. Brenda një dite. Dhe brenda një dite – tri xhenaze e tri morta në lagjen e atëhershme të vogël. Dalipi pati qenë agronom. Një Miçurin i vërtetë. Dengu i Abedin Çiçit dhe i Xhavit Hysës. Në revistën "Bujqësia" (revista "Bujqësia socialiste" është shumë më e vonshme) ka shkruar edhe agronomi i ri nga Sllova. E kam lexuar vetë. Diku autori thotë në libër që sllovasit janë fodullë. Fodullë do të thotë sqimatarë. Çoret i njoh më shumë. Këta më duken shumë fodullë. Edhe trima. Me Luftën Nacionalçlirimtare u angazhuan në forma të ndryshme të gjithë.

Më ka thënë Hidajeti që kur të bëjë librin e dytë – mbase, në trajtë fjalorthi enciklopedik, me më shumë hollësi e përimtime, do të rreshtojë edhe emra të tjerë nga Sllova. Nga Pashnjara, për shembull, bijat, vajzat pashnjarase. Nga Calet: infermierin e palodhur Hamdi Cala. Edhe në punë, edhe në rrugë ai ishte si një parisien. Nga Çoret: Tafë Çorja (ka këngë si luftëtar kundër osmanëve; Mudë Çorja (i zënë nga serbët në Kaush, konfrontuar burrërisht me ta); Nuri Çorja (gojëtari), të cilit i ngjante i biri – Shemsiu; Shaqir Çorja (pasaniku në Stamboll); Hazis Çorja e Sadik Çorja (bujq të përmendur); Brahim Çorja (partizani); Shukri Çorja – kuzhinieri i spikatur i konviktit të shkollës pedagogjike në Peshkopi; Ismet Çorja (mësuesi model); Din Çorja (shitësi që nuk ra asnjëherë deficit, derisa doli në pension); Nazmi Çorja (kryetari i kooperativës); Hasan Çorja e Dilaver Çorja (mjekë të përkushtuar); djemtë e Xhevdet Çores (sot, firmë ndërtimi në Greqi) e shumë të tjerë. Lashë për në fund dy emra të nderuar – dy vëllezër: Sulë Çorja e Xhelil Çorja. Sula qe mjeshtër sporti në qitje. Ka përfaqësuar Shqipërinë në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare. Xhelili qe elektricist. Mjeshtër. Hidrocentrali i parë në Dibër, për qytetin e Peshkopisë (me ujin e Përroit të Llixhave) është bërë nga Xhelil Çorja. Dhe, e dini si? Me "turbinë" me fletë si të mullirit. Djem Sllove qenë. Te Zhugrret: dy vëllezërit – bletërritësi i përmendur, Qaniu dhe oficeri i nderuar, Rexhepi e vëllezërit e tjerë, Xhevati e Ekremi – me një kulturë pune shembullore. Në Ratke: Abazi e Bezati. Dhe Feridi i sotëm. Letrar e historian. Samiu – valltari virtuoz. Dhe ka kërcyer në skenat e Moskës. Po te Kaçakët? Mbajmë mend dy mjeshtër ndërtimi – babë e bir: Islami e Fiqiriu.

Autori flet për veshjen e burrave dhe të grave. Na tërhoqi vëmendjen fjalia: *Në Sllovë është përdorur fustanella*. Sigurisht, autori e ka të vërtetësuar këtë. Dhe atëherë, Sllova nuk mund të jetë rast i veçuar, çka do të thotë, që fustanella duhet të jetë përdorur në të gjithë krahinën e më gjerë. Etnografët kanë vërtetuar se fustanella është përdorur edhe në Veri. "Fustanella dokumentohet që në lashtësi me disa gjetje arkeologjike të shekullit IV-III p.e.r." (Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, f. 296). Dimë që grekët e kanë huazuar fustanellën nga ne shqiptarët. Thuhet që fustanellën e kanë huazuar edhe skocezët (keltët nga ilirët). *Kilt* është fjala angleze për *fustanellë*. Edhe një fjali për fustanellën: Në një letër që Bajroni ia çon së ëmës, i thotë: "Shqiptarët kanë petkun më të bukur në botë – fustanellën e gjatë, të bardhë." Do të ishte interesante të zbulohej më tej cila ka qenë veshja me fustanellë. Vishej mbi tirq apo mbi kofsharë? Ka qenë e bardhë, e murrme apo e zezë? Ndoshta, e bardhë sepse është pëlqyer e bardha (kemi parasysh këmishën e bardhë dhe tirqit e bardhë). Deri kur është mbajtur? Dhe, sigurisht nuk bëhet fjalë vetëm për Sllovën. Gjurmimi është edhe për më tej.

Sllovasit (Pashnjarasit) janë fodullë, - u tha pak më sipër. Ja ç'thotë në libër një këngë dasme:

Ne kjo Sllova me lëndina,
Për m(j)edisi kalon maqina;
Kalon maqina e shkon vetura,
Gjem (= djem) e nuse janë fodulla.

Fodullë, por të punës. Emil Zolá (1840-1902), shkrimtar e publicist francez thotë: "Unë kam pasur të vetmin besim, të vetmen forcë – punën, punën ... Puna është i vetmi ligj që drejton botën. Jeta nuk ka qëllim tjetër. Ekzistenca nuk ka kuptim tjetër. Të gjithë ne vijmë në këtë botë vetëm për të marrë pjesë në punën e përbashkët...". Sllovasit i kemi të punës. Nuk janë vetëm fodullë. Dhe punën e tregojnë arat e pemët.

Sllovasit janë besnikë të kodit zakonor. Shih në libër atë që ndodhi me Elez Isufin. Edhe i fuqishmi ulet para rregullit e itifakut. Unë jam nga Vlesha. Vlesha është fqinje me Sllovën, më saktë, me Pashnjarën. Është fqinje në fushë, tek ujërat, te përrenjtë. Dhe pashnjarasit janë ai fqinji i mirë që nuk të cyt as me dorë e as me fjalë.

Libri na josh e na kënaq edhe me fotot. Aty sheh Kaushin – atë pikën e veçantë të vrojtimit, Gurin e Zi – një pikë tjetër më e lartë vrojtimi, rrugën e asfaltuar automobilistike, toka të sistemuara e pemëtore, trumza e tërfil,

Autori flet për veshjen e burrave dhe të grave. Na tërhoqi vëmendjen fjalia: *Në Sllovë është përdorur fustanella*. Sigurisht, autori e ka të vërtetësuar këtë. Dhe atëherë, Sllova nuk mund të jetë rast i veçuar, çka do të thotë, që fustanella duhet të jetë përdorur në të gjithë krahinën e më gjerë. Etnografët kanë vërtetuar se fustanella është përdorur edhe në Veri.

shkollat e shtëpitë, një mjedis të shëndetshëm e plot ajër e dritë. Në Sllovë ka diell, - thotë autori, - se ka relievin për diell. Ka edhe vlagë. Dhe rrënjët e pemëve zgjaten drejt vlagës; majat zgjaten drejt diellit. Prandaj ka aq pemë. Duket sikur pemët, sidomos kumbullat shtohen vetiu. Mollët i kultivojnë. Çekët patën thënë (po e përsërisim): "S'kemi hasur askund në Europë mollë kaq erëkëndshme". Ndoshta këtë aromë ua jep vlaga dhe dielli. Kundroni fotot, të bindeni për këtë. Nganjëherë, fotot flasin më shumë se fjalët. Dhe na bëjnë t'i hapim zemrat natyrës që na rrethon dhe ta sjellim bukurinë e saj brenda vetes. Le ta shohim bukurinë natyrore të Sllovës e të pasurohemi me të! Le ta shohin e të pasurohen me të – dhe të çmallen, sidomos ata që përkohësisht jetojnë larg Sllovës e larg Pashnjarës! Te paktën, të flladiten me të në feisbuk e jutub.

Për Pashnjarën e krejt Sllovën flet Kaushi. Flet Lapidari. Flet memoriali për dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare. Flet edhe ky libër i zotit Hidajet Lahi. Po t'i perifrazonim me një fjali këto që u thanë për librin e Hidajet Lahut, fjalia do të ishte: Kjo është Pashnjara. Kjo është Sllova.

Libri na josh edhe ne të tjerëve të shkruajmë. Për çfarë? Për shumë gjëra. Në libër thuhet se deri nga fillimi i viteve '50 sllovasit e bënin pazarin në Tiranë. Për kripë e vaj guri shkonin. Nga Bulqiza e tej - nëpër Rrugën e Arbrit. Nëpër këtë rrugën, që sot është automobilistike e që e presim të përurohet sa më shpejt. Zakonisht, shkonin vargan. Dhe, në këto udhë me varganë kishte edhe biseda, humor, histori. Mund të shkruhet edhe për to. Edhe për shqipet. Dhe shqipet, - thotë autori, - fluturojnë në trajtë gjysmërrethi: Gjipsi i Vleshës - Kalis. Me zë të çjerrë. Me krrau-krrautë. Tani na duket se nuk ka më shqipe. Edhe për këtë mund të shkruhet. Mund të shkruhet për këngët që këndohen aq gëzueshëm në dasma. Mbi të gjitha, mund të shkruhet për njerëzit. Për njerëzit që gjejnë të mirën dhe gëzimin. "Mundohu të gjesh gëzimin në jetë, - thotë Benjamin Franklin (një udhëheqës i luftës për pavarësi në SHBA (1706-1790). Kjo është mënyra më e mirë për të të ardhur lumturia." Libri i Hidajetit na ka çuar te njerëz të tillë.



Rruga e Arbërit nr. 196

Historia e fisit Capa është historia e ndritur e një fisi që luftoi për qëndresë dhe mbijetesë ndaj të huajit, sidomos ndaj pushtuesit serb.

monografi

“Mexhit Capa dhe krahët e fisit”, *një monografi studimore e Mevlud Bucit*

Nga **QAZIM SHEHU**

Libri “Mexhit Capa dhe krahët e fisit” i autorit Mevlud Buci, është libri i tij i tridhjetë, një monografi e shkruar me kompetencë faktologjike dhe me trajtesë të veçantë me shumë vlera. Që në fillim, autori na shpjegon se cila ishte arsyeja pse e shkroi këtë libër. Sipas tij dhe asaj ç’ka duket se është më e drejtë:”Historia e gjurmëve të fisit është historia e atdheut”. Kjo sentencë ka një kuptim domethënës sot në kohërat e reja, kur mjaft gjëra hutohen nga moderniteti ynë. Duke u ndalur në këtë rrjedhë mendimesh, të cilat vetvetiu ta krijojnë imazhin e individit dhe të kohërave në kuptimin përbashkues, nuk ka sesi të mos e vlerësosh këtë sentencë të rëndësishme, e cila mbetet shumë e vlerëshme dhe domethënëse.

Në librat e tij, Mevludi, (ky dhe të mëparshmit) mbështet në një lëndë jetësore të pasur, në gjurmime të jetës së njerëzve, të traditave, bën lidhje të viteve të shkëputura për shkak të dramave dhe lëvizjeve (fisi Capa lëvizi nga Katër Grykët dhe u vendos në Dibër të Madhe), evidenton të shkuarën dhe të sotmen duke krijuar marrëdhënie kohore dhe hapësinore mes tyre, po kështu ngrë lart njerëz të suksesit që kanë çarë në jetën e tyre përmes punës dhe ndershmërisë. Këta njerëz të suksesit autori i shqyrton dhe spikat tek ta humanizmin, bujarinë, mirësinë, vlerën e tyre kombëtare dhe humane në shërbim të njerëzve në nevojë. I tillëështë edhe Mexhit Capa, njeriu-bujar i Dibrës së Madhe dhe për këtë bindemi gjatë leximit të librit.

Historia e fisit Capa është historia e ndritur e një fisi që luftoi për qëndresë dhe mbijetesë ndaj të huajit, sidomos ndaj pushtuesit serb. (Sal Capa, në tetor 1913 me nipa dhe vëllezër e kushërinj sulmoi dhe asgjësoi 6 topçinj serbë dhe doli fitimtar, f. 9). Po kjo e dhënë dhe të tjera që lexuesi do t`i gjejë me bollëk në libër dëshmon për luftën e pandërprerë patriotike të Dibrës në tërësi, e cila ka qenë historikisht një krahinë e ekspozuar ndaj sulmeve të huaja, një luftë me faqe të ndritura të heroizmit masiv dhe të individëve të veçantë, krerë të organizimit të kryengritjeve popullore.

Në faqet e librit, me hulumtime mbushamendëse, autori bën një përvijim të shpejtë dhe konciz të lashtësisë së Katër Grykëve, të lëvizjeve të fiseve, po kështu, aty nga mesi i librit do të gjejmë edhe pemën gjenealogjike të tyre, e cila jepet në mënyrë të detajuar dhe me kuptimësi. Dhe nga këto gjurmime rezulton se kjo trevë ka qenë “e populluar që në shekullin XI(p. e. s dhe mjaft toponime janë iliro-romake), të cilat autori i përmend.

Autori është i detyruar t`i bëjë këto shpjegime, për tëvijuar pastaj në rrugëtimin e tij historiko-letrar, në përvijimin e kuadrateve rrethanore të lëvizjeve të fisit Capa dhe për të na treguar se gjërat nuk janë rastësore, por ata e kanë themelin në një traditë të fortë të të parëve. Duke ardhur në kohërat e mëvonshme, autori vëren se kjo traditë ka vijuar gjithnjë të qëndrojë në forcimin e saj vetëm në një kah:ruajtjen e vlerave. Këtu spikatin sidomos ngjarjet që vijnë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ku autori spikat disa figura nga Selishta(Molla Limani, Molla Hoxhë Buci) të përmendura dhe të trajtuara gjerësisht këto figura në librin e tij momografik për Hoxhë Bucin.

Ky sfond kohor me ngjarje të shumta, luftëra dhe përpjekje, nuk mund të kuptohet veçse si rrjedhë e vështirë e atyre ngjarjeve dramatike, të mbruajtura me sakrifica e vullnet për të ruajtur etninë dhe qenësinë kombëtare.

Në përshkrimin e figurës së Mexhit Capës(për të çilin është shkruar edhe libri), autori, pasi bën një biografi jetësore të tij(f. 32-35) arrin të spikatë formin intelektual,





cilësitë e personalitetit, si: korrektësia, guximi, mençuria, në ndërmarrjen e projekteve të rëndësishme , të cilat sjellin sukses, por kanë edhe risk, siç është ndërmarrja e Banjave të Dibrës. Në përshkrimin e figurës së njeriut të suksesit në biznes, Buci nuk harron të evidentoj faktin e portretit të njeriut të punës dhe të hapjes së mundësive për të tjerët(numri i punëtorëve në këtë ndërmarrje 250 vetë).

Kjo është njëra anë e personalitetit të Mexhit Capës, që autori e pasqyron me një përshkrim të shkurtër duke qëmtuar vetëm detajet më interesante. Natyrisht mbetet një anë e rëndësishme, duke theksuar rëndësinë e një njeriu me tiparet e punës, prej nga burojnë edhe cilësitë e tjera që sjellin dobi për vete dhe për të tjerët. Puna është shëndeti më i fuqishëm moral dhe ajo çfarë përbën burimin e këtij shëndeti.

Për punë e tij dhe ndihmesën që ka dhënë, Mexhiti ka marrë shumë mirënjohje nga organizata të ndryshme, si nga Veteranët e UÇK-së, nga Klubi i Karatesë, Dibër, si dhe Cerifikatën e Mirënjohjes nga Presidenti i Shqipërisë. Këto mirënjohje vijnë si ecuri e vazhdueshme e vlerësimit të merituar për njerëz të punës dhe të suksesit.

Duhet thënë se Buci e ka parë figurën e tij jo vetëm si njeri të suksesit, me ç`rast: biznesmen, por edhe si një figurë humane dhe me përgatitje të lartë profesionale, si një figurë e përmendur për mjaft çilësi të cilat lidhen me traditën, prejardhjen dhe ruajtjen e identitetit shqiptar, të cilin ai e manifestron aq bukur në veprimtarinë e tij. Kjo ka bërë që emri i tij të përmendet me respekt “në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, si një organizator i zoti i Odës Ekonomike dhe dibranofil”(citim nga autori f. 87).

Janë një numër poezish të shkruara për Mexhit Capën nga Mevlud Buci, autor i disa librave me poema dhe balada. Në baladën”Burri i dibranisë”, kushtuar Salë Xhemail Capës, i cili bashkë me vëllanë Destanin, me djem e nipër më 1913 asgjësoi topçinjtë serbë, lexojmë:”Në luftim/trup me trup/si shqipja arbnore/asgjësoi topçinjtë/Brenda në llogore”. Dhe ja sa bukur e karaketrizon portretin e Mexhit Capës në një baladë kushtuar atij:”Në ballë tëçdo shqote/porsi shqiponja/nëpër epoka/Mexhit Qazimi/Me dritë djerse/dritë jehonë/vrull i pandalur/si valë Drini”. Në poezinë tjetër”Dritë arbnore”, kushtuar Bajram Xhetan Capa, poeti do të shprehet:”Bajram Dibra/zëi shtrëngatës/zgalem kunore/Bajram Xhetani/Bir i Capës/Dritë arbnore”. Në mjaft poezi, balada, ndihet toni panegjirik-vlerësues për fisin Capa, për figura të ndritura të këtij fisi(Kujtim Capa, Naile Capa, Lahim Capa, Malë Capa, Dalip Capa etj).

Libri është konceptuar duke vënë në qendër të tij figurën e Mexhitit, por pa harruar



Në librat e tij, Mevlud Buci mbështet në një lëndë jetësore të pasur, në gjurmime të jetës së njerëzve, të traditave, bën lidhje të viteve të shkëputura për shkak të dramave dhe lëvizjeve (fisi Capa lëvizi nga Katër Grykët dhe u vendos në Dibër të Madhe), evidenton të shkuarën dhe të sotmen duke krijuar marrëdhënie kohore dhe hapësinore mes tyre, po kështu ngre lart njerëz të suksesit që kanë çarë në jetën e tyre përmes punës dhe ndershmërisë. Këta njerëz të suksesit autori i shqyrton dhe spikat tek ta humanizmin, bujarinë, mirësinë, vlerën e tyre kombëtare dhe humane në shërbim të njerëzve në nevojë. I tillë është edhe Mexhit Capa, njeriu-bujar i Dibrës së Madhe dhe për këtë bindemi gjatë leximit të librit.

njerëzit e tjerë të fisit, Mexhitin me familjen, fëmijët e vet të shkolluar e të sukseshëm, por edhe kushërinj e njerëz të afërt, si një fis që e përbashkon dashuria për gjenezën si kujtesë krenare(për Katër Grykët), dashuria për truallin, për jetën, për punën, duke konturuar e mbajtur në stad të mirëfilltë lavdërues disa vlera dhe tipare të qenësishme, si njerëz me rrënjë të forta në histori.

Natyrisht duke e ndërtuar librin me këtë strukturë tematike, Buci ka arritur të na krijojë imazhin e plotë të njeriut të sotëm e në kohë duke e parë zhvillimin e personalitetit të tij të ndërlidhur me truallin, traditat, rrethanat, regjimet, por edhe me ndarjet administrative shtetërore e rajonale. Ai ka dashur të tregojë dhe ia ka arritur qëllimit ta shprehë shkencërisht këtë, se njeriu sa zhvillohet si qenie individuale, aq kuptohet dhe shihet si qenie kombëtare dhe social-kulturore e tij, duke na dhënë një portret të plotët Mexhit Capës, por edhe të fisit të tij, të kohës, viteve, rrethanave dhe shfrytëzimit të tyre.

Libri ka një ritëmleximor mjaft të kënaqshëm, duket se Mevlud Buci ka shfrtytëzuar mirë një lëndë të pasur jetësore të siguruar nga arkivat dhe sistemimet e tij nëpër kohë, nga kontaktet e drejtpërdrejta, nga vëzhgimet e kohërave të reja dhe nga të stërviturit e penës për të shkruar monografi. Shkruar me një stil të rrjedhëm ku lakonizmi i frazës të bën përshtypje dhe njëkohësisht me një korrektesë në citime e referime, ai të tërheq pikërisht për këtë, por edhe të frymëzon për ngrohtësinë dhe sinqeritetin e rrëfimit. Udhëtimi nëpër kohë dhe gjetja e fillit të tyre, për të kuptuar dhe kapur filozofinë e jetës del përmes njohjes së kohës dhe shpalosjes së vlerave të saj, të cilat manifestohen në qëndresën morale të njeriut malësor i cili në kërkim të një jete më të mirë di t`i derdhë e kanalizojë energjitë e tij në dobi të vetes e të të tjerëve, duke u bërë model për të tjerët. Dhe ky është Mexhit Capa, dhe Buci që ka shkruar një monografi që e shpalos bukur figurën e tij, në mënyrë bindëse e me një stil të rrjedhshëm.

profil

Mësues Farisi po shijon pensionin mes Dibrës dhe Tiranës. Ai nuk është mësuar të qëndrojë pasiv as në mundje, as në arsim dhe askund tjetër. Ai ka krijuar një fermë interesante me të gjitha llojet e pemëve frutore dhe kalon aty kohën e lirë. Ka mbjellë dhe 90 rrënjë arra turke, që tashmë janë në vitin e tretë dhe kanë filluar të prodhojnë kokrrat e para. Është kjo një parajsë e vogël, dhuratë nga Zoti, për atë kontribut që mësues Farisi i ka dhënë shoqërisë për shumë e shumë dekada.

Faris Cibaku, *sfidanti i pamposhtur*

Nga **OSMAN XHILI**



Mësues Farisi nga Sohodolli i Dibrës nuk është shumë i madh në trup, por është i madh në karakter, në vepra e vlera njerëzore. Ai diti ti fitojë këto vlera, si dhe respektin e të gjithë njerëzve që e rrethojnë, falë punës dhe përpjekjeveqë ai bëri, që nga fëmijëria e deri më tani. Që i vogël i pëlqente sfida. Donte të sfidojë notën e mirë, të sfidojë malin e Korabit, ku bënte dru me mushkë.

As vetë nuk e diti se si kaluan vitet e rinisë dhe mbarimi i gjimnazit të Peshkopisë. Një ditë e pa veten me bursën e fituar për gjuhë-letërsi në Shkodër. U nis me një valixhe druri në dorë, siç ishin gati gjithë moshatarët e asaj kohe. U nis me premtimin se do të bëhej dikushi në jetë.

Ishte viti i parë, kur ata bënë zborin ushtarak në Bardhaj të Shkodrës. Aty, nëpër kashtë, studentët e rinj kapeshin në mundje me njëri-tjetrin dhe Farisi, trupimët, ra në sy, pasi lëshonte në tuç dhe disa me peshë më të madhe. E gjitha kjo ishte krejt natyrale, pasi deri atëherë nuk kishte qenë asnjë ditë në stërvitje të këtij lloji. Kur u kërkuan studentë për mundjen në spartakiadën kombëtare universitare, u përzgjodh dhe Faris Cibaku për të përfaqsuar Universitetin e Shkodrës. Mjeshtra të mëdhenj të kohës, si Iljaz Guri dhe Naim Pepa, e stërvitnin tre orë në ditë dhe studenti i ri i fitoi deri në perfeksion shumë reflekse të sportit të mundjes. Në muajin shkurt të atij viti ai fitoi vendin e dytë në shkallë republike.

Në mars të atij viti, dy dajallarët e babës së tij u dënuan me pushkatim nga regjimi i kohës. Me shumë ndërhyrje, kjo masë u kthye në dënim të përjetshëm. Në raste të tilla, jo vetëm familja, por i gjithë rrethi familjar "infektohej" politikisht. Një re pluhuri do të binte dhe mbi studentin Faris Cibaku, në dilemë për ta përjashtuar nga shkolla dhe nga sporti.Sjellja e tij e mirë, rezultatet e larta në mësime e në mundje i mundësuan atij vijueshmërinë e punës. Shumë shpejt, ai u shpall kampion kombëtar në peshën e parë dhe më pas dhe në të dytën. Emri i tij do të lakohej me shumë respekt në federatën e mundjes dhe në shtypin e kohës. Por, dhe pse bënte gati tre orë stërvitje në ditë, studenti i ri, kurrë nuk do të harronte qëllimin primar, mbarimin e universitetit me rezultate të shkëlqyera. Mësues Farisi dhe sot e kësaj dite përmend emrat e atyre kolosëve të gjuhës dhe shkencës të asaj kohe, profesorë të tillë si Jup Kastrati, Kolë Ashta, Tomor Osmani, Simon Pepa e shumë të tjerë. Ata u mësuan studentëve, jo vetëm shkencën, por dhe dashurinë për profesionin dhe të respektonin njerëzit. Në korrik të vitit 1975 studenti Faris Cibaku diplomohet për gjuhë dhe letërsi. Në nder të tij, klubi i sportit në Shkodër shtrojnë një banket, duke i bërë dhe disa dhurata simbolike, kostum, këmishë me vija, kollare dhe një termus. I blejnë dhe biletën e udhëtimit për tu kthyer në Dibër. Ishte mbyllur një kapitull mjaft i bukur me Shkodër loken, për të hapur një tjetër në vendlindjen e tij.

Mundja tashmë kishte zënë vend në tërë qenien e tij dhe ai nuk ju nda këtij sporti për më se çerek shekulli. Vazhdoi të marrë pjesë si mundës i Korabit,duke zënë disa herë vende nderi dhe duke ndikuar pozitivisht në renditjen e ekipit. Më tej, Faris Cibaku merr përsipër detyra si drejtues i ekipeve të moshave të ndryshme. E shohim atë të si trajner i ekipit të Korabit për të rritur, duke debutuar me sukses në kampionatin e organizuar në Vlorë. Për më se dy vjet të tjera provoi detyrën e trainerit të të rinjve, ku mundësi Musa Gjura u shpall kampion në Berat. Shumë kënaqësi i dha mësues Farisit detyra e trajnerit të para të rinjve. Fshati i tij, Sohodolli, u bë epiqendër e këtij sporti për të rinjtë e pasionuar pas mundjes. Aty sollën dhe një tapet mundje profesional, ku ushtroheshin të rinjtë. Në kampionatin kombëtar të zhvilluar, Korabi u përfaqsua dhe me tre të rinj të talentuar, si Xhelal Haraçiu, Seit Huta, Ermir Tafa dhe shumë të tjerë. Në vitin 1990, Faris Cibaku u shkëput nga sporti i mundjes, ku la aq shumë gjurmë me medalje të fituara, apo me breza mundësish të rinj, të cilëve u dha gjithë eksperiencën e tij, të fituar ndër vite.

Është shumë e vështirë të fusësh në një emrues të përbashkët, kaq shumë obligime, sa pati Faris Cibaku. Ai vazhdonte sportin e mundjes, ndërkohë, që shërbente si mësues në fshatin Vranjt. Për gati tetë vjet ai bënte pesë orë rrugë në këmbë dhe më pas vazhdonte tre orë stërvitje. Natën vonë i takonte të shkojë te shtëpia e tij, ku i duhej të bënte planet dhe përgatitjen për ditën e nesërme. Por dhe në këto kushte disi të vështira, ai përpiqej të gjente kohën për fëmijët e shkollës, që e prisnin me padurim për të diskutuar një tregim, apo një libër të riqë kishin lexuar, për të bërë analizën e pjesëve të fjalisë, apo si do të organizonin konkursin e fjalës artistike. Vetëm një pale u kishte hyrë në hak, fëmijëve dhe familjes së tij. Kur ai bëhej gati për të nesërmen, fëmijët i kishte kapitur gjumi dhe babait nuk i mbetej tjetër, vetëm se tu jepte nga një puthje të lehtë, si një falje për kohën, që nuk u kishte kushtuar.

Kështu kishin ikur vite të shumtë dhe mësues Farisi përplasej sa në një stacion në tjetrin dhe kudo linte gjurmë të pashlyera, në kujtimet e fëmijëve të shkollës. Në vitin 1985 Faris Cibaku shërbente si mësues në Vranjt, ndërkohë, që vjen një ekip pune i ministrisë së arsimit, i cili qëndroi për tre ditë te shkolla e tyre. Ekipi i ministrisë vlerësoi mjaft punën e kolektivit të mësuesve të kësaj shkolle, kurse mësues Farisi meritoi medaljen "Naim Frashëri", si një shembull, që duhej të ndiqej nga të tjerët.

Faris Cibaku shërbeu si mësues edhe në Sohodoll, në gjimnazin e Kastriotit, në gjimnazin e Peshkopisë, në shkollën "Demir Gashi" dhe kudo dha më të mirën që kishte nga shpirti dhe përvoja e pasur. Duke parë cilësi të tilla dhe aftësi organizative, jo pak kohë dhe jo pak herë, ka qenë si lidership i disa shkollave elitare të rrethit. Plot kompetencë, ndershmëri e profesionalizëm, Faris Cibaku shërbeu si drejtor i shkollës së Sohodollit, i shkollës "Demir Gashi", i gjimnazit të Peshkopisë, apo i shkollës Pedagogjike të qytetit. Mësues Farisi ka dhënë ndihmesën e tij si formator në seksionin e arsimit, si inspektor i gjuhës dhe letërsisë, si kryeinspektor i D.A.R. sëdhe si përgjegjës i sektorit të kualifikimit të mësuesve për qarkun e Dibrës. Të gjitha këto pozicione, sa të vlerësuara e të merituara, aq dhe të vështira për ti menaxhuar me sukses, janë diamante që varen në qafën e tij, siç vareshin dikur trofetë e sportit të mundjes.

Familja e mësuesit Faris Cibaku shkëlqen nga vlerat dhe shkollimet që ka. Dy prindërit, Farisi me të shoqen dhe katër fëmijët e tyre kanë mbaruar universitetet. Dy vajzat, Edlira dhe Jurida kanë ndjekur rrugën e babait, degën e gjuhës dhe letërsisë. Sot janë mësuese, përkatësisht në gjimnaz dhe në shkollën "Demir Gashi". Djali i madh, Gentiani, ka mbaruar akademinë e sporteve dhe atë ushtarake. Ai ka qenë në misione paqeruajtëse në Afganistan, Bosnje, specializime në Amerikë, Gjermani dhe shumë shtete të tjera dhe sot mban gradën e majorit në forcat e armatosura. Riza Cibaku, vëllai tjetër i tij, ka mbaruar universitetin e sporteve në Tiranë dhe jep mësim në gjimnazin e Peshkopisë.

Në luftën e Kosovës familja e tij i hapi dyert cep më cep, duke treguar se bujaria nuk është një simbol i të kaluarës, por një gen i gjallë dhe i pavdekshëm i familjes shqiptare. 42 persona nga Vushtria e Kosovës qëndruan për tre netë në familjen e tyre, kurse 17 prej tyre vazhduan të strehohen aty dhe për dy muaj e gjysëm të tjerë.

Mësues Farisi po shijon pensionin mes Dibrës dhe Tiranës. Ai nuk është mësuar të qëndrojë pasiv as në mundje, as në arsim dhe askund tjetër. Ai ka krijuar një fermë interesante me të gjitha llojet e pemëve frutore dhe kalon aty kohën e lirë. Ka mbjellë dhe 90 rrënjë arra turke, që tashmë janë në vitin e tretë dhe kanë filluar të prodhojnë kokrrat e para. Është kjo një parajsë e vogël, dhuratë nga Zoti, për atë kontribut që mësues Farisi i ka dhënë shoqërisë për shumë e shumë dekada.







Pse mungon një nga "Nandë Malet" e Dibrës në Memorialin e Gjoricës?

(Vijon nga faqja 9)

Ndaj këtij akti absurd dhe të turpshëm që injoron historinë e një treve lavdiplote ka reaguar edhe sttudjuesi i mirëfillë i historisë Bashkim Lami, njëherësh kryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore "Bulqiza".

Nisur nga sa më sipër, gjithkush mund të mendojë se përjashtimi i Muhurrit nga "NANDË MALET E DIBRËS", në memorialin e Gjoricës përbën shtrembërim (në mos fallsifikim) të qëllimshëm të historisë. Pikërisht, për të ndriçuar këtë të vërtetë të pamohueshme historike, por rendisim disa fakte që e ngrenë Muhurin në peidestalin qëi takon.

SHPIRTI LIRIDASHËS I MUHURRAKËVE...

Shpirti liridashës i muhurrakëve është manifestuar në ngjarjet më kulmore të Historisë së Dibrës e të gjithë Shqipërisë. Parë në kontekstin historik, historia e kësaj krahine është pjesë e qënësishme e historisë së krejt Dibrës. Duke nisur që nga pushtimi turk, ashtu si Malësia e Dibrës ose "Nandë Malet e Dibrës" edhe Muhurri si njëri prej këtyre maleve nuk i është nënshtuar këtij sundimi.

"Në Malësinë e Dibrës (Nandë Malet) hynin: Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri dhe Luznia në Dibër të Poshtme dhe Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza, Katër Grykët në Dibër të Epërme. Por sipas historianit Moisi Murra: "Gjithashtu është quajtur Malësi, d.m.th., hynin në 'Nandë Malet e Dibrës' dhe katundet e Gollobordës Përëndimore (Okshtun, Prodan, Zabzun, Sebisht, Borovë, Muglicë, Llangë). ("Dibra nga Antikiteti në Monarki", Mosi Murra - fq.87).

Në shkurt të vitit 1833 kryengritësit e Çidhnës, nën udhëheqjen e Vesel Lushës, Sali Nokës e Ali Tafës refuzuan me forcë regjistrimin e ushtarëvë nizamë....Brenda një kohe të shkurtër kryengritja u shtri në Çidhën, në Dardhë, Muhurr, Luzni, në Grykë të Vogël e Bulqizë". (P.Thëngjilli - "Kryengritjet popullore kundër osmane në Shqipëri, 1833-1839") fq. 127-128, Tiranë 1981).

Një autor anonim, në vitin 1866 ka shkruar: "Nandë Malet Dibrës, apo Malësia e Dibrës paraqet thelbin e vërtetë shoqëror të Gegërisë. Atje gjenden të ruajtura doket e vjetra shqiptare, si dhe Kodi i pashkruar i Skënderbeut, i bartur brez pas brezi, gjer në ditët e sotme me dlirësinë e tij të lashtë". Këtë e dëshmojnë edhe studimet e historianit e studiuesit të mirëfilltë të historisë, Xhemal Berisha, kur ai argumenton domosdoshmërinë e bashkimit të disa krahinave në Shqipërinë Veriore, duke krijuar një njësi specifike që u quajt "Mal".

Burimet turke thonë se Malet e Dibrës janë njohur e kanë vepruar me këtë emër që në kohën e Skënderbeut. Feti Pasha, sociolog, politikan, diplomat turk, ka shkruar: "Nëntë Malet e Dibrës së Poshtme dhe të Epërme formojnë atë krahinë, si të thuash klasike, roli i së cilës ka ushtruar gjithmonë ndikim të madh jo vetëm në problemet (punët) shqiptare, por dhe në ata ballkanike. Skënderbeu, falë Dibrës mundi të konsolidojë pushtetin e vet duke përballuar për 24 vjet ushtritë tona. Midis tij dhe gjeneralëve tanë, përfundimi i luftimeve varej gjithmonë nga mposhtja e 'Nandë Maleve' të dy Dibrave. Atje është zemra e Shqipërisë. Porta e vërtetë e Shqipërisë është kurdoherë atje". Do të mjaftonte qoftë dhe vetëm ky perifrazim për ta bërë çdo muhurrak të ndjehet krenar me historinë e lavdishme të Muhurrit si pjesë e Nandë Maleve të Dibrës. Kjo edhe për faktin se për nga rëndësia e madhështia, përfaqësimi i Muhurrit në Kuvendet dhe betejat e Maleve të Dibrës, është pika më e shndritshme në historinë e tij.

NEZIR LLESHI I MUHURRIT, NË GARDËN E ALI PASHË TEPELENËS

Në korrikun e vitit 1812, në Dibër u përqëndruan forcat e koalicionit të Pashait të Janinës nga njëra anë dhe ata të beut të Dibrës nga ana tjetër. "Ali Pashë Tepelena, i gjendur para presionit të Portës së Lartë dhe forcave të bashkuara të pashallarëve gegë, të viseve verilindore, u detyrua të tërhiqet. Në traditën gojore thuhet se në fshatin Moravisht (sot administrohet nga Shkupi) plasën pushkët e para. Në një kullë të tipit kala qëndronte kapedan Kondesha (Konesha) nga Çidhna e Dibrës së Poshtme, me 15 veta (mes të cilëve edhe Nezir Lleshi nga Muhurri), i cili bëri qëndresë të fortë, por më së fundi u vra bashkë me disa prej luftëtarëve të tij....". (Stavri N.Naçi, "Pashallëku i Shkodrës", fq.116, Tiranë 1986.)

"Pavarësisht humbjes që pësoi në Dibër, Ali Pasha i kishte vlerësuar dibranët për urtësinë, burrërinë, besën dhe trimërinë, prandaj bëri përpjekje dhe afroi afër vetes shumë krerë të Dibrës si: Mete Demën e Homeshit, Demir Lushën e Çidhnës, Cen Lekën dhe Has Kajën e Zogje, Dalip Karajn e Bulqizës, Nezir Lleshin e Muhurrit, etj. Në gardën e Pashait të Janinës shërbyen me forcat e tyre shumë dibranë e matjanë". (H.Stërmilli, "Dibra në prag të historisë", dorëshkrim, 1940, fq.15.)

"Në vitin 1872, Malet e Dibrës lidhën besë për të luftuar kundër turqve osmanë. Luftimet në Kastriot, Sllovë. Muhurr, Zogjej e Bulqizë u shkaktuan dëme të mëdha forcave të ushtrisë turke të Demir Pashës që erdhën për të shtypur kryengritjen në Muhurr". (Fatos Daci, "Kuvendet e Dibrës, parlamente demokratike të kohës").

Malet, si njësi administrative vetëqeverisëse, ashtu si dhe bajraqet në disa pjesë të vendit (edhe në Lurë), lindën në shekullin XVII. Malet kishin edhe krahun e vet të armatosur për rast lufte, dhe kur jepej kushtrimi për luftë kundër pushtuesit, mobilizimi bëhej "burrë për shtëpi" ose "burrë për pushkë". Vendimet merreshin në Kuvendin e Malit, ku caktohej edhe komandanti ushtarak dhe shtabi i luftës.

NANDË MALET E DIBRËS, NJË "SHTET" BRENDA SHTETIT

Ashtu si në vitet 1800 të shekullit XIX, kur Malet e Dibrës u riorganizuan dhe, të mbështetur në forcat e veta, u bënë një "shtet" brenda shtetit, aq sa Stambolli nisi t'i konsideronte si Mbretëri, ato qëndruan të bashkuara edhe në kohët e mëpastajme. (Moisi Murra, "Dibra nga Antikiteti në Monarki", fq.92.). Sipas historianit të mirënjohur M.Murra, "E gjithë veprimtaria e Maleve të Dibrës mbështetej në 'institucionin" e besës, institucion i cili, në Kuvendin e Dheut përfaqësohej nga pleqtë që formonin pleqësinë dhe nga të parët që formonin parinë".

Më tej, në faqen 93 të librit "Dibra nga Antikiteti në Monarki", Moisi Murra shkruan se ajo që u dha emër Maleve të Dibrës dhe që pranohet njëzëri nga të gjithë studiuesit, ka qenë bashkimi i tyre në luftën kundër Hajredin Pashës më 1844. Në këtë vepër dinjitoze, për herë të parë gjejmë përfaqësimin e Muhurrit nga Kurt Hoxha e Tahir Abazi në Kuvendin e Nandë Maleve të Dibrës, të thirrur në maj 1910 nga Mersim Dema tek Gropa e Ukut, në perëndim të katundit Boçevë, ku u vendos t'i përgjigjeshin me kryengritje të armatosur ekspeditës famëkeqe të Tërgut Pashës. Po ashtu, Kurt Hoxha, si edhe Halil Kaloshi e Jusuf Bej Karahasani do të ishin në mbështetje të vendimeve të Kuvendit të Maleve të Dibrës, të thirrur nga Mersim Dema në pranverën e vitit 1912 te Gurra e Mazhicës për ringjalljen edhe njëherë të kuvendeve tradicionale të maleve.

Krerët e Maleve janë mbledhur në disa vende si: në Fushë të Gjoricës dhe në Mej të Kalasë (Homesh) më 1844, në Livadhet e Bllacës së Epërme dhe Guri i Shpu më 1855, në Gjurrë të Mazhicës, qershor 1855 dhe maj 1910, në Vorret e Kishavecit më 1872, në Ferrë të Pashës më 1875, në Vorret e Shupenzës më 1909, tek Plepi i Egër më 1912, tek xhamia e Arrasit më 1920 dhe tek Ura e Topojanit më 1924. Muhurri ka patur përfaqësim dinjitoz në këto kuvende dhe ka mbështetur e zbatuar vendimet e tyre për luftë kundër pushtuesve turq, serb e austro-hungarezë.

"Në Kuvendin tek Guri i Shpu, në Fushë të Shehrit më 1855, Muhurri u përfaqësua nga Zenel Hoxha, Mustafa Lala e Jusuf Lika, Ibrahim Kaleshi e Demir Lleshi". (Munir Shehu, "Dibra në vitet 1840-1860, sipas të dhënave gojore dhe folklorit, dorëshkrim, fq.20).

"Nandë Malet e Dibrës, - shkruan Moisi Murra, – kanë luajtur një rol të rëndësishëm, përcaktues, në mbrojtje të qënies kombëtare. Pa mëdyshje, ata u bënë një 'shtet' brenda shtetit në Perandorinë më të fuqishme të kohës, Perandorinë Osmane. Dhe kjo nuk ishte pak". (libri "Dibra nga Antikiteti në Monarki", fq.97.)

Për herë të fundit Malet i gjejmë unikë në Kuvendin e Arrasit, 13 gusht 1920, në të cilin edhe pse pati përfaqësues të qeverisë shqiptare, ai pa mëdyshje qe Kuvendi i Nandë Maleve të Dibrës. Në këtë Kuvend historik Muhurri përfaqësohej nga Dine Hoxha, që falë mençurisë, trimërisë e fisnikërisë së trashëguar nga të parët (Kurt, Nel e Hazis Hoxha) dhe të përvetësuar e demostruar më së miri nga vetë ai, do të bënte emër, jo vetëm në Dibër, por në gjithë Shqipërinë. Veçanërisht me rezistencën e organizuar kundër pushtuesit serb. Kjo luftë ka vendin e saj në histori, një histori betejash dhe sakrificash që shkuan deri në vetëflijime. Ajo është një luftë që u bë për lirinë e Shqipërisë dhe shërben si simbol për të gjithë shqiptarët.

Ndaj dhe elita intelektuale dhe thuajse gjithë muhurrakët kanë të drejtë të indinjohen me aktin absurd të injorimit dhe shtremërimit të historisë së një zone si ajo e Muhurrit që i ka dhënë kombit heronj dhe personalitete të shquara, si gjeneralët e Skëndërbeut Nikollë e Dhimitër Berisha e deri tek mendimtari e prijësi popullor Dine Hoxha, një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog.

** Autori i shkrimit është anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve dhe mban titullin "Mjeshtër i Madh"*

NJOFTIME

- Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Për të dhënat bankare shihni faqen 2.
- Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!
- **KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE.** Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.
- Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT

https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

kujtesë

Havzi Nela, *i rrallë por jo i vetëm*



Homazh për poetin nga SELAMI NAZIFI

Para disa vitesh shkoja shpesh tek një farmaci bujqësore, që ndodhet diku pranë Pazarit të Ri në Tiranë. E dija që farmacisti ishte nga Kukësi. Një ditë, pasi mora porosinë që më duhej, e pyes farmacistin:

- A din gjë, ku është varrosur për së dyti herë i ndjeri Havzi Nela?

Mendohet pak sekonda e më thotë:

- Në fshatin e lindjes, në Kollovoz.

– E pyes për gjendjen e rrugës, kohën e udhëtimit, e disa hollësi të tjera në mënyrë që të planifikoj një vizitë homazh të varri i tij.

- Më fal, po pse interesohesh? - më pyet farmacisti.

- Kam lexuar për jetën e tij dhe më ka lënë përshtypje të thellë. Kam ndjerë shumë trishtim, shumë dhimbje. Njeri i rrallë, disident, antikomunist, trim që sfidoi diktaturën dhe vetë diktatorin, sa ishte gjallë. Havzi Nela në poezitë e tij shpreh shumë dashuri e dhembshuri. Në vjershat e tij ndjehet atdhedashuria, dinjiteti e cilësitë burrërore të një malësori....

- Ishte edhe një mësues, një intelektual, i cili që në atë kohë kishte dijeni për kartën e Helsinkit, kur ne të tjerët ishim "jerm" - ndërhyn farmacisti.

- Kam krijuar respekt e nderim, ndaj desha t'i bëj një homazh personal këtij martiri të fjalës së lirë..., - thashë unë.

–E varën në litar në qytetin e Kukësit, tek agjencia e udhëtarëve, në vendin ku kishte më shumë lëvizje, në mënyrë që të shihej nga të gjithë - kujton farmacisti.

- A ka më makabritet, kur në vitin 1988, dy vjet para se të vijë demokracia, në një vend në mes të Europës, të ndodhë një ngjarje e tillë?! Fati i tij i keq, pasi për dy vjet nuk mbërriti t'i gëzonte këto ditë demokracie...

- Pse nuk thua që "ishte më mirë që nuk i pa këto ditë demokracie!" - tha farmacisti gjithë pezm.



Për një moment mbeta i shtangur. Nuk iu përgjigja dhe u largova mendueshëm.

Konstatimi i tij ishte një gjë normale. Në çdo mjedis me të gjallë mund të dukej si diçka normale, por pyesja veten si do të reagonin të vdekurit?

Për të gjallët kjo pyetje ka përgjigjen te libri "Shumë gurë u hodhën mbi mua" me autor Xhafer Martinin. Shkrimtari Agron Tufa, në parathënien e librit, ndër të tjera shkruan:

"Në Shqipërinë postkomuniste ka ndodhur dështimi më i hidhur e tragjik. Dështimi i misionit antikomunist. Këtë mision duhet ta përmbushte shoqëria shqiptare e lirë e demokratike, po ky mision u sabotua, u tradhtua e u braktis nga klasa e politikanëve". (A. Tufa)

Më 14 gusht 2022 m'u dha mundësia të shkoj e të përulem para varrit të Havzi Nelës, këtij martiri të fjalës së lirë, me respekt e nderim, për shumë virtyte njerëzore që e karakterizonin.

Shfrytëzova rastin dhe "e pyeta" në lidhje me konstatimin e bashkëfshatarit të tij, "se më mirë që nuk i pa këto ditë demokracie". Dhe ai më thotë:

"Eh, more lum miku, bashkëfshatarit dhe gjithë të tjerëve që mendojnë si ai u them se "Ne, të vdekurit, nëse na kujtoni, nuk kemi humbur asgjë, pasi jemi larguar nga ajo jetë (Witer), por, ju të gjallët nuk do të gjeni kurrë prehje e qetësi, s'do të keni të ardhme as ju e as brezat që do të vijnë, për sa kohë nuk do të nderohen e respektohen vuajtjet e dhimbjet e mijëra e mijëra shpirtrave njerëzorë të pafajshëm, për sa kohë do njollosin e do përpiqen të vrasin të vërtetën, ndërkohë që nuk kërkoni të veprojë drejtësia në vend. Mos harroni, përveç drejtësisë njerëzore, ka dhe drejtësi hyjnore, që ndoshta vonon, por nuk harron".

* * *

MËNGJESI NË KUKËS

Poezi nga Bardhyl Londo

Ditën që u vendos në Kukës busti i martirit Havzi Nela

Mëngjesi vjen në Kukës
Me një diell që nuk di ç'të bëjë:
Të qeshë apo të qajë.
Mëngjesi vjen në Kukës
Me një Drin epik
që ende s'e di është i bardhë apo i zi.
Mëngjesi vjen në Kukës
Dhe kurrë s'e mori vesh
përse është më i pikëlluar se Pikëllima.
Mëngjesi vjen në Kukës
Dhe qyteti kurrë nuk e kuptoi
Është qytet i vjetër apo qytet i ri.
Mëngjesi vjen në Kukës
me dy lumenj që lidhen si një nyjë
dhe kurrë s'e morën vesh
a janë një fjongo delikate në kokën e një vajze
apo janë një fjongo e zezë për një kurorë funerali.
Mëngjesi vjen në Kukës
mes Gjallicës, Pikëllimës dhe Kortnikut
si në një trekëndësh gjigant
lëkundet trupi i varur i Havzi Nelës.
Kokën në qiell, këmbët në tokë
dhe askush s'e di
kujt i flet më shumë, qiellit apo tokës.
Dielli lind në Kukës me fytyrën e Havzi Nelës,
trupi i tij varur në trekëndëshin e tri maleve,
kurmi i tij shtrënguar në nyjën e dy lumenjve,
një lajmës i përjetshëm midis qiellit dhe tokës.
Herë i jep tokës sinjale me këmbë,
herë mesazhe i kumton qiellit me dy duart e ngritura lart.
Mëngjesi vjen në Kukës me Havzi Nelën
ndërmjetës midis qiellit dhe tokës.

Qershor, 2018

PORTRET / SHQIPTARI NGA TËRNOVA E DIBRËS NË "ALBANIAN AMERICAN SUCCESS STORY"

Beqir Gjoka, një nga 100 shqiptarët e suksesshëm në SHBA

Beqir Gjoka u lind në Tërnovë me 19 Maj1974, në një familje patriotike. Babi i tij, Uke Gjoka, ishte nip i Hoxhë Hasan Moglicës. Shkollën 8-vjeçare e kreu në Tërnovë. Për arsye ekonomike dhe për t'ju gjendur pranë familjes për nevojat e përditshme, detyrohet të mos vazhdojë shkollën e mesme. Beqiri fillon punë në minierën e Tërnovës si seleksionues kromi për të ndihmuar familjen financiarisht.

Me hapjen e kufijve ne vitet 90-te, ai emigron në Greqi deri në 1999, kur lufta vazhdonte në Kosovë. I tronditur nga masakrat dhe vrasjet masive të makinerisë ushtarake serbe që ushtronte mbi popullsinë e Kosovës, ndërpret emigriminpër të dhënë kontributin e tij në Kosovë.

Në Tiranë takon shefin e shtabit të batalionit të artilierisë, Gëzim Çela, për t'u orientuar se si të mobilizohet për t'u mobilizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Duke qenë se batalioni i forcave speciale ishte në preg të themelimit, Gëzimi e dërgon Beqirin në repartin e forcave speciale në Farkë, ku testoheshin kandidatët për forcat speciale. Beqiri arriti të kualifikohet ndër të parët dhe shërben në Forcat Specialeelitëtë Ushtrisë Shqiptare.

Në vitin 2000 Beqiri kualifikohet në kursin bazë të Forcave Speciale te Republikës



Për merita të veçanta në misione ushtarake Beqiri është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu. Në Irak, për merita dhe shërbime të rëndësisë së veçantë në misione speciale ushtarake, Beqiri dekorohet nga Komanda Amerikane me Flamurin e Nderit.

së Shqipërisë, ku zë vendin e II-të nga 180 kandidatë, 35 të fituar në këtëkonkurs. Kursi u zhvillua nga Forcat Speciale të NATO-s, Beretat e Kuqe të Turqisë.

Mbas kursit bazë të Forcave Speciale, Beqiri ndjek një seri kursesh duke u pajisur me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të kryer misione të rëndësisë së veçantë si brenda Shqipërisë edhe jashtë saj.

Mbas sulmit të 11 Shtatorit 2001, Beqiri dhe grupi i tij, ngarkohen me mision nga shteti Shqiptar në Kabul, Afganistan, ku shërbeu krah për krah forcave të NATO-s. Ai shërbeu në këtë mision për një vit, 2 herë nga 6 muaj. Bashkë me grupin e tij, me komandant misioni Arben Kingjin, sot Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, kthehen në atdhe me kokën lart për kryerjen me sukses të këtij misioni shumë të vështirë. Në këtë mision Beqiri dekorohet me medalje nga komanda e ISAF.

Në vitin 2006, kur shpërtheu lufta në Irak, Beqiri u ngarkua në misionin e radhës "Liria e Irakut". Atje, bashkë me grupin e tij, ju besua si detyrë siguria e Bazës Amerikane dhe patrullime në lagjet e qytetit.

Për merita të veçanta në misione ushtarake Beqiri është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu. Në Irak, për merita dhe shërbime të rëndësisë së veçantë në misione speciale ushtarake, Beqiri dekorohet nga Komanda Amerikane me Flamurin e Nderit.

Në misionin e fundit në Irak, Beqiri njihet me zonjën Samantha, e cila shërbente si koordinatore ushtarake midis qeverisë së Irakut dhe asaj Amerikane.

Në vitin 2010 emigron në Uashington, SHBA. Atje përfundon shkollën e mesme dhe pas shkollës së mesme, ai mbaron me sukses Institutin e Fizkulturës në Fare Fax, Virginia.

Kjo shkolle e përgatiti Beqirin me të gjitha njohuritë në fushën e fitnesit dhe këshillimin e dietave. Duke ushtruar këtë profesion, Beqiri ka krijuar miqësi me një komunitet të madh në Amerikë si dhe për punën e tij ka tërhequr vëmendjen e shumë institucioneve dhe personaliteteve, duke u radhitur si një nga 100 shqiptarët më të suksesshëm në Amerikë.

Emri i tij zë vend në faqen 139 të librit "Albanian American Success Story". Krahas biznesit që drejton, ai vazhdon dhe shkollën e lartë për Shkenca Politike. Ndërkohëmbështet edhe Departamentin e Shtetit si kontraktor me biznesin e tij.

(Marrë nga libri "Ternova e Dibrës")

Meditime pas takimit me një student të Internatit Dibra, një partizani, tankisti, oficeri nëndetëseje... njeriu që shpirti i ka mbet në Dibër...

Mos e harroni Selim Pirën, burrë i rrallë mes të rrallëve i Dibrës

Ai iku, Selim Pira nisi udhëtimin në përjetësi. Rroi 96 vjet. Kur e takova, një ditë vere në hollin e "15 Katshit",3 gusht 2018, kur përjetova gjallërinë, kujtesën si djalë i ri, dashamirësinë, e urova ta kapte "NJË QINDSHIN". Qeshi dhe më përqafoi.

I bëra disa fotografi; vetëm, me të bijën të cilën e ftova të më bëjë një foto bashkë me Selimin. Janë disa fotografi që ma zbukurojnë arkivin tim dhjetëra mijëra fotosh, bardhë e zi dhe me ngjyra.

Po i përcjell si ngushëllim për gjakun e tij, djem e vajza, nipër e mbesa, shokë e miq.

Të rroni, ta kujtoni e ta nderoni...

Mos e harroni SELIM PIRËN. Bën pjesë në BURRAT E DIBRËS, i rrallë mes të rrallëve...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 11 dhjetor 2022



Ti shërbesh atdheut si Selim Pira!

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Vetëm Selim Pira shkruaj në zarfin e kujtesës dhe fletët brenda do të hapen si në një enciklopedi...

Nuk kisha pi ndonjëherë kafe me Selim Pirën...

As i kisha dhënë dorën në ndonjë konak Dibre...

Me të vëllain Sulën po,

Edhe me fëmijët e tij...

Banonim në një pallat me themele të lidhura,

Ai në hyrjen e parë e unë në të tretën,

Në të njëjtin kat...

Selimi më njihte,

Jo në portret, por në germë të penës...

Sa herë më lexonte në "Rruga e Arbrit" apo në "Dita", më merrte në telefon...

Nuk dëgjonte mirë, por fliste qartë e me pasion,

Më bënte të skuqesha nga fjalët në shkallën më të lartë që përdorte ndaj meje...

Më fuste në borxh,

borxhin njerëzor për ta takuar,

pirë një kafe e qëndruar në krah të njërit tjetrit përjetësuar në fotografi...

Do të më afronte me të djali i tij, Xhimi, ikanak si edhe unë në Athinë...

E kisha fiksuar numrin e tij të telefonit...

Xhimi më dha numrin e motrës së tij me këshillën që lidhu me të se ajo ta sjell ku të duash...

Në Tiranë shkoj e iki, si i thonë, "për të marrë një gacë për zjarr"...

Sa herë shkoja e kisha në mendje ta takoja,

"Gaca" mi digjte takimet...

Më në fund e gjeta kohën...

I "lidhur" për t'i shkuar në shtëpi por i zgjidhur gjalmash për ta takuar atje ku duhet të ndiqja një seminar treditor...

I ngjiti shkallët e hotelit "Tirana Internacional" mbajtur për krahu nga vajza, për siguri (kështu na mbajnë tash fëmijët),

i drejtë si plepat "fyell pushke" të Lugjejt buzë Drinit...

"Kambët po më lenë, – më tha duke u përqafuar – por mendjen e kam si në rini"...

U ulëm ballë për ballë...

I shikoja në fytyrë buzëqeshjen...

Mundohesha t'i lexoj shpirtin...

I gjerë si deti, ku kishte lundruar në sipërfaqe e në thellësi...

I lartë si Korabi bjeshkëve të të cilit kishte kullotur ëndrrat...

SHPIRTIN E KAM ATJE, NË DIBËR...

"Unë jam Selim Isuf Pira, mu prezantua me një zë gjëmues...

Datëlindja 1926...

Lindur në Lugje të Dibrës...

Kam pas babën patriot e atdhetar...

"Daja i vogël", i thoshte Eles Isufi...

Në pesëdhjetëvjetorin e Pavarësisë, në vitin 1962, është dekoruar...

E quajnë Isuf Pira...

Unë: Një biografi që më erdhi në shpirt si këngë trimërie, atdhedashurie...

Shpirtin e kam atje, trupin e kam këtu në Tiranë...

Në Dibër...

Duke filluar nga fisi, nga fshati...

Unë: Një mall që s'e shuan as Drini në rrjedhë të trojeve të tij Lugjejt, as Veleshica tek takohet me Drinin e Zi...

Zall Dardha më ka nderue me titullin "Nderi i Dardhës"...

Erdhi edhe Donika Hyseni, sekretarja e përgjithshme...

Erdhën edhe nga komiteti i veteranëve, Ilmi Cani...

E kush do ta humbiste një flori kaq vezullues të asaj treve që atdhetarët e mëdhenj dhe këngët i kishte në barazkandar...

Unë kam 38 vjet pension...

Por a kam qenë në pension apo në punë?...

Punë, aktivist me Frontin edhe me Veteranët...

Kam qenë gjithnjë në kambë...

Edhe sot me shpirt jam në kambë...

Pleqëria nuk më ka ardhë nga koka por nga kambët...

Babën ma kanë vra forcat e Halil Alisë...

Më 8 korrik të 1944-s...

NJË KUJTESË QË TË HABIT

Kam bërë Internatin e Dibrës në Kastriot...

Shaban Shehun kam pas mësues...

Çdo të xhuma bënim mësime për fenë...

Mua më doli bursa për në medrese...

Nuk pranova...

Një nip, Selman Cala, baba i Skënderit dhe Beshirit...

Ishte xhandar në kohën e Zogut, bile u martua atë ditë me Zogun dhe shpenzimet e dasmës ia ka pague Zogu...

Nga shkolla mbaj mend Rufat Spahiun, drejtorin,

Burrë zotni, i mirë...

Qamil Guranjakun kam pas mësues.

Pas Çlirimit ka qenë zëvendësministër i arsimit, partizan, komisar i brigadës së 17 S...

Ishin djemtë e kaloshëve; Sefë Kaloshi, Llon Kaloshi, Mahmut Kaloshi, Hilmi Kaloshi, Kalosh Hysa, Avni Plaku, Ahmet Lahi, Rremzi Ndreu, Lazam Ndreu, Baftjar Ndreu, Irfan Ndreu, djemtë e Cen Elezit dhe të Kaloshëve...

Ka qenë edhe Bajrami i Beshirit, nipi i Dali Ndreut...

Ka qenë edhe Sul Pira, vëllai im...

Beqir Spahiu ka qenë inspektor i arsimit...

Vazhdova gjimnazin e Shkodrës dy vjet...

Më vranë babën, nuk shkova ma,

E lashë në të tretin...

USHTARAK ME RRËNJË NË BETEJA

Kam qenë partizan në Çetën e Sllovës...

U formua më 15 shkurt 1943...

Në çetë kam pas Qatip Calën, Isuf Calën, Faik Ndreun...

Pas Çetës u radhita në Batalionin e Dibrës që u krijua në Gjoricë më 26 korrik 1943...

Më pas në Brigadën e Tetëmbëdhjetë që u krijua në Sllatinë...

Isha komisar kompanie...

Kam marrë pjesë bashkë me Brigadën e 18-të në çlirimin e Dibrës së Madhe, shkuam në Mat deri në Lis...

Esat Ndreu ishte komandant...

Kam qenë përgjegjës i Rinisë të qarkut Shkodër,

Agim Popa ishte komisar, unë i rinisë...

Kam qenë komandant për shpërndarjen e ndihmave të UNRA-s...

Kam qenë në ditën e parë të krijimit të armës së tankeve, komisar...

Kam qenë komisar i specialiteteve në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve 7 vjet.

Kam 15 dekorata të luftës dhe të punës. Dekoratën e parë ma ka dhanë Enver Hoxha.

Ika për studime në Bashkimin Sovjetik, në Sevastopol, shkollën e nëndetëseve...

Kam punuar në nëndetësen e parë, 105-n...

Punova katër vjet...

Sabit Brokën e kam pas ndihmës mjek në nëndetëse...

Ai më njeh gjerë e gjatë, një njeri i mirë, burrë malesh të Labërisë...

Atje më ka lindë vajza, Merita,

Ka le në Orikum në vitin 1961...

Njëzet vjet punova në Ministrinë e Mbrojtjet, zëvendësdrejtor i kuadrit për specialitet...

Vëllai, Sulejmani, ka qenë 18 vjet në Shkollën e bashkuar pedagog...

Gjatë gjithë jetës, deri sa dola në pension kam qenë ushtarak...

Më 15 gusht të vitit 1982 kam dalë në pension...

Kam dy djem e një cucë.

Tre nipër e tri mbesa...

Dhe një stërnip...

* * *

Një kronikë jete si poezi, poetike, si këngë mbi tela çiftelie, lahute...

E shkruar me gjak e me djersë...

Nga ajo lloj djerse që vetëm Selim Pira e ka përcjellë ballit të rinisë e rrudhave të pleqërisë...

Kurdoherë në këmbë...

Maleve betejave partizane...

Mbi tanke...

Në barqe nëndetësesh...

Me dije e kulturë për ta pas zili...

* * *

Zërin e Selimit e ruaj në një zarf kompjuterik... Mbi dy orë bashkë...

Mes të qeshurash e fjalë të ngrohta që mu duk se i dhanë më shumë jetë...

Më dhanë edhe mua...

Mora një gacë...

U shndërrua në prush...

Faleminderit Selim Pira!

Faleminderit Merita!

Athinë, 25 janar 2019

Shuhet **Kujtim Neli**, njeriu i pasionuar pas punës e shkencës.

Më 6 janar 2023, në mënyrë të beftë, u nda nga jeta shoku ynë i fëmijërisë dhe i shkollës, kolegu i punës, Kujtim Neli, njeriu i pasionuar pas punës e shkencës.

Ai lindi më 15 nëntor 1949 në fshatin Cerjan, në gjirin e një familje të madhe patriarkale e me gjendje të mirë ekonomike. Babai, Iljazi, iku i ri, kur Kujtimi ishte 5 vjeç, por mbështetjen e kujdesin atëror ai dhe tre vëllezërit e gjetën te nëna e tyre burrneshe, Sulbia; te gjyshi, Hani dhe te dy xhaxhallarët, Perviz e Dalip.



Shkollën fillore Kujtimi e kreu në fshatin e lindjes, kurse 7-vjeçare dhe gjimnazin në qytetin e Peshkopisë. Shquhej si nxënës inteligjent e me rezultate të mira në mësime. Pas mbarimit të gjimnazit, Kujtimi bën një vit punë në Ndërmarrjen e Ndërtimit Peshkopi, si stazh maturanti në vitet 1969-1970 . Më pas vazhdoi shkollën e larte në ILP 3-vjeçar të Shkodrës në degën biokimi. Në shtator 1973 filloi punën si mësues biokimie në shkollën 8-vjeçare Bellovë, ku punoi e jetoi 10 vjet. Në punën e tij si mësues u shqua për përdorimin e metodave të reja në procesin mësimor, në ngritjen e një kabineti të pasur kimie, në eksperimente e prova të shumta shkencore në fushën e biologjisë e të kimisë si dhe për arritje të mira në formimin shkencor të nxënësve. Në mes të viteve '70, Kujtimi u martua me mësuesen e re, Fiqirete Stojku. Jeta bashkëshortore solli dhe dy fëmije të bukur si engjëj, por ky gëzim familjar nuk zgjati shumë, pasi në vitin 1996, Fiqireti, në moshën 43 vjeç, u nda para kohe nga jeta. Kujtimi nuk u martua më, por u kujdes për mirërritjen e edukimin e fëmijëve. Kujtimi pas kësaj dite "u martua" me shkencën, me studime të thelluara në fushën e mikrobiologjisë mjekësore.

Pas largimit nga Bellova, Kujtimi punoi si mësues biologjie në Greve dhe më pas në Kabinetin Pedagogjik të rrethit Dibër (1988-1992). Në vitin 1993 ai largohet nga puna për pikëpamje politike. Shpërngulet me banim në Tiranë, ku u mor kryesisht me punë shkencore në studimin e florës shqiptare, të bimëve mjekësore e në përgatitjen e ilaçeve të ndryshme. Në shtëpine e tij, një dhomë, ishte studio e tij e punës, ku shihje të ekspozuar në rafte lloj-lloj bimësh e gjethesh, rrënjë, epruveta e mikroskop, shishe me ilaçe etj. Kujtimi ishte një kërkues i madh në këtë drejtim, studiues i zellshëm i shkencave mjekësore.

Kujtimi ka marrë pjesë në shume ë ekspedita shkencore të organizuara nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Pyjeve etj. Me ilaçet e përgatitura nga bimët mjekësore, Kujtimi ka kuruar e shëruar mbi dhjetë mijë pacientë në këto 20 vitet e fundit.

Gjatë viteve 1990-2000 , Kujtimi ka dhënë mbi 50 emisione televizive në televizonet të ndryshme kombëtare dhe lokale. Për bimët mjekësore dhe kurimin e sëmundjeve të ndryshme ka shkruar me dhjetëra artikuj shkencorë në disa organe të shtypit shqiptar. Ai përgatiti dhe patentën e duhanit mjekësor "Rotgines" me 6 bimë mjekësore, e cila shëron gëlbazen, kollën, azmën bronkiale, epilepsinë. Kujtimi punoi në fushën e tij si mjek biolog për parandalimin e sëmundjeve të kancerit. Për arritjet e tij shkencore, ka marrë titullin "Doktor" në fushën e mikrobiologjisë. Kujtimi njihte e fliste mirë 4 gjuhe si: anglisht, italisht, rusisht e serbo-kroatisht.

Kohët e fundit ai u mor me shkrimin e një libri për vendlindjen e tij të dashur, Cerjanin, por fatkeqësisht, vdekja i preu jetën Kujtimit dhe kjo dëshirë e zjarrtë e tij nuk e ka parë ende dritën e botimit.

Lamtumirë shoku ynë i shtrenjtë Kujtim! Dheu i tokës mëmë qoftë i lehtë për ty!

BESNIK LAMI

homazh

Lutfi Manjani, kapiteni i përjetësisë!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Lutfi Manjani ishte futbollisti dhe mësuesi model, qytetari i devotshëm dhe familjari korrekt, njeriu që përmes punës dha shembullin e duhur për të shkruar emrin e mirë me germa të arta në historinë e një klubi të njohur si Korabi dhe një qyteti, po të tillë, si Peshkopia.

Më 5 janar 2023 zemra e tij ndaloj së rrahuri në SHBA në moshën 88 vjeçare, por ai la pas rrugëtimin e suksesshëm, ku padyshim vitet te Korabi i Peshkopisë në futboll janë kryefjala e kontributit në sport, pa harruar përkushtimin si edukator i brezave të shumtë në cilësinë e ish mësuesit dhe kujdestarit në shkollën e mesme "Nazmi Rushiti" në Peshkopi. Pasi mbaroi shkollën pedagogjike, djaloshi që vinte nga fshati Homesh i Shupenzës gjeti vetveten duke u angazhuar në disa ekipe sportive, si në futboll, volejboll e ping-pong, ku shquhej për aftësitë e tij tekniko-taktike, egon pozitive dhe luftën sportive për ta fituar çdo sfidë. Manjani do të mbahet mend edhe si kapiten i Korabit në vitet '62, kur skuadra arriti suksesin e parë historik të ngjitjes në kategorinë e parë. Për afro një dekadë ai ishte një lojtar kontribues, i cili me seriozitetin dhe korrektesën e tij kish fituar edhe shiritin e kapitenit. Qendërmbrojtësi stoik me Nr. 3 ishte një barrikadë e pakalueshme edhe për sulmuesit më të mirë të kohës në vend, si Pano apo Resmja, por edhe mjaft të tjerë që u përballën me skuadrën dibrane dhe duelet e tij në mbrojtje. Së bashku me kushëririn e tij Shemsi Manjani ata përbënin një duet të bukur dhe të forte për ngjyrat e Korabit, duke arritur edhe suksese të niveleve të tilla historike, pra, të ngjitjes në kategorinë e parë.

Ai ishte po kaq i suksesshëm edhe në volejboll, madje Korabi në këtë sport vetëm për një pikë skualifikohet në Sarandë përballë Butrintit, sepse ndryshe do të ngjitej në kategorinë e parë nëse do të fitohej ajo pikë e fundit dhe ai takim dramatik. Ky pasion e shoqëronte Lutfi Manjanin edhe në sporte të tilla të maleve dhe terreneve të vështira, si alpinizëm apo ski, sepse ai ishte njeriu i sfidave dhe djaloshi i guximshëm. Por një pasion i tij i jashtëzakonshëm ishte edhe ping -pongu, duke qenë një raketë fituese dhe një sulmues i frikshëm me goditjet e forta e të papërballueshme edhe me veteranët. Pasionin për këtë sport ai e vijoi edhe në moshën e tretë, duke marrë pjesë edhe në mjaft turne kombëtarë dhe mbarëkombëtarë së bashku me Shkëlqim Hoxhën, ish sportist dhe njëherësh edhe organizator i disa aktiviteteve të tilla dhe mjaft ping-pongistë të tjerë.

Luti të imponente respekt me atë buzëqeshjen dhe sjelljen e tij shembullore prej një dibrani burrnor dhe të mençur, duke shëmbëllyer me korrektesën e pashembullt në vendin e punës dhe jashtë saj. Ai punoi për shumë vite në shkolla të ndryshme të rrethit të Dibrës, në fshat dhe qytet, duke dhënë më të mirën e profesionit dhe duke lënë gjurmë kujtese për ish nxënësit dhe kolegët e tij. Edhe në konviktin e shkollës së mesme "Nazmi Rushiti" në Peshkopi punoi me përkushtim si kujdestar. Luti ishte vërtet një kujdestar i kujdesshëm për qindra nxënës, vajza e djem, duke luajtur rolin e një prindi të dytë, ku jetoi me hallet dhe problemet e tyre, pasi të gjithë konviktorët vinin edhe nga fshatra të largët të Dibrës, por edhe rrethe të tjera në veri të vendit.

Lutfi Manjani sot pushon në qytetin pa jetë, duke pikëlluar bashkëshorten e tij Sabrijen, por edhe fëmijët e tij, Gëzimen, Halilin, Afrimin dhe Meribanin, nipërit dhe mbesat, të cilët e deshën kaq shumë dhe bënë gjithçka sa ai ishte gjallë në respekt të njeriut të tyre të shtrenjtë. Po ashtu dhimbje ndjejnë edhe vendlindja e tij Dibra, ish nxënësit, ish kolegët, miqtë dhe të gjithë ata që e njohën dhe e nderojnë edhe sot me respekt, për atë çfarë dha dhe për atë çfarë ishte në çdo dimension profesional, njerëzor dhe human. I paharruar qofsh profesori ynë i dashur! Prehu në paqe, sepse paqja dhe mirësia ishin dy anët e tua cilësore, krahas shumë gjërave pozitive që ti dhurove në jetë.



Lutfi Manjani (në rreth) me ekipin e Korabit

Mirënjohje e qytetit dhe "Nderi i Klubit Korabi" i jepet Lutfi Manjanit pas vdekjes

Dibra nderon ish futbollistin dhe mësuesin model

Lutfi Manjani është njëri prej ikonave të futbollit dhe sportit dibran që pak ditë më parë ndërroi jetë në Shtetet e bashkuara në Amerikë, ku jetonte prej vitesh. Por qyteti ku ai lindi dhe u rrit e kontribuoi fort në sport dhe në arsim, Peshkopia, ka ditur ta nderojë edhe në mungesë këtë mjeshtër të sportit dhe jo vetëm. Në sallën e pallatit të kulturës "Haki Stërmilli" janë bërë bashkë drejtues vendorë dhe qytetarë të thjeshtë, ish futbollistë dhe skuadra aktuale e Korabit, në shenjë mirënjohje për gjithçka ai bëri në sportin dibran.

Fillimisht është transmetuar një dokumentar i shkurtër i RTSH Sport për jetën dhe veprën e tij, ndërsa më pas kryetari i Bashkisë Dibër Rrahim Spahiu, përveç se ka folur për meritat e tij, e ka nderuar me mirënjohjen e qytetit Lutfi Manjanin pas vdekjes, titull ky që i është dorëzuar djalit të tij Afrim Manjani, që nuk i ka mbajtur dot emocionet. Më pas janë ngjitur në skenë dhe kanë pohuar vlerat e Manjanit kryetarja e qarkut zonja Valentina Haliti Doda, zoti Nexhmedin Shehu, prefekti i Dibrës, deputeti i qarkut të Dibrës zoti Lavdrim Krrashi, ish kryetari i bashkisë dhe ish nxënësi i tij Ilir Krosi, komentatori i mirënjohur i Radio Tiranës Rrok Preçi, trajneri i njohur i volejbollit dibran Fehmi Bulku, njëherësh ish koleg i tij, ndërsa më pas në sallë mikrofoni ishte për qytetarë, sportdashës e trajnerë të ndryshëm, që sollën kujtime e mbresa. Kulmi arriti kur në skenë është ngjitur stafi i ekipit të Korabit me presidentin Fehmi Mziu, trajnerin Shpendi Kumbarçe dhe kapitenin Sokol Mziu, të cilët e kanë dekoruar Lutfi Manjanin me titullin e larte: Nderi i Klubit Korabi dhe i kanë dorëzuar djalit të tij fanellën me Nr. 3, që ai mbante dikur kur luante si qendërmbrojtës i Korabit në vitet '55-'65.

Një foto e përbashkët mbylli këtë takim, ndërsa më pas në stadiumin e qytetit në prag të ndeshjes Korabi – Partizani është zhvilluar një ceremoni, ku fillimisht trashëgimtari i Lutfi Manjanit ka bërë një gjest simbolik, duke i dorëzuar skuadrës një shumë financiare dhe më pas të dyja skuadrat, Korabi dhe Partizani, kanë mbajtur një minutë heshtje në nderim të ikonës së futbollit dibran. Kësisoj, mjeshtri i njohur i sportit dhe njëri prej yjeve të futbollit dibran, u përjetësua në mënyrën më të mirë, duke vlerësuar gjithë atë rrugëtim që ai bëri, duke i dhënë shumë Korabit dhe Dibrës në sport dhe në fushën e arsimit si njëri prej mësuesve më të dalluar në vite.



Lutfi Manjani me familjen.



Afrim Manjani, i biri:

Mirënjohjen time do t'ia dedikoj atij qyteti, që i dha mundësinë babait tim dhe shumë të tjerëve, të demonstronin nëpërmjet kulturës dhe sportit, vlerat reale që në fakt i gjetën edhe falë të parëve të tyre që formuan atë qytet dhe e mbajtën aq të pastër dhe të bukur emrin e tij. Do t'ju lutesha brezave që atë traditë të bukur ta përcjellin dhe ta mbajnë ashtu si të parët tanë. Falenderoj Bashkinë e Dibrës dhe kryetarin Rrahim Spahiu, por dhe klubin Korabi, të cilët e vlerësuan me çmimet përkatëse punën dhe kontributin e babait tim, por edhe drejtuesit vendorë dhe të gjithë ata që morën pjesë në atë takim përkujtimor dhe shumë emocionues për tim atë, ku edhe dua të çmoj punën e palodhur dhe realizimin shumë profesional të të gjithë këtij aktiviteti të gazetarit të mirënjohur dhe dibranit tonë të palodhur Defrim Methasani.



Lutfiu (djathtas) dhe Shemsi Manjani.



Lutfi Manjani (djathtas)



NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK.
PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE...

Bëj pajtimin tënd!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për të ndihmuar në botimin e gazetës mund të përdorni botimin e saj në versionin print për njoftime ose reklama të ndryshme për bizneset.

Një faqë me ngjyra në fund të gazetës kushton 20 000 leke, ndërsa në brendësi të gazetës 15 000 lekë.
Një faqe bardh e zi kushton 10000 lekë.
Një reklamë në formatin e kartëvizitës 5x9 cm kushton 1000 lekë gjatë gjithë vitit (12 botime)

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen **VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE** që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë.
SWIFT Code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Për informacion: tel: **069 20 68 603;**
Whatsapp: **0686508441.**
Email: **rrugaearberit@gmail.com**

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit", duke skanuar QR Code ose përmes lidhjes: https://tinyurl.com/lcc3e2f

cyan magenta yelloë black